



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



RAPORTI VJETOR 2022

Prishtinë, mars 2023

FJALA HYRËSE

Të nderuar,

Kam nder të veçantë që Kuvendit të Republikës së Kosovës t'ia paraqes Raportin vjetor të aktiviteteve të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) dhe të sektorit të energjisë që janë zhvilluar gjatë vitit 2022.

Ky raport vjetor është përpiluar në pajtim me dispozitat ligjore të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, dhe i dorëzohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për informim, shqyrtim e miratim.

Raporti vjetor paraqet një pasqyrë detale të aktiviteteve të zhvilluara dhe arritjeve kryesore të ZRRE-së dhe të sektorit të energjisë, si dhe raportin financiar të ZRRE-së për vitin 2022. Raporti përmban të dhëna dhe informacione për ngjarjet më të rëndësishme për tregun e energjisë, shqyrtimin e tarifave të energjisë, raportin financiar të ZRRE-së, si dhe të dhëna për aktivitetet e rregulluara në sektorin e energjisë në Republikën e Kosovës.

ZRRE është agjenci e pavarur e themeluar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës sipas neneve 119.5 dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ku aktivitetin e saj e ka në fokus të sigurinë së furnizimit me energji me çmime të përbalueshme, mbrojtjen e konsumatorëve të energjisë, si dhe funksionimin e qëndrueshëm të ndërmarrjeve të energjisë.

Viti 2022, ashtu si edhe viti 2021, konsiderohet si një nga vitet më sfiduese për sektorin e energjisë në Kosovë, si pasojë e rritjes së paprecedentë të çmimeve të energjisë elektrike në tregjet ndërkombëtare të energjisë.

ZRRE brenda mandatit të saj ka ndërmarrë veprime të domosdoshme për tejkalimin e krizës energjetike, e posaçërisht me çmimet e energjisë elektrike, me qëllim të furnizimit të qëndrueshëm me energji, duke zhvilluar shqyrtimin e jashtëzakonshëm të tarifave të energjisë elektrike.

Pas një procesi të gjatë disa mujore, ZRRE gjatë vitit 2022 ka përcaktuar Vlerat hyrëse për Periudhën rregullative 2023-2027 që janë parametrat kryesorë të cilat përdoren për llogaritjen e të hyrave të lejuara maksimale të Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Tregut dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes. Parametrat kryesorë të cilat janë përcaktuar nga ZRRE gjatë vitit 2022 janë: Mesatarja e ponderuar e kostonë së kapitalit, Caku i reduktimit të humbjeve dhe lakorja e humbjeve të lejuara, dhe Faktori i Efikasitetit.

Tregu i përbashkët Kosovë – Shqipëri ka zënë vend të veçantë në aktivitetet e ZRRE gjatë vitit 2022, me qëllim të funksionalizimit të bashkimit të tregut të energjisë. Duhet përmendur se në vitin 2022 është mbajtur mbledhja e parë e përbashkët mes Rregullatorit të Republikës së Kosovës dhe Rregullatorit të Republikës së Shqipërisë, ku të dy Rregullatorët kanë miratuar Rregullat e ALPEX-it, e që me miratimin e këtyre rregullave është bërë përmbyllja e tërë kornizës Rregullative për krijimin e tregut të përbashkët Kosovë – Shqipëri.

ZRRE gjatë vitit 2022 si nevojë e nxitjes së ndërtimit të projekteve energjetike ka rishikuar dhe plotësuar Rregullën për Procedurën e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja nga BRE, me qëllim që të lehtësohen procedurat aktuale, që të përfshihen edhe procedura tjera për lëshimin e Autorizimit për projektet tjera të energjisë, si dhe të zhvillohet një treg konkurrues i energjisë. Të

gjitha këto veprime janë bërë që të nxisim investime të reja, për të garantuar sigurinë dhe stabilitetin e sektorit të energjisë në Republikën e Kosovës.


Për të lehtësuar procesin e liberalizimit të tregut të energjisë elektrike, respektivisht nxitur konkurrencën në tregun e energjisë elektrike, ZRRE gjatë vitit 2022 ka licencuar, vazhduar, apo njohur edhe nëntë (9) licenca të furnizimit me energji elektrike me pakicë dhe shumicë, ku tre (3) prej tyre janë përmes parimit të reciprocitetit dhe Memorandumit të Mirëkuptimit me Entin Rregullator të Shqipërisë.

ZRRE si çdo vit tjetër, edhe këtë vit ka bashkëpunuar ngushtë me komisionet parlamentare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, me ministritë relevante të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me Autoritetin e Konkurrencës, me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë në Vjenë, me Asociacionin Rajonal të Rregullatorëve të Energjisë, me Këshillin e Rregullatorëve Evropian për Energji, e me shumë institucione tjera.

Në emrin tim dhe anëtarëve tjerë të Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji, dua të shpreh mirënjohje ndaj të gjithë personelit të ZRRE dhe të sektorit të energjisë, për punën dhe përkushtimin e tyre në ofrimin e shërbimeve ndaj konsumatorëve, gjatë këtij viti të krizës energjetike.

Për fund, ZRRE mbetet e përkushtuar në rrugën drejt një tranzicioni energjetik, në përputhje me synimet drejt integritimit në tregun evropian të energjisë, duke vendosur konsumatorin e energjisë në qendër të saj.

Me respekt,



Ymer Fejzullahu

Kryesues i Bordit



PËRMBAJTJA

1	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	9
2	ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI	12
2.1	Bordi i Rregullatorit.....	12
2.2	Struktura organizative dhe burimet njerëzore	13
2.3	Financimi i Rregullatorit.....	17
3	AKTIVITETET E ZYRËS SË RREGULLATORIT PËR ENERGJI	18
3.1	Licencimi i aktiviteteve të energjisë.....	18
3.2	Monitorimi i ndërmarrjeve të energjisë	25
3.3	Burimet e Ripërtërishme të Energjisë (BRE).....	31
3.4	Autorizimi për ndërtimin e kapaciteteve të reja	33
3.5	Gjeneratorët për vetë-konsum	34
3.6	Monitorimi i ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese	38
3.7	Integrimi i tregut	39
3.8	Kriza në sektorin e energjisë.....	41
3.9	Aktivitetet e Rregullatorit në fushën e rregullimit të çmimeve	41
3.10	Aktiviteti i Rregullatorit në fushën e mbrojtjes së konsumatorëve	57
4	BASHKËPUNIMI ME PALËT TJERA DHE TRANSPARENCA	62
4.1	Përfshirja e Publikut në proceset rregullative përmes Konsultimeve Publike	62
4.2	Raportimi dhe bashkëpunimi me Kuvendin e Kosovës	64
4.3	Takime me palët e tjera të interesit	65
4.4	Bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare.....	66
4.5	Pjesëmarrja e Rregullatorit në aktivitetet ndërkombëtare	68
4.6	Aktivitetet e prokurimit	73
5	RAPORTIMI FINANCIAR PËR RREGULLATORIN	74
5.1	Të hyrat	74
5.2	Buxheti	74
5.3	Shpenzimet buxhetore.....	75
6	SEKTORI I ENERGJISË ELEKTRIKE	79
6.1	Karakteristikat e sektorit të energjisë elektrike.....	79
6.2	Burimet primare të energjisë.....	83
6.3	Prodhimi i energjisë elektrike	84
6.4	Sistemi i transmetimit.....	89
6.5	Sistemi i shpërndarjes së energjisë elektrike.....	99

6.6	Furnizimi me energji elektrike	109
6.7	Importi dhe eksporti i energjisë elektrike.....	114
6.8	Standardet e cilësisë së furnizimit dhe shërbimit me energji elektrike	117
7	SEKTORI I ENERGJISË TERMIKE	130
7.1	Karakteristikat teknike të sistemeve të energjisë termike	130
7.2	Zhvillimet kryesore në sektorin e energjisë termike	131
7.3	Performanca e ndërmarrjeve të energjisë termike	134
7.4	Faturimi, arkëtimi dhe sipërfaqja e ngrohjes	138
8	SEKTORI I GAZIT NATYROR	141
8.1	Perspektiva e zhvillimit të sektorit të gazit natyror në Kosovë	141

Lista e shkurtesave

AIT	Average Interruption time (Koha mesatare e ndërprerjes)
AQP	Agjencia Qendrore e Prokurimit
BE	Bashkimi Evropian
BRE	Burimet e Ripërtërishme të Energjisë
CCP	Customer Care Programme (Programi për përkujdesje të konsumatorëve)
CEER	Council of European Energy Regulators (Këshilli i Rregullatorëve Evropian për Energji)
DETG	Departamenti për energji termike dhe gaz
DLL	Departamenti ligjor dhe i licencimit
DMK	Departamenti për mbrojtjen e konsumatorëve
DTÇ	Departamenti i tarifave dhe i çmimeve
DTE	Departamenti për treg të energjisë
EBRD	European Bank for Reconstruction and Development (Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim)
EC	European Commission (Komisioni Evropian)
ECRB (BRKE)	Energy Community Regulatory Bord (Bordi Rregullativ i Komunitetit të Energjisë)
EJL	Evropa Juglindore
EMS	Operatori i Sistemit të Transmetimit të Serbisë
ENS	Energy Not Supplied (Energjia e pafurnizuar)
ENTSO-E	European Network of Transmission System Operators for Electricity (Rrjeti Evropian i Operatorëve të Sistemit të Transmetimit për Energji Elektrike)
ERC	Komisioni Rregullativ për Energji dhe Ujë i Republikës së Maqedonisë Veriore
ERE	Enti Rregullator të Energjisë të Republikës së Shqipërisë
ERRA	Energy Regulators Regional Association (Asociacioni Rajonal i Rregullatorëve të Energjisë)
FSHU	Furnizuesi me shërbim universal
GPG	Grupi Punues për Gaz
GPNL (PHLG)	Grupi i përhershëm i nivelit të lartë (Permanent High Level Group)
GWh	Gigavatorë
HC	Hydrocentral
HLM (MAR)	Të Hyrat e Lejuara Maksimale (Maximum Allowed Revenue)
IAP	Ion-Adriatik-Pipeline – Gazsjellësi Përtej Adriatikut
ITC	Inter TSO Compensation (Kompensimi ndërmjet OST-ve)
KE	Komuniteti i Energjisë
KEDS	Kompania Kosovare për Distribim me energji elektrike (Kosovo Electricity Distribution and Services)
KEEJL	Komuniteti i Energjisë në Evropën Juglindore
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KESCO	Kompania për furnizim me energji elektrike e Kosovës (Kosovo Electricity Supply Company)
KESH	Korporata Energjetike e Shqipërisë
KfW	Banka Gjermane për Zhvillim
KM	Këshilli i Ministrave

km	Kilometër
KOSTT	Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Tregut
KPSC	Komisioni Rregullativ për Shërbime Publike Kentucky
kV	Kilovolt
kW	Kilovat
LP	Largpërçues
MAP	Ministria e Administratës Publike
MBE	Marrëveshja për Blerjen e Energjisë
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MVA	Megavoltamper
MW	Megavat
MWh	Megavatorë
MW_{TH}	Megavat termik
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
NARUC	National Association of Regulatory Utility Commissioners (Asociacioni Nacional i Komisionarëve të ndërmarrjeve Rregullative)
NjA	Njësia e administratës
NQ	Ngrohje Qendrore
NS	Nënstacioni
OSSH	Operator i Sistemit të Shpërndarjes
OST	Operator i Sistemit të Transmetimit
OT	Operator Tregu
PECI	Projects of Energy Community Interest (Projekti i Interesit të Komunit. Energjisë)
PRR	Periudha rregullative
RAB	Regulated Asset Base (Baza e Rregulluar e Aseteve)
RoR	Rate of Return (Norma e kthimit)
SAIDI	Indeksi mesatar i kohëzgjatjes së ndërprerjeve në sistem
SAIFI	Indeksi mesatar i frekuencës së ndërprerjeve në sistem
SCADA	Supervisory Control and Data Acquisition (Sistemi Mbikëqyrës dhe i Mbledhjes së të Dhënave)
SKE	Energy Community Secretariat (Sekretariati i Komunitetit të Energjisë)
TAP	Trans-Adriatik-Pipeline – Gazsjellësi Përtej Adriatikut
TC	Termocentral
TF	Task Forcë
TKE	Traktati i Komunitetit të Energjisë
TM	Tensioni i Mesëm
TR	Transformator
TU	Tensioni i Ulët
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
UA	Udhëzimi administrativ
USAID	United States Agency for International Development (Agjencia e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim Ndërkombëtar)
WACC	Weighted Average Cost of Capital (Mesatarja e ponderuar e kostos së kapitalit)

WBIF	Western Balkans Investment Framework (Korniza për Investime në Ballkanin Perëndimor)
ZK	Zona Kadastrale
ZRRE	Zyra e Rregullatorit për Energji (Rregullatori)

1 PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Zyra e Rregullatorit për Energji (në tekstin e mëtejshëm Rregullatori), në përputhje me kërkesat ligjore që dalin nga Ligji për Rregullatorin e Energjisë (Ligji nr. 05/L-084), paraqet Raportin Vjetor për vitin 2022 për shqyrtim në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Raporti Vjetor përmban informata mbi aktivitetet në lidhje me fushëveprimin e Rregullatorit, si dhe funksionimin e sektorit të energjisë, duke analizuar të dhënat e të licencuarve, përfshirë edhe zhvillimin e tregut të energjisë në Kosovë.

Pjesë përbërëse e këtij raporti është gjithashtu edhe Raporti financiar i buxhetit të Rregullatorit për vitin 2022.

Bordi i ZRRE-së, për tema të ndryshme të vendimmarrjes, përveç mbledhjeve të rregullta me pjesëmarrje fizike, ka shfrytëzuar edhe mjetet e komunikimit virtual elektronik.

Çmimet e energjisë elektrike kanë filluar të ngritën ndjeshëm që nga gjysma e dytë të vitit 2021, e që bazuar në çmimet në HUPX – bursën Hungareze të Energjisë Elektrike, e cila merret si referencë për shkak të afërsisë gjeografike dhe likuiditetit të saj dhe në vitin 2022 çmimi mesatar i energjisë elektrike në HUPX ishte 271.66€/MWh, derisa mesatarja vjetore për 2021 ishte 113.86€/ MWh (në gjysmën e dytë kishte arritur vlerën 376€/MWh).

Blokimi i linjave transmetuese për operim komercial dhe mos alokimimi i kapacitetit transmetues në kufirin interkonektiv në mes KOSTT-it dhe EMS-së vazhdon të ndikoj në rritjen e çmimeve të energjisë elektrike. Mungesa e kapaciteteve transmetuese ndërkuftare si rezultat i bllokimit të linjave interkonektive për operim komercial nga ana e Serbisë vazhdon të shkaktoj vështirësi serioze për tregtarët, siç është pengimi i tregtisë së energjisë në këtë kufi, duke reflektuar kështu me rritjen e çmimit të kapaciteteve ndërkuftare në kufijtë e tjerë dhe çmimin e importit të energjisë, për Kosovën dhe për Evropën Juglindore, dhe ka shkaktuar vështirësi në balancimin e sistemit.

Me fillimin e operimit si Zonë Rregulluese e pavarur në kuadër të Evropës Kontinentale, që nga data 14 dhjetor 2020 me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së Kyçjes ndërmjet KOSTT dhe operatorëve të sistemit të transmetimit (OST) nga Evropa Kontinentale, balancimi i sistemit është përgjegjësi e plotë e KOSTT, që nënkupton mbulimin e të gjitha devijimeve nga sistemi i Kosovës.

Furnizimi i katër komunave veriore të Kosovës, edhe gjatë vitit 2022 është bërë nga KOSTT duke shfrytëzuar të hyrat nga buxheti i ndarë nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Kostoja totale e shkaktuar për energjinë e konsumuar por të papaguar nga katër komunat veriore të Kosovës në këtë vit ka qenë 63,177,300 €, prej të cilave nga buxheti i ndarë nga Qeveria e Republikës së Kosovës janë paguar 57,500,000 €, ndërsa pjesa e mbetur është mbetur borxh ndaj devijimeve të shkaktuara ndaj rrjetit evropian të transmetuesve të energjisë elektrike.

Në këtë raport janë paraqitur në mënyrë të detajuar të dhëna mbi ecurinë e Sektorit të Energjisë për vitin 2022.

Prodhimi i gjithmbarshëm i energjisë elektrike në vitin 2022 ka qenë 6,315 GWh, prej të cilave 5,678 GWh janë nga termocentralet, ndërsa nga HC dhe BRE tjera janë 637 GWh, dhe ka një ngritje prej 1,7% krahasuar me gjithsej prodhimin në vitin 2021.

Kërkesa e përgjithshme për energji elektrike në sistem në vitin 2022 ka qenë 6,547 GWh, që paraqet një ulje prej 4.90% në krahasim me kërkesën në vitin 2021. Kjo kërkesë kryesisht është plotësuar nga

prodhimi vendor, ku termocentralet kanë pjesëmarrjen më të madhe, derisa pjesa tjetër është mbuluar nga importet.

Sasia e përgjithshme e energjisë elektrike e shitur te konsumatorët fundor ka qenë 4,930.4 GWh, prej të cilave 3,116 GWh apo 63.4% janë për konsumatorët familjar, kurse pjesa tjetër 1,804 GWh apo 36.6% për konsumatorët jo-familjar. Në faturimin e konsumatorëve jo-familjar përfshihet edhe faturimi i konsumatorëve të parregulluar i cili në vitin 2022 ka qenë 113,3 GWh.

Për kategorinë e konsumatorëve familjar çmimi mesatar i energjisë është 6.14 €cent/kWh, ndërsa për konsumatorët jo-familjar çmimi mesatar i energjisë është 9.27 €cent/kWh.

Humbjet në rrjetin e transmetimit janë në nivel të pranueshëm 1.25 % ndaj energjisë së futur në transmetim, dhe janë përafërsisht në të njëjtin nivel me humbjet në rrjetet transmetuese në rajon dhe Evropë.

Humbjet teknike në rrjetin e shpërndarjes ende janë mjaft të larta, dhe në vitin 2022 kanë qenë 12.21 %, kurse konsumi i paautorizuar i energjisë (më tutje në tekst humbjet komerciale) përbëjnë 10.42 % të kërkesës në shpërndarje, prej të cilës energjia e pa faturuar në katër komunat veriore të Kosovës përbënë 5.85 % (362 GWh).

Tabela e mëposhtme pasqyron të dhënat kryesore të realizuara në vitin 2022 krahasuar me bilancin e vitit 2022 dhe me realizimin në vitin 2021, prej nga shihet se për balancimin e sistemit-furnizim ndaj kërkesës është paraqitur nevoja për importe dhe eksporte.

Tab. 1.1 Të dhënat kryesore të realizuara në vitin 2022

	Njësia	Prodhimi	Kërkesa	Importi	Eksporti	Humbjet	
						Transmetim	Shpërndarje
Realizimi 2022	GWh	6,315	6,547	761	787	118	1,403
Bilanci 2022	GWh	6,598	7,008	1,573	1,026	137	1,440
Realizim/Bilanc	%	95.71	93.43	48.39	76.69	86.32	97.40
Realizimi 2021	GWh	6,207	6,885	1,311	835	120	1,538
Raporti 2022/2021	%	101.74	95.10	58.07	94.23	98.54	91.19

Sa i përket sektorit të energjisë termike situata mbetet kryesisht e pandryshuar. Projekti i kogjenerimit në NQ Termokos ka dhënë rezultate të mira duke ngritur cilësinë e ngrohjes për konsumatorët e kyçur në rrjet, ndërsa projekti i ngrohjes se re dhe kogjenerimit me biomase në NQ Gjakova është përfunduar.

- Prodhi neto i energjisë termike në sezonin 2021/2022, në NQ Termokos ka qenë 288 GWh_{Th}, ndërsa në NQ Gjakova 12.7 GWh;
- Konsumi i energjisë termike në sezonin 2021/2022, në NQ Termokos ka qenë 256.6 GWh_{Th}, ndërsa në NQ Gjakova 10.17 GWh;
- Humbjet ne rrjet të energjisë termike në sezonin 2021/2022, në NQ Termokos ka qenë 12.84 % (në rrjetin e transportimit të energjisë termike: 2% dhe në rrjetin primarë të shpërndarjes 10.84%), ndërsa humbjet ne rrjetin e shpërndarjes se energjisë termike te NQ Gjakova janë vlerësuar 20%.

Në Kosovë nuk ekziston infrastrukturë funksionale dhe treg i gazit natyror, mirëpo ligjet e energjisë dhe strategjia e energjisë parashohin zhvillimin e infrastrukturës së gazit natyror, përmes lidhjes

(kyçjes) me projektet e infrastrukturës së gazit në rajonin e Evropës Juglindore, përmes projektit të gazsjellësit TAP (“Trans-Adriatik-Pipeline” – Gazsjellësi Përtej Adriatikut) dhe Projektit të interkoneksionit të gazit Maqedoni e Veriut - Kosovë.

Sa i përket zhvillimit projekteve të gjenerimit nga burimet e rinovueshme, gjatë këtij viti pas finalizimit të projekteve sipas Autorizimit nga Bordi i ZRRE-së, dhe pas pranimit teknik ka hyr në operim komercial një (1) projekt nga Turbinat e Erës, projekti WIND PARK SELAC 3 me fuqi totale të instaluar prej 34.47 MW. ZRRE, gjatë këtij viti ka trajtuar edhe kërkesat/aplikacionet për gjeneratorët për marrjen e statusit të konsumatorit prodhues për vetë-konsum, të cilat pas plotësimit të kërkesave ligjore në pajtim me Rregullën e Autorizimit dhe Skemën mbështetëse, janë lejuar për të vazhduar me ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese për vetë-konsum dhe në total janë instaluar 4.2 MW.

Në zbatim të detyrimeve të Traktatit të Komunitetit të Energjisë, me qëllim të krijimit dhe funksionimit të një tregu konkurrues të energjisë elektrike, Shqipëria dhe Kosova kanë themeluar Bursën Shqiptare të Energjisë ALPEX, përmes së cilës të dyja vendet parashikojnë të zbatojnë Modelin i Synuar Evropian i Tregut, për tregjet e ditës në avancë (DAM) dhe brenda ditës (IDM), të karakterizuara ndryshe dhe si tregje me shumicë bazuar në transaksionet dypalëshe dhe kontratat e lidhura midis dy pjesëmarrësve të tregut jashtë bursës së energjisë elektrike (Over the Counter -OTC) ose ndryshe si një treg i organizuar i ditës në avancë dhe brenda të njëjtës ditës, i organizuar nga Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike-ALPEX.

ALPEX-i do të ofrojë platformë transparente për tregtimin e energjisë, do të ngrit konkurrencën në nivel të çmimit me pakicë dhe krijojë sinjale të çmimit që do të nxisë investime të reja të sektorit privat, si dhe ofron hyrje më të lehtë të furnizuesve të rinj dhe kapacitet më të mirë absorbues të gjenerimit nga burimet e ripërtëritshme të energjisë (BRE). Kjo platformë tregtimi është një hap i madh në krijimin e tregut rajonal të energjisë të Ballkanit Perëndimor, prej nga do të përfitojnë përfundimisht konsumatorët e Kosovës, Shqipërisë por përfundimisht i tërë rajoni, dhe është mënyra më efikase për të ndihmuar maksimizimin e shfrytëzimit të kapacitetit ndërkufitar të energjisë elektrike dhe të transmissioinit me çmimin më të ulët të mundshëm.

Më 27 dhjetor 2022, Zyra e Rregullatorit për Energji e Kosovës (ZRRE) dhe Enti Rregullor i Energjisë i Shqipërisë (ERE) mbajtën një mbledhje të përbashkët në Prishtinë për miratimin e rregullave dhe procedurave të tregimit për ALPEX, i cili ishte hapi përfundimtar në kornizën rregullative që nevojitet për të mundësuar operimin e bursës së energjisë elektrike në mes të dy vendeve.

ZRRE-ja në vazhdimësi është e angazhuar për një bashkëpunim edhe më të ngushtë me Sekretariatën e Komunitetit të Energjisë në Vjenë, si një ndër partnerët kryesorë në përpilimin e legjislacionit primar dhe sekondar, Qeverinë, Autoritetin e Konkurrencës, si dhe të gjithë akterët e tjerë të Sektorit Energjetik në vend e më gjerë.

2 ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI

Zyra e Rregullatorit për Energji (Rregullatori) është agjenci e pavarur dhe e ndarë në aspektin ligjor dhe funksional nga çdo person tjetër fizik a juridik. Detyrat dhe funksionet e Rregullatorit janë të përcaktuara në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084, të cilat përfshijnë: krijimin dhe funksionimin efikas, transparent dhe jo-diskriminues të tregut të energjisë; përcaktimin e kriterëve dhe kushteve si dhe dhënien e licencave për kryerjen e aktiviteteve në fushën e energjisë; përcaktimin e kriterëve dhe kushteve dhe dhënien e autorizimeve për ndërtimin e kapaciteteve të reja; monitorimin e tregut dhe përkujdesen për përmirësimin e sigurisë së furnizimit me energji; vendosjen e tarifave për aktivitetet e energjisë në mënyrë të arsyeshme dhe në bazë të metodologjisë tarifore; monitorimin dhe parandalimin e krijimit të pozitës dominuese dhe praktikave jo-konkurruese nga ndërmarrjet e energjisë, si dhe zgjidhjen e ankesave dhe kontesteve në sektorin e energjisë.

Rregullatori është përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e kornizës rregullative për sektorin e energjisë në Kosovë, me qëllim që të arrihet pajtueshmëri me detyrimet e Traktatit të KEEJL-së dhe harmonizimit me “*acquis communautaire*” për energji, për të siguruar qasje jo diskriminuese të të gjithë shfrytëzuesve të rrjetit të energjisë me çmime që reflektojnë shpenzimet e vërteta ekonomike.

2.1 Bordi i Rregullatorit

Bordi i ZRRE-së, është organi vendimmarrës për të gjitha çështjet nën juridiksionin dhe kompetencën e ZRRE-së sipas Ligjit Nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë, përbëhet nga Kryesuesi dhe 4 anëtarë, të cilët emërohen në detyrë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me një mandat 5 vjeçar. Bordi merr vendime me shumicë votash dhe ka kuorumin e nevojshëm për marrjen e një vendimi nëse së paku tre anëtarë të Bordit janë të pranishëm por duhet të ketë tri (3) vota pro për të qenë vendimi i plotfuqishëm. Bordi paraqet qëndrimet e veta rreth çështjeve që trajtohen përmes vendimeve, të cilat merren në mbledhje të hapura dhe të njoftuara qysh më parë në faqen zyrtare të ZRRE-së.

Në fund të vitit 2022 Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji përbëhej nga anëtarët si në vijim:

Ymer Fejzullahu, Kryesues i Bordit

Selman Hoti, anëtar i Bordit

Izet Rushiti, anëtar i Bordit

Lutfije Dervishi, anëtare e Bordit

Gani Buçaj, anëtar i Bordit

Për qëllime të vendimmarrjes, në përputhje me autoritetin e dhënë sipas legjislacionit në fuqi, Bordi i ZRRE-së ka mbajtur takime të vazhdueshme, në të cilat është diskutuar lidhur me funksionimin e sistemit energjetik në Kosovë dhe janë marrë vendime adekuate si dhe aprovime/miratime të dokumenteve të nevojshme për sektorin.

Bordi i ZRRE-së deri në dhjetor të vitit 2022 ka mbajtur gjithsej 15 mbledhje publike, në të cilat janë marrë 193 vendime që kanë të bëjnë me:

- Monitorimin e tregut dhe aktiviteteve të sektorit të energjisë;

- Rregullimin e çmimeve;
- Licencimin e aktiviteteve të energjisë në Kosovë;
- Autorizimin e ndërtimeve të kapaciteteve të reja të gjenerimit të energjisë nga Burimet e Ripërtëritshme;
- Mbrojtjen e konsumatorëve;
- Aprovimin e rregullave, metodologjive dhe dokumenteve tjera të sektorit të energjisë, dhe
- Çështje të tjera në kuadër të përgjegjësisë të tij.

Të gjitha dokumentet e shqyrtuara dhe të miratuara fillimisht janë vënë në diskutim publik, ashtu siç parashihet me ligj, për të përfshirë të gjitha palët e involvuara në proceset e vendimmarrjes dhe janë të publikuara në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Për të gjitha aktivitetet, Bordi është mbështetur nga: Drejtori Menaxhues, Njësia administrative dhe pesë (5) departamente si në vijim:

- Departamenti ligjor dhe i licencimit (DLL)
- Departamenti i tregut të energjisë (DTE)
- Departamenti i tarifave dhe çmimeve (DTÇ)
- Departamenti për mbrojtjen e konsumatorëve (DMK)
- Departamenti për energji termike dhe gaz natyror (DETG)

Bordi i ZRRE-së ka përkrahur ngritjen profesionale të stafit të ZRRE-së duke synuar specializimin e punonjësve në profilet përkatëse në kuadër të përgjegjësisë të tyre, përmes trajnimeve të ndryshme të organizuara brenda dhe jashtë vendit.

2.2 Struktura organizative dhe burimet njerëzore

Rregullatori është i organizuar në përputhje me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë (Kreu II i Ligjit) dhe Manualin e Operimeve të Rregullatorit. Bordi i Rregullatorit sipas përgjegjësisë të përcaktuara me ligj kryen aktivitete si në vijim:

- Miraton politikat rregullative dhe operacionale të Rregullatorit;
- Organizon dhe mbikëqyr punën e Rregullatorit;
- Mbikëqyr zbatimin e buxhetit dhe menaxhimin financiar të Rregullatorit dhe miraton raportet dhe deklaratat financiare të saj;
- Organizon procedurat e rekrutimit dhe mbikëqyr punën e personelit të punësuar nga Rregullatori;
- Miraton nivelet e kompensimit dhe kushtet tjera të punësimit, për të punësuarit e Rregullatorit;
- Harton dhe miraton akte nënligjore që janë të nevojshme për zbatimin e Ligjit për Rregullatorin e energjisë.

Struktura organizative e Rregullatorit është e përcaktuar nga Bordi i Rregullatorit bazuar në përgjegjësitë dhe detyrat që parashihen në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084. Struktura bazë përbëhet nga Drejtori menaxhues, Zyrtarja për asistencë të Bordit, Zyrtarja për marrëdhënie me

publikun, pesë departamente dhe Njësia e administratës (NJA) të cilat janë themeluar në pajtim me detyrat operacionale të Rregullatorit.

2.2.1 Drejtori Menaxhues

Drejtori menaxhues i koordinon aktivitetet midis Bordit dhe stafit profesional dhe administrativ; është përgjegjës për implementimin e të gjitha vendimeve të Bordit të Rregullatorit, në mënyrë aktive informon dhe këshillon Bordin për zhvillimet në sektorin Energjetik, mbështet Bordin e Rregullatorit për të siguruar që të gjitha aktivitetet e Rregullatorit janë kryer në përputhje me ligjet, rregulloret dhe politikat e Rregullatorit si dhe mbikëqyrë punën e departamenteve të Rregullatorit. Drejtori menaxhues i raporton dhe i përgjigjet drejtpërdrejt Bordit dhe ushtron detyrën nën drejtimin dhe udhëzimet e Bordit, në pajtim me Manualin e operimeve të Rregullatorit.

2.2.2 Departamentet e Rregullatorit

Departamentet udhëhiqen nga udhëheqësit e departamenteve, të cilët organizojnë, kontrollojnë, planifikojnë, bashkëpunojnë, vlerësojnë stafin e tij/saj dhe mbajnë përgjegjësi për aktivitetet dhe përmbushjen e të gjitha detyrave të përcaktuara për punën e departamenteve. Udhëheqësi i departamentit është përgjegjës për delegimin e punëve të përditshme të stafit të departamentit.

Roli i anëtarëve të stafit të departamenteve është të kryejnë detyra, kurdo që është e nevojshme sipas kërkesave ligjore dhe përmes udhëheqësve të departamenteve i propozojnë në Bord. Në disa raste, anëtarët e stafit mund të autorizohen nga Bordi të kryejnë detyra të posaçme.

Anëtarët e stafit duhet të punojnë në bashkëpunim të ngushtë me udhëheqësin e departamentit dhe stafin tjetër profesional. Anëtari i stafit po ashtu duhet të ketë mundësi në ndjekjen e trajnimeve të disponueshme nga Rregullatori, për përmirësimin e aftësive dhe njohurive të tyre profesionale.

Departamenti ligjor dhe i licencimit (DLL)

Departamenti ligjor dhe i licencimit është përgjegjës për hartimin e legjislacionit sekondar, vlerësimin e aplikacioneve për licencim të ndërmarrjeve të energjisë, vlerësimin e aplikacioneve për dhënien e autorizimeve për ndërtim të kapaciteteve të reja. Ky departament gjithashtu bën mbikëqyrjen dhe monitorimin e aktiviteteve të të licencuarve.

Departamenti i tregut të energjisë (DTE)

Departamenti i tregut të energjisë është përgjegjës për strukturën e tregut, monitorimin e performancës së pjesëmarrësve të tregut, vlerësimin dhe analizën e të dhënave në sektorin e energjisë. Departamenti gjithashtu monitoron konkurrencën dhe sjelljen e pjesëmarrësve në treg në mënyrë objektive, transparente dhe jo-diskriminuese.

Departamenti i tarifave dhe çmimeve (DTÇ)

Departamenti i tarifave dhe çmimeve është përgjegjës për vlerësimin e aplikacioneve tarifore të ndërmarrjeve të licencuara, monitoron realizimin e shpenzimeve operative dhe kapitale përmes shqyrtimeve tarifore, ndërmerr të gjitha masat që tarifatat të jenë kosto - reflektive, të arsyeshme, jo-diskriminuese, të bazuara në kritere objektive, si dhe të vendosura në mënyrë transparente, duke marrë në konsiderim përballueshmërinë dhe mbrojtjen e konsumatorëve.

Departamenti për mbrojtjen e konsumatorëve (DMK)

Departamenti për mbrojtjen e konsumatorëve është përgjegjës për shqyrtimin dhe zgjidhjen e ankesave dhe kontesteve ndërmjet konsumatorëve dhe ndërmarrjeve për energji, operatorëve të sistemit dhe ndërmarrjeve energjetike, si dhe ndërmjet dy ndërmarrjeve energjetike. Gjatë kryerjes së detyrave dhe përgjegjësisë, ky departament bashkëpunon me të gjitha institucionet dhe organizatat, të cilat në mënyrë legjitime i përfaqësojnë konsumatorët.

Departamenti për energji termike dhe gaz natyror (DETG)

Departamenti për energji termike dhe gaz natyror është përgjegjës për shqyrtimin dhe implementimin e strategjive, standardeve të performancës dhe praktikave tjera operacionale, që kanë të bëjnë me këta sektorë. Ky departament kryen monitorimin e ndërmarrjeve të licencuara përmes mbledhjes, analizës dhe vlerësimit të të dhënave dhe informatave përkatëse, e gjithashtu kontribuon në zhvillimin e sistemeve raportuese të ndërmarrjeve të ngrohjes qendrore duke u fokusuar në elementet tekniko-teknologjike dhe në integrimin e masave nxitëse dhe caqeve për eficiencë. Po ashtu bashkëpunon me departamentet tjera të Rregullatorit duke dhënë mbështetjen dhe ekspertizën teknike për çështjet e ndërlidhura me energjinë termike dhe gazin natyror.

Njësia e administratës (NJA)

Njësia e administratës mbështet funksionimin e Rregullatorit, organizon rekrutimin efikas të stafit të Rregullatorit, koordinon trajnimet e stafit të Rregullatorit, furnizimin me pajisje të zyrës dhe mirëmbajtjen e tyre, ndihmon në rregullimin e zyrës, duke e bërë atë të përshtatshme për punë për të gjithë stafin e Rregullatorit.

Personeli i ZRRE-së është i strukturuar në departamente organizative të përcaktuara në bazë të veprimtarive të veçanta operacionale dhe administrative.




Fig. 2.1 Skema organizative e Rregullatorit

Numri i përgjithshëm i të punësuarve, deri në fund të 31 dhjetorit 2022, është 26 punonjës. Në këtë numër përfshihen 5 anëtarët e Bordit dhe 21 anëtarë të personelit të punësuar brenda departamenteve profesionale dhe njësisë së administratës. Struktura arsimore e personelit të ZRRE-së përbehet nga njëmbëdhjetë inxhinierë, tetë ekonomistë, pesë juristë dhe një punonjës me arsim tjetër universitar dhe një punonjës me arsim të mesëm.

Përshkrimi i shkurtër i strukturës organizative me vendet e punës në vitin 2022 është dhënë në tabelën më poshtë.

Tab. 2.1 Struktura organizative

Pozitat e vendeve të punës	Pozitat e planifikuara	Punësuar	Vendet e lira
Bordi i ZRRE-së	5	5	0
Drejtor menaxhues	1	1	0
Zyrtare për marrëdhënie me publikun	1	0	1
Zyrtare për asistencë të Bordit	1	1	0
Njësia e administratës			
Udhëheqëse e njësisë së administratës			
Zyrtar kryesor financiar			
Menaxhere e prokurimit			
Zyrtare e administratës			
Zyrtar për menaxhimin e të dhënave	9	9	0
Ekspert për zhvillim të bazës së të dhënave			
Përkthyes i gjuhës angleze			
Recepionist			
Mirëmbajtës/Vozitës			
Departamenti ligjor dhe i licencimit (DLL)			
Udhëheqës i dpt. ligjor dhe të licencimit			
Ekspert për çështje ligjore dhe të monitorimit	3	3	0
Analiste për monitorim të licencave			
Departamenti i çmimeve dhe Tarifave (DTC)			
Udhëheqës i dpt. për çmime dhe tarifa			
Ekspert ekonomik për çështje rregullative dhe të tarifave	4	2	2
Analist për tarifa dhe çmime			
Analist për strukturë tarifore			
Departamenti i tregut të energjisë (DTE)			
Udhëheqës i dpt. për treg të energjisë			
Analiste për furnizim me energji dhe strukturë të tregut	4	3	1
Analist për sisteme elektroenergjetike			
Analist për monitorim të tregut			
Departamenti për gaz dhe energji termike (DGET)			
Udhëheqës i dpt. për energji termike dhe gaz			
Analiste për energji termike	2	1	1
Departamenti për mbrojtje të konsumatorëve (DMK)			
Udhëheqës i dpt. për mbrojtje të konsumatorëve			
Zyrtar për mbrojtje të konsumatorëve	3	1	2
Analist për përmbushje të standardeve			
Gjithsej	33	26	7

Personeli i Rregullatorit është një ekip ekspertësh me performancë të dëshmuar në fushat e përgjegjësi qe ata mbulojnë.

2.3 Financimi i Rregullatorit

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) gëzon statusin e "agjensionit të pavarur". Kushtetuta e Republikës së Kosovës parashikon që agjencitë e pavarura, janë institucione të krijuara nga Kuvendi bazuar në ligjet përkatëse që rregullojnë krijimin, funksionimin dhe kompetencat e tyre. Agjencitë e pavarura ushtrojnë funksionet e tyre në mënyrë të pavarur nga çdo organ ose autoritet tjetër në Republikën e Kosovës. Kjo do të thotë që ZRRE-ja duhet të ketë pavarësi të plotë në planifikimin dhe shpenzimin e buxhetit, gjegjësisht të hyrave të dedikuara të saj, të garantuara me Kushtetutë dhe legjislacionin në fuqi.

Çështja e pavarësisë financiare është rregulluar kryesisht nga Direktivat e BE-së, të cilat parashikojnë që shtetet anëtare duhet të sigurojnë që autoritetet rregullative ose agjencitë e pavarura duhet të jenë në gjendje të marrin vendime autonome në mënyrë të pavarur nga çdo organ politik, përfshirë mënyrat përmes të cilave ato ushtrojnë mandatet e tyre, punonjësit që duhet të rekrutojnë etj. Kjo do të thotë që Zyra e Rregullatorit për Energji duhet të gëzojë pavarësi financiare, e cila mundësohet përmes inkasimit të të hyrave vetanake dhe zbatimit të legjislacionit në fuqi.

Legjislacioni aktual parashikon qartë se të hyrat e ZRRE-së janë "të hyra të dedikuara", dhe, në lidhje me këtë, ZRRE ka të drejtë të mbledhë "të hyra të dedikuara" nga burime të caktuara, të cilat në rastin e ZRRE-së përfshijnë taksat e licencimit. Kjo gjithashtu parashikohet në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i cili përcakton se "të ardhurat e dedikuara" janë ato të ardhura që rrjedhin nga një burim i caktuar i të ardhurave, dhe këto agjenci, vetëm në rastet kur këto të ardhura janë të pamjaftueshme, mund të kërkojnë ndarje buxhetore plotësuese nga buxheti i Republikës së Kosovës, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Në bazë të nenit 24 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, ZRRE-ja mbledh të hyra nga:

- Taksat fillestare dhe vjetore të licencimit;
- Taksat nga aplikacionet për lëshimin dhe modifikimin e licencave;
- Taksat për lëshimin e certifikatave të origjinës;
- Taksa për shqyrtim/rishikim të aplikacioneve për autorizim për ndërtimin e kapaciteteve të reja.

3 AKTIVITETET E ZYRËS SË RREGULLATORIT PËR ENERGJI

3.1 Licencimi i aktiviteteve të energjisë

Të gjitha palët që duan të operojnë në kryerjen e aktiviteteve të energjisë në Kosovë për prodhim, shpërndarje, furnizim, tregtim etj., duhet të pajisen me Licencë nga Zyra e Rregullatorit për Energji. Se deri në sa MW apo kW nevojitet licenca, kjo çështje është e përshkruar më në detaje edhe në legjislacionin në fuqi, më konkretisht në Nenin 28 paragrafin 2 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe poashtu në Nenin 3 paragrafin 1 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë (Rregulla ZRRE/Nr.07/2017, datë 31.03.2017).

Bazuar në dispozitat ligjore të legjislacionit në fuqi, deri më tani Rregullatori ka lëshuar licenca për këto aktivitete: prodhimin e energjisë elektrike; prodhimin e energjisë termike; bashkëprodhimin e energjisë elektrike dhe termike; transmetimin e energjisë elektrike përfshirë operimin e sistemit të transmetimit; shpërndarjen e energjisë elektrike duke përfshirë operimin e sistemit të shpërndarjes; shpërndarjen e energjisë termike; furnizimin me energji elektrike dhe energji termike, duke përfshirë transitin, importin dhe eksportin e energjisë elektrike; furnizimin me shumicë (tregtimin) e energjisë elektrike; si dhe operimin e tregut të energjisë elektrike.

Siç u cek në paragrafin e sipërpërmendur, ka raste në të cilat nuk kërkohet të lëshohet licencë nga Zyra e Rregullatorit për Energji, për disa aktivitete të cilat nuk kanë ndikim shumë të madh në sistemin elektroenergjetik të Kosovës. Pra aktivitete të cilat nuk kanë nevojë për licencë janë:

- prodhimi i energjisë elektrike në lokacionin energjetik me kapacitet që nuk tejkalon 5 MW;
- prodhimi i energjisë termike të prodhuar nga ngrohoret për konsum vetanak apo me kapacitet që nuk tejkalon 1 MW;
- prodhimi i energjisë elektrike për konsum vetanak, ku stabilimenti i prodhimit apo konsumatorët e energjisë elektrike nuk lidhen në sistemin e transmetimit apo shpërndarjes.

Përkundër që Rregullatori nuk lëshon Licencë për aktivitete në pikat e sipërpërmendura, megjithatë Rregullatori është i përfshirë në këto aktivitete e të cilat nuk mund të ndërtohen nëse nuk marrin Autorizim për Ndërtim të kapacitetit gjenerues, të lëshuar nga Rregullatori.

Që nga themelimi e deri më tani Rregullatori ka licencuar rreth nëntëdhjetë (90) ndërmarrje për aktivitete të ndryshme të energjisë dhe me kohëzgjatje të ndryshme të licencës, varësisht nga jetëgjatësia e aseteve, ku rreth gjashtëdhjetë (60) prej tyre vazhdojnë të jenë aktive në tregun e energjisë në Kosovë, të cilat janë nën monitorimin e Rregullatorit të Energjisë për aktivitetin e tyre.

Edhe gjatë vitit 2022 sikurse edhe viteve paraprake, interesimi i palëve për licencim nuk ka munguar, mirëpo krahasuar me vitin 2021 intensiteti i palëve për të marrë licencë për aktivitete të energjisë ka qenë në rënje, respektivisht numri i licencave të trajtuara, në proces apo të lëshura ka qenë shumë më i ulët rreth 43%.

Fokusi i licencave të lëshuara nga Rregullatori po ashtu ka qenë për aktivitete të ndryshme si furnizimi me energji elektrike në Kosovë, pasuar nga licencimi i aktivitetit të furnizimit me shumicë (tregtisë) të energjisë elektrike, vazhdim licence etj.

3.1.1 Licencimi i aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike

Bazuar në Nenin 29 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, aktiviteti i prodhimit të energjisë elektrike nuk mund të kryhet pa pasur licencë të lëshuar nga Rregullatori për gjeneratorët që janë me kapacitet më të madh se 5 MW.

Kërkesat për licencim të aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike në Kosovë, kanë qenë gjithnjë aktuale, përfshirë edhe vitin 2022, ku si rrjedhojë e kësaj, Rregullatori në vazhdimësi ka pranuar aplikacione për licencim të aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike (nga linjiti, era, uji, solare, biomasë etj.).

Rregullatori përveç që ka licencuar gjeneratorët të cilët kanë qenë të ndërtuar para themelimit të Rregullatorit, po ashtu ka licencuar edhe gjeneratorë të tjerë të rinj të cilët janë ndërtuar përmes Procedurës së Autorizimit për Ndërtim të Kapaciteteve të Reja të udhëhequr nga Rregullatori. Përkundër kërkesave për lëshim të licencave të përkohshme, gjatë këtij viti Rregullatori nuk ka lëshuar licenca të përkohshme për prodhim të energjisë elektrike për hidrocentralet, duke zbatuar kështu legjislacionin në fuqi.

Më poshtë janë të paraqitura në tabelë të dhënat e ndërmarrjeve që janë pajisur me Licencë për prodhim të energjisë elektrike, u është vazhduar licenca dhe atyre që janë në proces të licencimit të aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike.

Tab. 3.1 Ndërmarrjet që janë licencuar, u është vazhduar licenca dhe janë në proces të licencimit të aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike

Nr.	Emri i ndërmarrjes	Përshkrimi i aktivitetit të Licencuar	Numri i licencës	Adresa, selia e të licencuarit	Vlefshmëria e licencës
1	Matkos Group Sh.P.K. (HC Sharri)	Prodhim i energjisë elektrike (nga uji)	ZRRE/Li_74/21	Rr.Shpetim Robaj, Prishtine, Republika e Kosoves (selia Shterpce), Republika e Kosovës.	23.02.2021 - në proces të licencimit 12.11.2020 - 11.11.2059 - Lëshim Licence 15.10.2021-Pezulluar me Aktvendim/ Aktgjykim të Gjykatës Kompetente. 17.11.2022-Në fuqi, pas nxjerrjes së Aktgjykimit në rastin nr.KI202/21
2	"KelKos Energy" SH.P.K (HC Deçani)	Prodhim i energjisë elektrike (nga uji)	ZRRE/Li_49/20	Rr. Demë Ali Pozhari, Nr. 41, 51000 Deçan, Republika e Kosovës	12.11.2020 - 11.11.2059 - Lëshim Licence 15.10.2021-Pezulluar me Aktvendim/ Aktgjykim të Gjykatës Kompetente. 17.11.2022-Në fuqi, pas nxjerrjes së Aktgjykimit në rastin nr.KI202/21
3	"KelKos Energy" SH.P.K (HC Belaje)	Prodhim i energjisë elektrike (nga uji)	ZRRE/Li_50/20	Rr. Demë Ali Pozhari, Nr. 41, 51000 Deçan, Republika e Kosovës	12.11.2020 - 11.11.2059 - Lëshim Licence 15.10.2021-Pezulluar me Aktvendim/ Aktgjykim të Gjykatës Kompetente. 17.11.2022-Në fuqi, pas nxjerrjes së Aktgjykimit në rastin nr.KI202/21
4	"KelKos Energy" SH.P.K (HC Lumbardhi II)	Prodhim i energjisë elektrike (nga uji)	ZRRE/Li_64/18 ZRRE/Li_64/20	Rr. Demë Ali Pozhari, Nr. 41, 51000 Deçan, Republika e Kosovës	14.10.2019 - 13.10.2020 Licencë e përkohshme 14.10.2019 - në proces të licencimit ...

Matkos Group Sh.P.K. (HC Sharri) – ka aplikuar në Rregullator për licencë të prodhimit të energjisë elektrike nga Hidrocentrali Sharri me datë 23 shkurt 2021, për kapacitet të instaluar prej **6.453MW**. Ky hidrocentral është ende në proces të licencimit, mirëpo duke marr parasysh që ndërmarrja ende nuk ka plotësuar kushtet mjedisore të cilat kërkohen me legjislacionin në fuqi, kjo ndërmarrje mbetet ende në proces të licencimit, përkundër që hidrocentrali është ndërtuar sipas procedurës së autorizimit të udhëhequr nga Rregullatori.

Kelkos Energy SH.P.K (HC Deçani, HC Belaje dhe HC Lumbardhi II) – kjo ndërmarrje e cila kishte plotësuar të gjitha kërkesat për licencim, sipas udhëzimeve të Rregullatorit, ishte licencuar nga Bordi i Rregullatorit për prodhim të energjisë elektrike, për dy (2) njësi prodhuese nga: Hidrocentrali “Deçani” me kapacitet prej **8.06 MW** dhe Hidrocentrali “Belaje” me kapacitet prej **9.8 MW**, ndërsa Hidrocentrali “Lumbardhi II” me kapacitet prej **6.2 MW**, në mungesë të plotësimit të kushteve të cilat kërkohen sipas legjislacionit në fuqi, nuk kishte arritur të pajiset me licencë të prodhimit të energjisë elektrike, duke mbetur kështu në proces të licencimit që nga 21 dhjetor 2018.

Përkundër licencimit të këtyre dy njësive (HC Deçani dhe HC Belaje) nga Bordi i Rregullatorit për periudhë katërdhjetë (40) vjeçare 12.11.2020-11.11.2059 (përfshirë licencën e përkohshme një vjeçare), këto Hidrocentrale të ndërmarrjes Kelkos Energy Sh.P.K dalin nga operimi që nga data 15 tetor të vitit 2021, si pasojë e pezullimit të operimit të tyre, me Aktvendim rrjedhimisht me Aktgjykim të Gjykatave kompetente të Kosovës dhe mbesin jashtë operimit deri me datë 17.11.2022 pas nxjerrjes së Aktgjykimit nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (shih rastin nr.KI202/21¹).

3.1.2 Licencimi i aktivitetit të furnizimit me energji elektrike

Kërkesa për licencim të aktivitetit të furnizimit me energji elektrike në Kosovë gjithnjë po shkon drejt rritjes. Pra ngjashëm si edhe në vitin 2021 edhe këtë vit pas plotësimit të kushteve për licencim janë licencuar nga Bordi i Rregullatorit pesë (5) ndërmarrje të energjisë, ndërsa një mbetet në proces të licencimit.

Si rezultat i lidhjes së memorandumit “Memorandum Mirëkuptimit për Njohje Reciproke të Licencave për Veprimtarinë e Tregtimit dhe Furnizimit të Energjisë Elektrike Ndërmjet Autoriteteve Kombëtare Rregullatore të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë” (MiM) të datës 07 dhjetor 2021 në mes të Zyrës së Rregullatorit për Energji dhe Entit Rregullator të Energjisë së Republikës së Shqipërisë, për Njohjen Reciproke të Licencave, dy (2) nga licencat për furnizim me energji elektrike janë njohur nga Bordi i Rregullatorit të Kosovës, mbi bazën e këtij Memorandumi.

¹ <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=66625>

Tab. 3.2 Ndërmarrjet që janë licencuar, u është vazhduar licenca dhe janë në proces të licencimit për aktivitet të furnizimit me energji elektrike gjatë vitit 2022

Nr.	Emri i ndërmarrjes	Përshkrimi i aktivitetit të Licencuar	Numri i licencës	Adresa, selia e të licencuarit	Vlefshmëria e licencës
1	"FUTURE ENERGY TRADING AND EXCHANGE DYNAMICS" SH.P.K.	Furnizim me energji elektrike		Lagjja Kalabria, A1, CII, Nr.25, Prishtinë, Republika e Kosovës	13.04.2018 - 12.04.2023 - Lëshim Licence 12.09.2022 - në proces për vazhdim licence...
2	MCM COMMODITIES SH.P.K	Furnizim me energji elektrike	ZRRE/Li_78/21	Nëna Terezë, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës	31.03.2022-30.03.2027 Lëshim Licence
3	Društvo Elektrosever D.O.O.	Furnizim me energji elektrike	ZRRE/Li_70/20	Filipa Visnjica bb, Mitrovicë e Veriut, Republika e Kosovës	24.06.2022-23.06.2027 - Lëshim Licence
4	ETMT ENERGY SH.P.K.	Furnizim me energji elektrike	(ZRRE/Li_84/22)	Nëna Terezë, Str. 22 b., Nr.5, Prishtinë, Republika e Kosovës	12.10.2022-11.10.2027 - Lëshim Licence
5	NOA ENERGY TRADE SHPK Dega në Kosovë	Furnizim me energji elektrike		Rruga Rexhep Luci, 5, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës	Në fuqi nga 02.12.2021, për periudhë prej 5 vitesh. (E NJOHUR SIPAS PARIMIT TË RECIPROCITETIT me datë 26.05.2022)
6	EZ 5 ENERGY SHPK -Dega në Kosovë	Furnizim me energji elektrike		Rr.Kuvendi i Bujanit, Nr.10., 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës	Në fuqi nga 07.03.2019, për periudhë prej 5 vitesh. (E NJOHUR SIPAS PARIMIT TË RECIPROCITETIT me datë 13.07.2022)

FUTURE ENERGY TRADING AND EXCHANGE DYNAMICS SH.P.K. - është licencuar fillimisht nga Rregullatori në vitin 2018 për periudhë pesë (5) vjeçare për aktivitetin e furnizimit me energji elektrike, aktivitetin e furnizimit e ka filluar në vitin 2022.

Meqë licenca do ti skadonte në prill 2023, gjatë vitit 2022 kjo ndërmarrje ka aplikuar brenda afatit ligjor për vazhdim licence dhe ka dorëzuar dokumentet e nevojshme, të cilat janë proces të shqyrtimit në Rregullator.

MCM COMMODITIES SH.P.K – kjo ndërmarrje pas plotësimit të gjithë dokumentacionit, është licencuar nga Bordi i Rregullatorit për periudhë kohore poashtu prej pesë (5) vitesh, si në tabelën më sipër.

Društvo Elektrosever D.O.O. – e cila kishte aplikuar gjatë vitit 2021 për komuna të caktuara në Veri të Kosovës, është licencuar këtë vit nga Bordi i Rregullatorit për aktivitetin e furnizimit me energji elektrike për periudhë prej pesë (5) vitesh.

Për dallim nga licencat tjera të furnizimit me energji elektrike, të cilat kanë licencë për tërë territorin e Republikës së Kosovës, kësaj ndërmarrjeje licenca i është lëshuar për katër (4) Komunat me shumicë serbe të Republikës së Kosovës dhe atë Mitrovica Veriore, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviç , ashtu siç është përcaktuar me Nenin 5 të “Marrëveshjes për Energjinë” të vitit 2013. Dispozitivi i Vendimit

V_1515_2022² i datës 24 qershor 2022 mbi lëshimin e licencës parasheh edhe afatet e përmbushjes së kushteve nga i Licencuari, para hyrjes në operim.

Duhet theksuar se në dispozitivin e Vendimit janë përfshirë obligimet që “Drustvo Elektrosever” D.O.O dhe akterët tjerë të përfshirë me Marrëveshje dhe Konkluzë, duhet ti përmbushin brenda afateve të përcaktuara si në dispozitiv, e të cilat obligime janë pjesë përbërëse e “Marrëveshjes për Energji” e vitit 2013 dhe “Konkluzioneve të Lehtësuesit të BE mbi Implementimin e Marrëveshjes për Energji të vitit 2013” të vitit 2015, dhe “Udhërrëfyesit të Zbatimit të Marrëveshjeve të Energjisë”, të datës 21.06.2022. Pra licencimi i kësaj ndërmarrjeje vjen si rezultat edhe i marrëveshjeve ndërkombëtare dhe bisedimeve të zhvilluara në Bruksel.

Edhe afateve të përcaktuara në Vendimin V_1515_2022 për licencim, gjatë këtij viti nuk janë arritur të plotësohen të gjitha pikat e përcaktuara në dispozitiv të Vendimit, dhe si pasojë i Licencuari mbetet jashtë operimit deri në plotësimin e tyre.

ETMT ENERGY SH.P.K – kjo ndërmarrje pas plotësimit të gjithë dokumentacionit, është licencuar nga Bordi i Rregullatorit për periudhë kohore prej pesë (5) vitesh.

NOA ENERGY TRADE SHPK Dega në Kosovë – e licencuar në Shqipëri për aktivitet të furnizimit me energji elektrike, e cila të njëjtin aktivitet me po të njëjtën licencë mund ta kryej edhe në Kosovë, pasi që Bordi i Rregullatorit i ka njohur licencën mbi bazën e Parimit të Reciprocitetit, të cilës i ka paraprirë Memorandumit të Mirëkuptimit me Shqipërinë. Afati i kryerjes së aktivitetit nga kjo ndërmarrje është ai i përcaktuar në licencën e lëshuar nga Enti Rregullator i Republikës së Shqipërisë.

EZ 5 ENERGY SHPK -Dega në Kosovë – poashtu, e licencuar në Shqipëri për aktivitet të furnizimit me energji elektrike, e cila të njëjtin aktivitet me po të njëjtën licencë mund ta kryej edhe në Kosovë, pasi që Bordi i Rregullatorit i ka njohur licencën mbi bazën e Parimit të Reciprocitetit, ngjashëm si edhe ndërmarrjes së sipërpërmendur NOA ENERGY TRADE SHPK Dega në Kosovë.

3.1.3 Licencimi i aktivitetit të furnizimit me shumicë (tregtimit) të energjisë elektrike

Ngjashëm si edhe në vitin paraprak, edhe këtë vit Rregullatori ka pranuar një numër jo të vogël të aplikimeve për licencim të aktivitetit të furnizimit me shumicë (tregtimit) të energjisë elektrike, ndonëse me intensitet më të ulët, për dallim nga vitet paraprake (përjashto 2021) ku aplikimi, respektivisht licencimi i këtij aktiviteti kishte pasur rënje.

Sikurse edhe te aktiviteti i furnizimit me energji elektrike, edhe te ky aktivitet përveç licencimit të aktivitetit në pajtim me Rregullën për Licencim të Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë dhe legjislacionin tjetër në fuqi, ka pasur kërkesa, respektivisht licencime mbi bazën e parimit të njohjes reciproke të licencave.

Ligji për energjinë elektrike parasheh që licencat e lëshuara për tregtimin e energjisë elektrike në Palët tjera Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë duhet të njihen në Kosovë. Furnizuesit e tillë të licencuar do të kenë të drejtë të tregtojnë energjinë elektrike pa pasur nevojë për licencë shtesë. Tregtarët dhe furnizuesit e regjistruar në një Palë tjetër të Komunitetit të Energjisë kanë të drejtë

²https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Vendimet/Vendimet%202022/V_1515_2022_Vendim_Drustvo%20Elektrosever.pdf

të marrin pjesë në tregun e energjisë elektrike, sipas parimit të reciprocitetit dhe në përputhje me rregullat e aplikueshme të tregut, rregullat e balancimit dhe rregullat fiskale.

Lidhur me këtë Rregullatori ka amendamentuar edhe Rregullën për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, Rregulla ZRRE/Nr.02/2022³ në të cilën përveç tjerash, sa i përket parimit të reciprocitetit parashihet që për aq sa e lejon legjislacioni në fuqi i Republikës së Kosovës nuk do të kërkohet aplikimi për licencim për Furnizim me shumicë (tregtim) me energji elektrike dhe Furnizim me energji elektrike, në rast se një ndërmarrje ka një licencë të lëshuar nga një autoriteti Rregullator i një vendi tjetër Palë Kontraktore e Komunitetit të Energjisë/një shteti Anëtar i Bashkimit Europian, ose një vendi tjetër me të cilin është nënshkruar një marrëveshje dypalëshe për njohjen reciproke të licencave ndërmjet Rregullatorit dhe autoritetit përkatës Rregullator, si dhe me kusht që të dorëzojnë në Rregullator dëshmitë që parashihen në këtë rregull.

Tab. 3.3 Ndërmarrjet që janë licencuar, u është vazhduar licenca apo janë në proces të licencimit për aktivitet të furnizimit me shumicë (tregti) të energjisë elektrike gjatë vitit 2022

Nr.	Emri i ndërmarrjes	Përshkrimi i aktivitetit të Licencuar	Numri i licencës	Adresa, selia e të licencuarit	Vlefshmëria e licencës
1	Interenergo d.o.o-Kosova SH.P.K.	Furnizim me shumicë (tregti) të energjisë elektrike	(ZRRE/Li_56/16)	Sali Çeku gogaj Building, app.14, Deçan, Republika e Kosovës	27.02.2017-26.02.2022 - Lëshim Licence 27.02.2022-26.02.2027- Vazhdim Licence
2	MFT Energy Kosoco L.LC (ZRRE/Li_86/22)	Furnizim me shumicë (tregti) të energjisë elektrike		St.Mujo Ulqinaku, NO.5,AP.10, Qyteza Pejton, Prishtinë, Republika e Kosovës	12.11.2022-11.11.2027 - Lëshim Licence
3	SONEL 888 LTD Branch in Kosovo (ZRRE/Li_85/22)	Furnizim me shumicë (tregti) të energjisë elektrike		Ali Vitia BII-Office Administrata K.III/3/1, Prishtinë, Republika e Kosovës.	12.11.2022-11.11.2027 - Lëshim Licence
4	NRG power Shpk Dega në Kosovë (emri tregtar NRG Power Shpk)	Furnizim me shumicë (tregti) të energjisë elektrike		Rr.Garibaldi Nr. 5/9, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës	Në fuqi nga 13.07.2022, për periudhë prej 5 vitesh. (E NJOHUR SIPAS PARIMIT TË RECIPROCITETIT me datë 29.12.2022)

Nga tabela më sipër shihet se këtë vit Rregullatori ka lëshuar dy (2) licenca për furnizim me shumicë (tregti) të energjisë elektrike, ka vazhduar një (1) të tillë dhe poashtu sipas parimit të reciprocitetit dhe Memorandumit të Mirëkuptimit me Entin Rregullator të Shqipërisë, ka njohur një (1) licencë.

3.1.4 Licencimi i aktivitetit të prodhimit të energjisë termike

Sikurse aktivitetet e energjisë elektrike, Rregullatori është kompetent për licencimin edhe të aktiviteteve të energjisë termike. Duke marr parasysh se licencimi i ndërmarrjeve të energjisë për aktivitete të ndryshme të energjisë elektrike dhe termike ka filluar në Kosovë që nga viti 2006 edhe afati i shumë licencave ka skaduar. Legjislacioni në fuqi lejon vazhdim të afatit të licencës, në rast se

³ https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Licencat/2017.03.31_2022_Amendament_Rregulla_per_Licencimin_e_Aktiviteteve_te_Energjise_ne_Kosove.ALB.pdf

ndërmarrja aplikon gjashtë (6) muaj para skadimit të afatit të licencës. Shumë licencave të energjisë termike u ka skaduar afatit i vleshmërisë së licencës gjatë vitit 2021 dhe ato që kanë plotësuar kushtet veç u është vazhduar licenca, pas sjelljes së dokumentacionit të nevojshëm për aktivitetin relevant.

Në tabelën më poshtë janë paraqitur ndërmarrjet të cilat kanë aplikuar për vazhdim të licencave për prodhim të energjisë termike dhe bashkëprodhim të energjisë termike (nga biomasa), ku njëra është me seli në Prishtinë dhe tjetra me seli në Gjakovë.

Tab. 3.4 Ndërmarrjet që janë licencuar, u është vazhduar licenca apo janë në proces të licencimit për aktivitet të prodhimit të energjisë termike

Nr.	Emri i ndërmarrjes	Përshkrimi i aktivitetit të Licencuar	Numri i licencës	Adresa, selia e të licencuarit	Vlefshmëria e licencës
1	Ngrohtorja e Qytetit Sh.A	Prodhim i energjisë termike (nga biomasa)	ZRRE/Li_75/21	Rezina, Gjakovë, Republika e Kosovës	19.11.2021-18.11.2051- Lëshim Licence (energji termike nga biomasa) 26.02.2021 - në proces të licencimit për bashkëprodhim
2	Ngrohtorja e Qytetit "Termokos" Sh.A	Prodhim i energjisë termike (nga mazuti)	ZRRE/Li_10/17	Rr "28 Nëntori" pn-Dardani Prishtinë, Republika e Kosovës	23.03.2021 - në proces të licencimit...

Ngrohtorja e Qytetit Sh.A – pra nga tabela më lartë shihet se kësaj ndërmarrjeje me seli në Gjakovë, i është lëshuar licenca për prodhim të energjisë termike nga biomasa për periudhë kohore prej tridhjetë (30) vitesh. Lëshimi i kësaj licence për prodhim të energjisë nga biomasa (si burim i ripërtërishëm i energjisë) është bërë për herë të parë në Kosovë nga Bordi i Rregullatorit, pas plotësimit të kushteve të përcaktuara për vazhdim licence të këtij aktiviteti. Ndërtimi i këtij gjeneratori është përcjellur dhe ndërtuar përmes procedurës së autorizimit të udhëhequr nga Rregullatori, ngjashëm si edhe ndërtimi i gjeneratorëve tjerë për prodhim të energjisë nga burime të ripërtërishme (era, uji etj.) E njëjta ndërmarrje ka aplikuar edhe për bashkëprodhim të energjisë elektrike me atë termike, dhe mbetet në proces të licencimit deri marrjen e lejes mjedisore dhe plotësimin e kushteve tjera të nevojshme siç janë matjet e emitimeve të gazrave.

Ngrohtorja e Qytetit "Termokos" Sh.A – e vetmja ndërmarrje në kryeqytet për prodhim të energjisë termike nuk ka arritur të plotësoj kushtet për vazhdim licence për prodhim të energjisë termike (nga mazuti) pavarësisht që ka aplikuar brenda afatit ligjor për vazhdim të kësaj licence gjatë vitit 2021, dhe si rrjedhojë mbetet në proces deri në plotësimin e të gjitha kërkesave ligjore, sipas legjislacionit në fuqi. Vlenë të ceket se kjo ndërmarrje furnizohet sipas Marrëveshjes për Furnizim me Energji Termike nga TC Kosova B e cila i transporton energjinë termike përmes rrjetit të transportit të energjisë termike. Licenca sipas së cilës kryhet ky aktivitet është Licenca për Bashkëprodhim të Energjisë Elektrike me atë Termike, të cilën Bordi i Rregullatorit i lëshuar KEK-ut, TC Kosovës B gjatë vitit 2017 me afat vlerfshmie deri në vitin 2026.

3.2 Monitorimi i ndërmarrjeve të energjisë

Monitorimi/mbikqyrja e ndërmarrjeve të energjisë është një ndër kompetencat kryesore të Rregullatorit të energjisë, përgjegjësi e cila parashihet në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, e posaçërisht me Kreun XII, Ligjin për Energjinë Elektrike dhe legjislacionin sekondar.

Kështu, Rregullatori, si edhe viteve tjera edhe këtë vit ka vazhduar me monitorimin e ndërmarrjeve të licencuara për aktivitetet e energjisë, duke u siguruar nëse ndërmarrjet janë duke vepruar në pajtueshmëri me kushtet e licencës, zbatimin e rregullave, akteve individuale dhe vendimeve tjera të lëshura nga Rregullatori apo legjislacioni tjetër në fuqi. Monitorimi bëhet duke kërkuar raporte dhe të dhëna nga të licencuarit, duke mbajtur takime, si dhe duke vizituar (monitoruar) të licencuarit, me apo pa paralajmërim.

Edhe gjatë vitit 2022, Rregullatori ka monitoruar ndërmarrjet e licencuara të energjisë dhe ndërmarrjet që janë në proces të ndërtimit përmes procedurës së autorizimit për ndërtim të kapaciteteve të reja.

ZRRE gjatë vitit 2022 në përputhje me kompetencat e dhëna me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, ka bërë monitorimin në lidhje me: blerjet e energjisë elektrike, pagesat dhe nominimet për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH); Furnizuesit me Energji Elektrike (KESCO); Operatorit të Sistemit të Transmisionit të Tregut (KOSTT); dhe Korporatës Elektroenergjetike të Kosovës (KEK), si dhe monitorimi ndaj OSSH lidhur me ndërprerjet e planifikuara dhe paplanifikuara të energjisë elektrike për muajt nëntor-dhjetor 2021.



Fig. 3.1 Raportimi i raporteve të monitorimit të të licencuarve para Bordit të ZRRE-së

ZRRE, në kuadër të monitorimit në lidhje me blerjet e energjisë elektrike pagesat dhe nominimet ka përgatitur Raportet me të gjeturat të cilin janë prezantuar Bordit të ZRRE-së për shqyrtim.

Bordi i ZRRE-së, ka shqyrtuar të gjeturat në Raportet e përgatitura nga ekspertët e ZRRE-së, dhe ka vendosur që Raportet e Monitorimit në lidhje me blerjet e energjisë elektrike pagesat dhe nominimet, t'iu dërgohen palëve për komentim.

Raportet e monitorimit u janë dërguar palëve për komentim ku janë obliguar që brenda 15 ditësh kalendarike të ofrojnë përgjigjet me shkrim lidhur me të gjeturat në Raportet përkatëse.

ZRRE pas pranimit të përgjigjeve ka vlerësuar komentet e dërguara nga KEDS SH.A. dhe KESCO lidhur me monitorimin e blerjeve të energjisë elektrike, pagesat dhe devijimet në nominimet e energjisë, ku ka vërtetuar se KEDS SH.A. dhe KESCO nuk ka mundur të kundërshtoi/argumentoj të gjeturat përmes Raporteve të Monitorimit lidhur me blerjet e energjisë elektrike, pagesat dhe nominimet, dhe në pajtim me dispozitat ligjore iu ka dërguar Njoftim lidhur me shkeljet e konstatuara për blerjet e energjisë elektrike, pagesat dhe nominimet nga KEDS SH.A. dhe KESCO.

ZRRE në përputhje me dispozitat e Nenit 57 paragrafi 7 i Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, Njoftimet e cekur më lartë i është dërguar KEDS dhe KESCO në mënyrë që tu mundësohet përgjigja me shkrim lidhur me shkeljet e bëra, brenda katërbëdhjetë (14) ditësh nga pranimi i këtij njoftimi.

ZRRE nga KEDS dhe KESCO ka pranuar përgjigjet me shkrim, në lidhje me shkeljet e konstatuara me Njoftimet e cekur më lartë, ku janë paraqitur në formë të shkruar arsyetimet në lidhje me shkeljet e konstatuara nga ZRRE, si dhe arsyetime tjera jashtë atyre të konstatuara përmes Njoftimeve të ZRRE-së.

ZRRE në mbledhjen e mbajtur me datë 16.11.2022, ka bërë vlerësimin dhe analizimin e përgjigjeve të paraqitura nga KEDS dhe KESCO dhe ka ardhur në përfundim se përgjigjet nuk i kontestojnë me asnjë argument, qoftë formal apo material shkeljet e evidentuara nga ana e ZRRE-së.

ZRRE përmes vendim V_1617_2022 Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH), i ka shqiptuar gjobën për shkak të shkeljeve ligjore të konstatuara për blerjet e energjisë elektrike, pagesat dhe nominimet në shumën prej 2,753,000€ (dy milion e shtatëqind e pesëdhjetë e tre mijë Euro).

Ndërsa përmes vendimit V_1618_2022 Furnizuesit me energji elektrike (KESCO) i ka shqiptuar gjobën për shkak të shkeljeve ligjore të konstatuara për blerjet e energjisë elektrike, pagesat dhe nominimet në shumën prej 8,475,000 € (tetë milion e katërqind e shtatëdhjetë e pesë mijë Euro).

ZRRE po ashtu me rastin e shqiptimit të gjobës ka vlerësuar edhe rrethanat rënduese, për faktin se qëllimi i këtij dënimi nuk është dëmtimi i ndërmarrjes, por përmirësimi i saj, që në veprimet e ardhshme në të mirë të sigurisë juridike të vetë të Licencuarit që të respektohen kushtet e Licencës dhe kërkesat ligjore të obligueshme në fuqi dhe të zbatueshme.

ZRRE për sa i përket shumës së gjobës, ka marr parasysh shkeljet e konstatuara, dhe në mënyrë komulative të të gjitha shkeljeve është propozuar gjoba bazuar në të hyrat që ndërmarrja ka akumuluar gjatë vitit fiskal paraprak, e që janë të bazuara në Raportin e Auditorit të Pavarur për Pasqyrat Financiare për Qëllime Specifike të Rregullatorit dhe të dërguara në ZRRE.

ZRRE gjithashtu ka kryer Monitorim ndaj Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH), lidhur me ndërprerjet e planifikuara dhe të paplanifikuara të energjisë elektrike për muajt nëntor-dhjetor 2021.

ZRRE me qëllim të këtij monitorimi, ka analizuar të dhënat e dërguara nga i licencuari KEDS SH.A dhe ka përgatitur “Raport monitorimi ndaj Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes lidhur me ndërprerjet e planifikuara dhe të paplanifikuara të energjisë elektrike për muajt nëntor-dhjetor 2021” ku edhe janë evidentuar të gjeturat e këtij monitorimi.

Raporti me të gjeturat iu ka dërguar palës KEDS për përgjigje, ku pas pranimit të përgjigjeve, janë vlerësuar përgjigjet e dërguara nga pale dhe është përgatitur Njoftimi për mos-pajtueshmëri për KEDS me kornizën rregullative dhe më vërejtjet për përmirësim.

Përmes këtij Njoftimi ZRRE ka obliguar KEDS SH.A që të mënjanojë parregullsitë e konstatuara në këtë njoftim. Në të kundërtën, ZRRE mund të filloj procedurat administrative për ndërmarrjen e masave tjera, deri te përcaktimi i gjobës.

ZRRE bazuar në të gjeturat dhe konstatimet të prezantuara në Raportin e grupit punues dhe në përputhje me dispozitat e Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullës për Masat Administrative dhe Gjobat, obligon KEDS-in që në afat jo më të gjatë se 30 ditë nga data e pranimit të këtij njoftimi, përmes një dokumenti të quajtur “Plani i Veprimit”, të informojë Bordin e ZRRE-së lidhur me veprimet që do të ndërmerren për përmirësimin dhe eliminimin e parregullsive të përmendura më lartë, si dhe veprimet që do t’i ndërmerren për mos përsëritjen e parregullsive të konstatuara.

Për sa u përket Monitorimit të Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) dhe Korporatës Elektroenergjetike (KEK), Raportet e monitorimit u janë dërguar palëve për komentim ku janë obliguar që brenda 15 ditësh kalendarike të ofrojnë përgjigjet me shkrim lidhur me të gjeturat në Raportet përkatëse.

ZRRE pas pranimit të përgjigjeve ka vlerësuar komentet e dërguara nga KOSTT lidhur me monitorimin e blerjeve të energjisë elektrike, pagesat dhe devijimet në nominimet e energjisë dhe KEK lidhur me blerjet e energjisë elektrike, të cilat kanë mbetur të shqyrtohen në seancat e mbledhjeve të Bordit gjatë vitit 2023, në përputhje me dispozitat ligjore dhe afatet kohore, ku pas shqyrtimit do të ndërmerren veprimet procedurale

Raportet përfunduar mbi monitorimin e ndërmarrjeve të energjisë publikohen në ueb faqe të Rregullatorit.

Monitorimi sipas Doracakut të Raportimit në Sektorin e Energjisë – sipas këtij doracaku, ndërmarrjet e licencuara të energjisë kanë dërguar në Rregullator raporte të menjëhershme, tremujore, apo vjetore, varësisht nga kërkesat e përshkurara në këtë doracak apo kërkesa tjera të Rregullatorit.

Për disa nene të licencës, të një rëndësie më të veçantë, pra shkelje të kushteve të licencës që mund të kenë ndikim serioz mbi politikën qeveritare, të konsumatorët ose në koston për kompensim, i licencuari duhet ta njoftojë menjëherë Rregullatorin. Në rast se një njoftim i tillë nuk bëhet me kohë, Rregullatori ka të drejtë të vendos masa administrative ose gjoba në pajtim me Rregullën për Masat Administrative dhe Gjobat.

Monitorimi i Programit të Pajtueshmërisë të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (KEDS Sh.A)– ky program është në fuqi që nga viti 2015 (V_750_2015), i cili është i aprovuar nga Bordi i Rregullatorit. Pas kërkesës së Rregullatorit, i njëjti është modifikuar dhe aprovuar nga Bordi i Rregullatorit gjatë vitit 2020 (V_1223_2020), ku sipas të cilit Zyrtari i Pajtueshmërisë i KEDS (i aprovuar me vendimin V_1256_2020) ka raportuar në Rregullator lidhur me përmbushjen e obligimeve të përcaktuara në këtë program.

3.2.1 Kontestet gjyqësore administrative

Gjatë vitit 2022, disa vendime të ZRRE janë atakuar në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, përmes kërkesëpadive të palëve të interesit si dhe me kërkesa për shtyrje të ekzekutimit të vendimeve deri në shqyrtimin e kërkesëpadisë në çështjen meritorë.

Vendimet e kontestuara kanë pasur të bëjnë me vendimin V_1489_2022 për tarifën me pakicë të energjisë elektrike që do të mbledhen nga Furnizuesi me Obligim të Shërbimit Publik (KESCO), nga dy palë të ndryshme.

Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, përmes Aktvendimit A. Nr. 656/2022 të datës 08.04.2022 me të cilën është aprovuar kërkesa e paditësit-propozuesit Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me adresë : Rr. "Nëna Terezë" Nr. 20, 10000 Prishtinë Republika e Kosovës, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Sekretari i Përgjithshëm Bajrush Xhemajli, për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit V_1489_2022 të datës 08 shkurt 2022 me Nr. protokollin 077/22 të datës 16.02.2022 të nxjerr nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE), derisa Gjykata të vendos me vendim përfundimtar gjyqësor përkitazi me padinë e paditëses.

ZRRE si palë e paditur ka shfrytëzuar të gjitha mjetet e rregullta dhe të jashtëzakonshme të parapara me Ligjin për Konfliktet Administrative, duke i ndjekur të gjitha shkallët e rregullta në procedurë, dhe pas parashtrimet të kërkesës për shqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.656/2022 të datës 08.04.2022 dhe i vërtetuar me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Departamenti për Çështje Administrative AA. nr. 364/2022 të datës 17.05.2017, e paditura Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE), konform dispozitivave të nenit 24 të Ligjit (Nr. 03/L-202, Viti V/Nr.82 / 21 tetor 2010) për Konfliktet Administrative pranë Gjykatës Supreme të Kosovës, nga Kolegji Gjyqësor i kësaj gjykate përmes Aktgjykimit ARJ nr. 45/2022 të datës 13 qershor 2022, me të drejt ka ndryshuar Aktvendimin e Gjykatës së Apelit- Departamenti për Çështje Administrative A.A. 364/2022 të datës 17.05.2022 dhe Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative A. Nr. 656/2022 i datës 08.04.2022, ashtu që është refuzuar si e pabazuar kërkesa-propozimi i parashtruesit të kërkesës Partia Demokratike e Kosovës për shtyrje të ekzekutimit të Vendimit të paditurës Zyra e Rregullatorit për Energji, nr. prot. 077/2022 Vendimi V_1489_2022 i datës 08.02.2022, deri në vendosjen sipas padisë me vendim përfundimtar në procedurë gjyqësore.

Po ashtu për rastin në fjalë është iniciuar edhe kërkesa pranë Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës nga pala e interesit, ku ZRRE ka paraqitur përgjigje në kërkesën e tillë, brenda afateve ligjore pranë Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, e cila është në trajtim.

Gjithashtu kundër këtij vendimi V_1489_2022, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, ka parashtruar kërkesëpadi edhe Komuna e Obiliqit, duke kërkuar përmes kërkesës shtyrjen e ekzekutimit të vendimit deri në shqyrtimin e çështjes së meritave në shqyrtim meritor.

Gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë kanë refuzuar kërkesën e tillë paditësit, edhe përkundër se pala paditëse ka parashtruar kërkesë për shqyrtim të jashtëzakonshëm në Gjykatën Supreme.

Gjykata Supreme e Kosovës përmes Aktgjykimit ARJ.UZVP. nr. 106/2022, dt. 27.10.22, ka refuzuar si të pabazuar kërkesën e paditësit Komunës së Obiliqit për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit

gjyqësor, parashtruar kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA. UZh. Nr. 496/2022 dt. 18.07.2022.

Kontest gjyqësor ka iniciuar edhe KOSTT SH.A., me të cilën ka kërkuar nga gjykata shtyrjen e ekzekutimit të Nenit 5 të Licencës së të paditurës ZRRE.

ZRRE përmes përgjigjes me shkrim e ka kundërshtuar kërkesën e paditësit për shtyrje të ekzekutimit, me arsyetimin se shtyrja e ekzekutimit të nenit 5 të Licencës do të ishte në kundërshtim me interesin publik dhe dëmet do të ishin të pariparueshme si për paditësin ndërmarrje e rregulluar e energjisë, po ashtu edhe për secilin konsumator i cili furnizohet me energji elektrike, pasi që paditësi që nga viti 2017 është duke u subvencionuar nga Qeveria dhe Kuvendi i Republikës së Kosovës për kostot e obliguara ligjore në fuqi.

Gjykata e shkallës së parë përmes aktvendimit A. Nr. 1156/22 me të drejt ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën e KOSTT SH.A., dhe njashtu edhe Gjykata e shkallës së dytë përmes aktvendimit AA. Nr. 475/2022 ka refuzuar si të pabazuar ankesën e paditësit KOSTT, ndërsa aktvendimin e shkallës së parë e ka vërtetuar si të drejt.

Kontest gjyqësor ka iniciuar edhe subjekt juridik AFA ENERGY SH.P.K., për shkak të refuzimit të vazhdimit të autorizimit për ndërtim përtej afateve ligjore nga ZRRE. Mirëpo edhe shkalla e par, e dytë dhe Gjykata Supreme e Kosovës pas parashtrimit të kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm përmes Aktgjykimit ARJ nr. 22/2022, ka refuzuar si të pabazuar kërkesën e tillë të paditësit, dhe ka vërtetuar aktvendimin e shkallës së dytë dhe asaj të shkallës së parë. Subjekti në fjalë ka parashtruar edhe kërkesën në Gjykatën Kushtetuese, ku e paditura ZRRE ka paraqitur argumentet dhe kundërshtimet përmes përgjigjeve me shkrim në Gjykatën Kushtetuese e cila është duke trajtuar rastin në fjalë.

Po ashtu vlen të theksohet që nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës, kemi pranuar njoftimin lidhur me rastin Nr.ref.:1416/22/bb të datës 29 korrik 2022, me të cilën është kërkuar që Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës të njoftohet nëse parashtruesi i kërkesës shoqëria Elektrosever D.O.O, është pajisur me licencë nga ZRRE-ja, dhe nëse jo, cilat janë arsyet që kanë shtyrën ZRRE-në, që parashtruesi i kërkesës të mos pajiset me licencë deri më tani?

ZRRE përmes përgjigjes me shkrim ka njoftuar Gjykatën Kushtetuese se me datë 24 qershor 2022 me vendimin V_1515_2022 ka lëshuar Licencën për furnizim me energji elektrike ndërmarrjes Društvo Elektrosever D.O.O me Nr. të Licencës ZRRE/Li_70/20, për periudhën pesë vjeçare, nga data 24 qershor 2022 deri me 23 qershor 2027.

ZRRE gjatë vitit 2022 ka pranuar edhe Aktgjykimin AA. Nr. 990/21 të Gjykatës së Apelit në Prishtinë, me të cilën është refuzuar si e pa bazuar ankesa e të paditurës ZRRE, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative A. Nr. 1373/17 i datës 15.09.2021 është vërtetuar.

ZRRE brenda afateve ligjore ka parashtruar edhe kërkesën për shqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimeve gjyqësore, pranë Gjykatës Supreme, me kërkesën që të të aprovoj si të bazuar kërkesën dhe të ndryshohet Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë A. Nr. 1373/2017, të datës 15.09.2021, dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA. Nr. 990/21 të datës 04.10.2022, pasi që të njëjtit janë nxjerr në shkelje të drejtës materiale dhe të procedurës, të cilat kanë ndikim në zgjidhjen e drejt të çështjes.

Respektivisht të Aprovohet kërkesa e të paditurës Zyra e Rregullatorit për Energji e Republikës së Kosovës dhe të anulohet Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë A. Nr. 1373/2017, të datës 15.09.2021, dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA. Nr. 990/21 të datës 04.10.2022, dhe çështja i kthehet Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti Administrativ, në rigjykim.

ZRRE është në pritje të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, në lidhje me shqyrtimin e kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor.

3.3 Burimet e Ripërtërithme të Energjisë (BRE)

Me Ligjin për Energjinë Nr. 05/L-081 në fuqi është përcaktuar politika e zhvillimit të BRE-ve, e cila ka për qëllim promovimin e shfrytëzimit ekonomik e të qëndrueshëm të potencialeve vendore të BRE-ve, në funksion të plotësimit të nevojave për energji, rritjes së sigurisë së furnizimit dhe mbrojtjes së mjedisit, e cila është pjesë përbërëse e Strategjisë së Energjisë së Republikës së Kosovës.

Ministria përkatëse për zbatimin e politikave të BRE-ve sipas legjislacionit në fuqi, ka përcaktuar me akt të veçantë nënligjor caqet e energjisë nga BRE në harmoni me kërkesat e direktivës përkatëse të Bashkimit European për BRE.

Me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084 është përcaktuar se ndërtimi i kapaciteteve të reja gjeneruese (BRE), sistemeve të reja për bartjen dhe shpërndarjen e gazit natyror, përfshirë interkonektorët, si dhe linjat direkte elektrike dhe gazsjellësit direkt për bartjen e gazit natyror do të bëhet në pajtim me procedurat e Autorizimit sipas këtij ligji, e cila do të ndërmerret nga Zyra e Rregullatorit për Energji, në përputhje me kritere objektive, transparente dhe jo-diskriminuese.

Vlen të theksohet që Republika e Kosovës është palë nënshkruese e Traktatit e për Themelimin e Komuniteti të Energjisë e cila është nënshkruar me datë 25 tetor 2005, e ratifikuar dhe ka hyr në fuqi me 01 korrik 2006 dhe ka filluar të implementohet me 1 korrik 2007. Në bazë të kësaj Kosova ka marrë obligime ligjore për të përmbushur të gjitha obligimet që kanë të bëjnë me sektorin e energjisë ku është paraparë edhe obligimi i detyrueshëm për arritjen e caqeve të BRE-ve deri në 2020, duke përfshirë edhe ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga burimet e pastërta.

Për të përmbushur obligimet ligjore për të arritur cakun e detyrueshëm për BRE, Ministria e Zhvillimit Ekonomik ka nxjerrë Udhëzimin Administrativ nr. 01/2013 dhe plotësim ndryshimin me UA Nr. 05/2017 me të cilin ka përcaktuar caqet vjetore dhe afatgjate të Energjisë nga BRE.

Udhëzimi Administrativ ka përcaktuar se, caku i detyrueshëm nga Burimet e Ripërtërithme të Energjisë deri në 2020, ishte 25 % të konsumit përfundimtar bruto të energjisë siç është përcaktuar në nenin 4 të Vendimit të Këshillit Ministror të Komunitetit të Energjisë Nr. D/2012/04/MC –EnC.

ZRRE, për të mbështetur zhvillimin e investimeve në Energjinë e Ripërtërithme, në vitin 2016 me Vendimin V-810-2016 ka përcaktuar tarifatat nxitëse (“feed-in”) për prodhimin e energjisë elektrike të prodhuar nga BRE. ku: energjia elektrike e prodhuar nga uji (hidrocentralet <10MW) ka çmimin 67.47€/MWh, energjia elektrike e prodhuar nga era ka çmimin 85.0€/MWh, energjia elektrike e prodhuar nga biomasa solide ka çmimin 71.3€/MWh dhe energjia elektrike e prodhuar nga panelet solare/fotovoltaike për caqet deri në 10 MW sipas udhëzimit të kaluar ka qenë prej 136.4€/MWh.

Po ashtu për të arritur objektivat e BRE-ve, ishte garantuar edhe jetëgjatësia e Marrëveshjes për Blerje të Energjisë e cila lidhet mes investitorit dhe KOSTT/OT, ku për energjisë elektrike të prodhuar

nga panelet fotovoltaike dhe energjinë e prodhuar nga Turbinat e Erës do të kenë kohëzgjatjen dymbëdhjetë (12) vjeçare, ndërsa për burimet tjera (hidroenergji dhe biomasa solide) do të kenë kohëzgjatje dhjetë (10) vjeçare, me çmime (tarifa nxitëse) të aplikueshme dhe të pranuar në skemën mbështetëse. Ndërsa për gjeneratorët për vetë-konsum ka garantuar kontratën (MBE) prej dymbëdhjetë (12) vitesh, e cila lidhet me furnizuesin e konsumatorit prodhues.

ZRRE në fund të vitit 2020 me vendimin V_1321_2020 kishte vendosur që të ndërpritet aplikimi i Skemës Mbështetëse me tarifa Nxitëse ("Feed – in") për mbështetjen e projekteve të reja, në ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Burimet e Ripërtërishme të Energjisë (BRE) për caqet 2021-2030.

Gjithashtu përmes atij vendimi ka vendosur që të ndërpritet edhe pranimi i aplikacioneve për marrje të autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, për tu trajtuar me tarifë nxitëse "feed –in", nga BRE, nga data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi.

ZRRE po ashtu ka theksuar se, vendimet për autorizim preliminar apo final për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese që janë lëshuar para hyrjes në fuqi të këtij Vendimi, do të trajtohen sipas dispozitave ligjore të Rregullës Nr. 10/12017 për Skemën mbështetëse dhe Vendimin V_810-2016 të datës 19 maj 2016 të nxjerr nga Bordi i ZRRE-së.

ZRRE përmes vendimit ka theksuar se, në pajtim me detyrimet ligjore dhe në bashkëpunim me Institucionet e Republikës së Kosovës, do të ndërmarr veprime për zhvillimin e projekteve nga Burimet e Ripërtërishme të Energjisë për caqet 2021-2030 përmes formave të ndryshme të ankandeve, në përzgjedhjen e përfitueseve nga format tjera përmes Tarifave Premium ose të ngjashme, konform praktikave më të mira në favor të interesit publik.

Vlen të theksohet se Strategjia e Energjisë së Republikës së Kosovës për periudhën 2022-2031 dhe Projektligji për Burimet e Ripërtrishme janë në proces të aprovimit, ku paraqesin edhe obligime për ZRRE-në, për zbatimin e politikave të Burimeve të Ripërtrishme dhe hartimin e kornizës ligjore për arritjen e objektivave energjetike.

ZRRE gjatë vitit 2022 si nevojë e ndërtimit të projekteve energjetike ka rishikuar Rregullën Nr. 11/2017 për Procedurën e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja nga BRE. Qëllimi i rishikimit ishte që të përfshihen edhe procedura për lëshimin e Autorizimit për projektet tjera të energjisë, për zhvillimin e një tregu konkurrues të energjisë dhe që nxisin investime për të garantuar sigurinë dhe stabilitetin e sektorit të energjisë në Republikën e Kosovës.

ZRRE pas zhvillimit të procesit të konsultimit publik me datë 16.11.2022 ka miratuar: "Rregullën Nr. 03/2022 për procedurën e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, sistemeve të reja të transmisionit dhe distribucionit të gazit, përfshirë interkonektorët, tubacionet direkte për energji termike dhe Linjat Direkte të Energjisë Elektrike dhe Tubacionet Direkte për Transmisionin e Gazit Natyror".

ZRRE gjatë vitit 2022 ka hartuar edhe Draft/Rregullën për vet-konsumatorët me Burime të Ripërtrishme, ku janë përcaktuar parimet dhe mekanizmat e rregulluar për mbështetjen e konsumatorëve të energjisë elektrike që dëshirojnë të gjenerojnë energji elektrike në ambientet e tyre bazuar në teknologjinë e ripërtërishme për përdorim vetanak.

Përmes kësaj draft/Rregull janë krijuar mundësitë që konsumatori fundor që operon brenda hapësirave të tij të vendosura brenda kufijve të ngushtë, që të prodhon energji elektrike të

Ripërtërishme për konsum vetanak, si dhe i cili mund të ruajë ose shesë energji elektrike të Ripërtërishme të prodhuar nga vetë ai, me kusht që, për një vetë-konsumator të burimeve të Ripërtërishme jo-familjar, këto veprimtari nuk përbëjnë veprimtarinë e tij kryesore tregtare ose profesionale.

ZRRE ka përfunduar procedurat e konsultimit publik në lidhje me këtë draft/rregulle dhe gjatë fillimit të vitit 2023 pritet të aprovohet dhe të fillohet implementimi.

ZRRE gjatë vitit 2022 ka trajtuar projektet të cilat kanë qenë në proces të finalizimit sipas autorizimit në pajtim me Rregullën për Procedurën e Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese bazuar në BRE dhe Rregullën për Skemën Mbështetëse nga Burimet e Ripërtërishme të Energjisë.

3.4 Autorizimi për ndërtimin e kapaciteteve të reja

ZRRE, edhe gjatë këtij viti ka vazhduar me zbatimin e procedurës së autorizimit, shqyrtimin e aplikacioneve për lëshimin e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga Burimet e Ripërtërishme të Energjisë (BRE), për shoqëritë që kanë aplikuar për marrjen e autorizimit.

ZRRE në kuadër të përmbushjes së detyrimeve të caktuara me legjislacionin në fuqi, ka lëshuar Autorizime për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese, ku çdo aplikues për marrjen e autorizimit iu është nënshtruar analizës së rregullshmërisë dhe plotësimit me korrektësi të dokumentacionit ligjor, administrativ, teknik, financiar dhe mjedisor, si dhe marrjes së lejeve përkatëse, të lëshuara nga institucionet relevante në përputhje me aktivitetin që subjektet kanë kërkuar për marrjen e autorizimit për lejimin e ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese bazuar në BRE.

ZRRE gjatë vitit 2022 nga subjektet e ndryshme juridike ka pranuar 2 aplikacione për marrje të autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga BRE me një kapacitet total prej 6.75 MW. Janë pranuar dhe shqyrtuar 114 kërkesa për marrjen e Autorizimit për gjeneratorët për vet-konsum me një kapacitet total prej 4.202 MW.

3.4.1 Aplikacionet që janë në proces të shqyrtimit në Rregullator

ZRRE, gjatë këtij viti ka shqyrtuar aplikacionet për marrje të autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, të cilat janë në fazën e kompletimit të aplikacioneve. Në vazhdim është paraqitur lista e aplikacioneve, të cilat janë në proces të shqyrtimit.

Tab. 3.5 Shoqëritë që janë në proces të shqyrtimit për marrjen e vendimit për autorizim preliminar

Nr.	Subjekti Juridik	Objekti	Lokacioni	Kapaciteti i instaluar	PROCES TË SHQYRTIMIT
1	SOLAR ENERGY GROUP EUROPE SH.P.K	Solare	BEC - VRANIQ - Gjakova	150 MW	proces
2	EV WIND PARK SH.P.K.	Era	Wind Park ZATRIQ 1, Rahovec	35MW	proces
3	EV WIND PARK SH.P.K.	Era	Wind Park ZATRIQ 2, Rahovec	35MW	proces
4	EUROKOS DD SH.P.K	Hidrocentral	DRINI PSHP - REVERZIBIL/ Prizren	250 MW	proces
5	DARDANA INVEST SH.P.K.	ERA	WIND PARK KITKA 2/Kamenica	33 MW	proces
6	NIN TECHNOLOGY SH.P.K.	Biomasa	Ferizaj	5.2 MW	proces

3.4.2 Projektet në proces të ndërtimit sipas Autorizimit Final

Projektet të cilat janë ndërtuar dhe finalizuar sipas planit dinamik të realizimit dhe sipas afateve të përcaktuara me Rregullën Nr. 11/2017 për Procedurës së Autorizimit, janë dy (2) projekte ku sipas planit dinamik të realizimit në ri-procedurë një (1) projekt i hidroenergjisë me kapacitet të instaluar prej 3.45 MW, dhe një (1) projekt nga panelet solare me kapacitet të instaluar prej 3 MW. Këto projekte janë duke u realizuar sipas kornizës së rregulluar me çmime referente.

Ndërsa projekti i shoqërisë Bondcom Energy Point SH.P.K., për gjenerimin e energjisë elektrike nga ERA Wind Park Bodakova me kapacitet prej 11 MW, është në proces të realizimit sipas afateve ligjore ku deri në prill të vitit 2023 duhet të finalizohet.

3.4.3 Hyrja në operim e gjeneratorëve nga BRE

Gjatë këtij viti pas finalizimit të projekteve sipas Autorizimit nga Bordi i ZRRE-së, dhe pas pranimit teknik kanë hyr në operim një (1) projekt nga Turbinat e Erës, projekti WIND PARK SELAC 3 me fuqi totale të instaluar prej 34.47 MW.

3.5 Gjeneratorët për vetë-konsum

ZRRE, gjatë këtij viti ka trajtuar edhe kërkesat/aplikacionet për gjeneratorët për marrjes e statusit të konsumatorit prodhues për vetë-konsum, të cilat pas plotësimit të kërkesave ligjore në pajtim me Rregullën e Autorizimit dhe Skemën Mbështetëse, janë lejuar për të vazhduar me ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese për vetë-konsum.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur numri i vendimeve të lëshuara nga Bordi i ZRRE-së, për gjeneratorët për vetë-konsum gjatë vitit 2022.

Tab. 3.6 Autorizimet për vetë-konsum

Vendime për vetë-konsum	Nr. i vendimeve të lëshuara
Solare	117
Totali	117

Në tabelën e mëposhtme janë paraqiten personat fizik dhe juridik të cilave iu është lëshuar vendimi për autorizimin për ndërtim të gjeneratorëve për vetë-konsum.

Tab. 3.7 Shoqëritë të cilave iu është lëshuar vendimi për ndërtim të gjeneratorëve për vetë-konsum

Nr.	Subjekti Juridik	Objekti	Lokacioni	Kapaciteti i instaluar	Data e Lëshimit të Vendimit
1	HIB PETROL SH.P.K.	Solare	fsh. "Shkabaj" Prishtinë, Republika e Kosovës	100 kW	14.01.2022
2	PROEX SH.P.K.	Solare	Rr. "Agim Ramadani", Mitrovicë, Republika e Kosovës	100 kW	14.01.2022
3	N.T.P. V- T KASTRATI	Solare	fsh. "Kërpime", Podujevë, Republika e Kosovës	10.92 kW	14.01.2022
4	INTERING SH.P.K.	Solare	Rr. "Ali Hadri", Obiliq, Republika e Kosovës	43.69 kW	14.01.2022
5	EXPRESS POSTA L.L.C.	Solare	fsh. "Uglar", Fushë Kosovë, Republika e Kosovës	8 kW	14.01.2022
6	Biznes Individual Q.G.	Solare	Zona Industriale, Prishtinë, Republika e Kosovës	100 kW	16.02.2022
7	Biznes Individual Q.G.	Solare	Zona Industriale, Prishtinë, Republika e Kosovës	100 kW	16.02.2022
8	ANANAS IMPEX SH.P.K.	Solare	fsh. "Livadicë", Podujevë, Republika e Kosovës	48 kW	16.02.2022
9	N.P.SH. ALBATROS	Solare	Rr. "Besim Shala", Prizren, Republika e Kosovës	18.4 kW	16.02.2022
10	GEMIX SH.P.K.	Solare	fsh. "Korreticë e Epërme", Drenas, Republika e Kosovës	100 kW	16.02.2022
11	VETONI 2 SH.P.K.	Solare	fsh. "Mirushë", Malishevë, Republika e Kosovës	60 kW	16.02.2022
12	VERONA	Solare	fsh. "Xërxë", Rahovec, Republika e Kosovës	14 kW	16.02.2022
13	Person Fizik V. M.	Solare	Rr. "Ali Bajraktari" pn, Gjakovë, Republika e Kosovës	10 kW	31.03.2022
14	KATANA SH.P.K.	Solare	Rr. "Hasan Prishtina", Obiliq, Republika e Kosovës	30 kW	31.03.2022
15	PROTON SH.P.K.	Solare	Rr. "Veternik" Çagllavicë, Republika e Kosovës	89.1 kW	31.03.2022
16	RIMA GROUP SH.P.K.	Solare	fsh. "Rimanishtë", Besi-Prishtinë, Republika e Kosovës	20.86 kW	31.03.2022
17	DORA - FIX SH.P.K.	Solare	Mgjistralja Pejë- Prishtinë, Rr. "Avni Miftari", Drenas, Republika e Kosovës	100 kW	31.03.2022
18	KOLEGJI - UBT SH.P.K.	Solare	Magjistralja Prishtinë-Ferizaj, Lipjan, Republika e Kosovës	48 kW	31.03.2022
19	Person Fizik XH. I.	Solare	fsh "Llugat", Istog, Republika e Kosovës	5 kW	31.03.2022
20	Person Fizik B. K.	Solare	fsh. "Çikatovë, Drenas, Republika e Kosovës	5 kW	31.03.2022
21	Person Fizik K. B.	Solare	fsh. "Kishnicë", Graçanicë, Republika e Kosovës	6.96 kW	31.03.2022
22	LONI GLASS SH.P.K.	Solare	fsh. "Greme" Ferizaj, Republika e Kosovës	65 kW	24.06.2022
23	PROFIL STAR SH.P.K.	Solare	fsh. "Greme", Ferizaj, Republika e Kosovës	75 kW	24.06.2022
24	RINA COMERCE SH.P.K.	Solare	fsh. "Vrellë", Istog, Republika e Kosovës	75 kW	24.06.2022
25	UNICRON SH.P.K.	Solare	"Pejë", Republika e Kosovës	89.1 kW	24.06.2022
26	AGRO JETALS SH.P.K.	Solare	fsh. "Gurakoc", Istog, Republika e Kosovës	10 kW	24.06.2022
27	LESNA INDESIGN SH.P.K.	Solare	fsh. Konjuh, Lipaj, Republika e Kosovës	100 kW	24.06.2022
28	TOBACCO HOLDING GROUP SH.P.K.	Solare	fsh. Laplje Selo, Graçanica, Republika e Kosovës	50 kW	24.06.2022
29	AGRO VIKTORIA SH.P.K.	Solare	fsh. Vitomirica, Pejë, Republika e Kosovës	5 kW	24.06.2022
30	MOBILE DEKOR SH.P.K.	Solare	"Pejë", Republika e Kosovës	30 kW	24.06.2022
31	INTERING SH.P.K.	Solare	Ali Hadri, Obiliq, Republika e Kosovës	75 kW	24.06.2022

Nr.	Subjekti Juridik	Objekti	Lokacioni	Kapaciteti i instaluar	Data e Lëshimit të Vendimit
32	Person Fizik F. XH.	Solare	fsh. "Marali", Malishevë, Republika e Kosovës	10 kW	24.06.2022
33	Person Fizik A. B.	Solare	fsh. "Krojmir", Lipjan, Republika e Kosovës	5 kW	24.06.2022
34	Person Fizik A. U.	Solare	Podujevë, Republika e Kosovës	3 kW	24.06.2022
35	Person Fizik A. Ç.	Solare	Podujevë, Republika e Kosovës	3 kW	24.06.2022
36	AB JETISHI SH.P.K.	Solare	fsh. "Brekoc", Gjakovë, Republika e Kosovës	14 kW	29.07.2022
37	GJIMNAZI ATATURK MAMUSHË	Solare	Mamushë, Komuna e Mamushës Republika e Kosovës	4.16 kW	29.07.2022
38	N.T.P INOX	Solare	Gjakova, Republika e Kosovës	14 kW	29.07.2022
39	KUVENDI KOMUNAL -MAMUSHË	Solare	Mamushë, Komuna e Mamushës Republika e Kosovës	12.48 kW	29.07.2022
40	KUVENDI KOMUNAL -MAMUSHË	Solare	Mamushë, Komuna e Mamushës Republika e Kosovës	14.95 kW	29.07.2022
41	SH.M.U. ANADOLU-MAMUSHË	Solare	Mamushë, Komuna e Mamushës Republika e Kosovës	11.84 kW	29.07.2022
42	Person Fizik B. S.	Solare	fsh. "Plluzhinë", Skenderaj, Republika e Kosovës	5 kW	29.07.2022
43	N..T.P. ECO GLASS	Solare	fsh. "Prelez I Jerlive", Ferizaj, Republika e Kosovës	48 kW	29.07.2022
44	Person Fizik N. D.	Solare	Gjakovë, Republika e Kosovës	3 kW	29.07.2022
45	AGRO ALF	Solare	491 "Vëllezërit Frashëri, Rahovec, Republika e Kosovës	45 kW	29.07.2022
46	MOBILE DEKOR SH.P.K.	Solare	fsh. "Qyshk", Pejë, Republika e Kosovës	84 kW	29.07.2022
47	N.T.SH. BAST TRADE	Solare	Magj. Prish.-Mitrovicë, Obiliq, Republika e Kosovës	100 kW	29.07.2022
48	RESTAURANT MJELLMA	Solare	"shtime", Komuna e Shtimes, Republika e Kosovës	40 kW	29.07.2022
49	BESIMI COMMERCE SH.P.K.	Solare	"Shtime", Komuna e shtimes, Republika e Kosovës	10 kW	29.07.2022
50	DECON SH.P.K.	Solare	"Preoce", Komuna e Graçanicës, Republika e Kosovës	84 kW	29.07.2022
51	N'KATUN SH.P.K.	Solare	"Milloshevë", Komuna e Obiliqit, republika e Kosovës	20.68 kW	29.07.2022
52	Person Fizik SH.G.	Solare	"Nagavc", Komuna e Rahovecit, Republika e Kosovës	10 kW	05.09.2022
53	CADI GROUP SH.P.K	Solare	"Babush" Komuna e Ferizajt, Republika e Kosovës	100 kW	05.09.2022
54	Person fizik U.M.	Solare	"Reti e Poshtme", Komuna e Rahovecit	5 kW	05.09.2022
55	Person Fizik SH.P.	Solare	"Lagjja Marigona", Graçanicë, Republika e Kosovës	10 kW	05.09.2022
56	MOBILE DEKOR SH.P.K.	Solare	"Tahir Shala", Pejë, Republika e Kosovës	81 kW	05.09.2022
57	WORMSER & PARTNERS L.L.C.	Solare	"Graçanicë" Graçanica, Republika e Kosovës	25 kW	05.09.2022
58	HAXHIJAJA SH.P.K.	Solare	"Rahovec", Rahovec, Republika e Kosovës	14 kW	05.09.2022
59	MAXX GROUP SH.P.K.	Solare	Preoce, Komuna e Graçanicës, Republika e Kosovës	30 kW	05.09.2022
60	JETISHI QERAMIKA SH.P.K.	Solare	Gjakovë, Republika e Kosovës	66.5 kW	05.09.2022
64	DURMISHI F GROUP INT. SH.P.K.	Solare	Preoce, Komuna e Graçanicës, Republika e Kosovës	60 kW	05.09.2022
62	SOLE KOSOVA SH.P.K.	Solare	Fushë Kosovë, Republika e Kosovës	100 kW	05.09.2022
63	N.T. P AGONI -S	Solare	fsh. Greme, komuna Ferizaj, Republika e Kosovës	10 kW	05.09.2022
64	PROEX SH.P.K.	Solare	Istog, Republika e Kosovës	100 kW	05.09.2022
65	N.T.N GLOBI KOS	Solare	Klinë, Republika e Kosovës	10 kW	05.09.2022
66	PRETENI SH.P.K.	Solare	Nushtri, Republika e Kosovës	40 kW	05.09.2022
67	Person Fizik B.XH.	Solare	Gjakovë, Republika e Kosovës	8 kW	05.09.2022
68	Person Fizik B.XH.	Solare	Gjakovë, Republika e Kosovës	8 kW	05.09.2022
69	Person Fizik A.T.	Solare	Gjakovë, Republika e Kosovës	10 kW	12.10.2022
70	EUROTERM - AG O.P	Solare	Osekë Hilë, Komuna e Gjakovës, Republika e Kosovës	69 kW	12.10.2022
71	ECO FRUITS SH.P.K	Solare	Batllavë, Komuna e Podujevës, Republika e Kosovës	75 kW	12.10.2022
72	SH. M. Kuvendi I Arbërit	Solare	Brahim Ademi, Komuna e Ferizajt, Republika e Kosovës	30.24 kW	12.10.2022
73	SH.F.M.U Jeronim De Rada	Solare	Dëshmorët e Kombit, Komuna e Ferizajt, Republika e Kosovës	20.16 kW	12.10.2022
74	SH.F.M.U. Gjon Sereçi	Solare	Ahmet Kaqiku, Komuna e Ferizajt, Republika e Kosovës	25.2 kW	12.10.2022
75	Çerdhja e fëmijëve, Ferizaj	Solare	Enver Topalli, Komuna e Ferizajt, Republika e Kosovës	35.7 kW	12.10.2022
76	Person Fizik E.G.	Solare	Preoce, Komuna e Graçanicës, Republika e Kosovës	10 kW	12.10.2022
77	Person Fizik H.SH.	Solare	Adem Jashari, Komuna e Malishevës, Republika e Kosovës	8.3 kW	12.10.2022
78	Person Fizik I.H.	Solare	Lagjja Marigona Rezidence, Graçanicë, Republika e Kosovës	7.5 kW	12.10.2022
79	Person Fizik F.H.	Solare	Lagjja Marigona Rezidence, Graçanicë, Republika e Kosovës	7.5 kW	12.10.2022
80	Person Fizik N.D.	Solare	Ganimete Tërbeshi, Komuna e Klinës, Republika e Kosovës	15 kW	12.10.2022
81	Person Fizik K.R.	Solare	Preoce, Komuna e Graçanicës, Republika e Kosovës	14.9 kW	12.10.2022

Nr.	Subjekti Juridik	Objekti	Lokacioni	Kapaciteti i instaluar	Data e Lëshimit të Vendimit
82	Person Fizik P.N.	Solare	Dol, Komuna e Gjakovës, Republika e Kosovës	10 kW	16.11.2022
83	X.PLAST SH.P.K.	Solare	Rakaj, Komuna e Ferizajt, Republika e Kosovës	100 kW	16.11.2022
84	HIP PETROL SH.P.K.	Solare	Fushë Kosovë, Republika e Kosovës	100 kW	16.11.2022
85	RESTAURANT NATYRAL BI SH.P.K.	Solare	Sojevë, Komuna e Ferizajt, Republika e Kosovës	100 kW	16.11.2022
86	SOLE KOSOVA SH.P.K.	Solare	Fushë Kosovë, Republika e Kosovës	100 kW	16.12.2022
87	A&M SH.P.K.	Solare	Graçanicë, Republika e Kosovës	30 kW	16.11.2022
88	Person Fizik Y.S.	Solare	Greme, Komuna e Ferizajt, Republika e Kosovës.	5 kW	16.12.2022
89	Person Fizik B.B.	Solare	Nekodim, Komuna e Ferizajt, Republika e Kosovës.	8 kW	16.11.2022
90	Person Fizik M.K.	Solare	Balincë, Komuna e Malishevës, Republika e Kosovës	5 kW	16.11.2022
91	Person Fizik F.SH.	Solare	Komuna e Mitrovicës, Republika e Kosovës	7 kW	16.11.2022
92	Person Fizik K.S.	Solare	Komuna e Ferizajt, Republika e Kosovës.	8 kW	16.11.2022
93	Person Fizik I.A.	Solare	Komuna e Ferizajt, Republika e Kosovës.	8 kW	16.11.2022
94	Person Fizik A.M.	Solare	Komuna e Ferizajt, Republika e Kosovës.	7 kW	16.11.2022
95	Person Fizik M.M.	Solare	Komuna e Ferizajt, Republika e Kosovës.	15 kW	16.11.2022
96	Person Fizik V.I.	Solare	Lagjja e Re, Komuna e Lipajnit, Republika e Kosovës	12 kW	29.12.2022
97	HOLE L.L.C.	Solare	Komuna e Obiliqit, Republika e Kosovës	49 kW	29.12.2022
98	Person Fizik S.L.	Solare	Komuna e Ferizajt, Republika e Kosovës	6 kW	29.12.2022
99	VIER PFOTEN KOSOVA OJQ	Solare	Mramor, Komuna e Prishtinës, Republika e Kosovës	13 kW	29.12.2022
100	INTERPLAST GROUP SH.P.K.	Solare	Komuna e Mitrovicës, Republika e Kosovës	40 kW	29.12.2022
101	Person Fizik F.N.	Solare	Lagjja Qërshia, Komuna e Prishtinës, Republika e Kosovës	10 kW	29.12.2022
102	AUTOTRADE SH.P.K.	Solare	Llapancellë, Komuna e Graçanicës, Republika e Kosovës	5 kW	29.12.2022
103	N.H.T. FRESKIA A.D	Solare	Burimi, Komuna e Istogut, Republika e Kosovës	49 kW	29.12.2022
104	ELJEKTROMETALI SH.P.K.	Solare	Komuna e Ferizajt, Republika e Kosovës	72.78 kW	29.12.2022
105	Person Fizik F.I.	Solare	Komuna e Ferizajt, Republika e Kosovës	7 kW	29.12.2022
106	ASGETO SH.P.K.	Solare	Livagjë, Komuna e Graçanicës, Republika e Kosovës	79 kW	29.12.2022
107	PROMOPLAST SH.P.K.	Solare	Komuna e Ferizajt, Republika e Kosovës	69.37 kW	29.12.2022
108	Person Fizik SH.B.	Solare	Komuna e Ferizajt, Republika e Kosovës	8 kW	29.12.2022
109	DST PRODUCT SH.P.K.	Solare	Komuna e Ferizajt, Republika e Kosovës	30 kW	29.12.2022
110	Person Fizik A.K.	Solare	Komuna e Prishtinës, Republika e Kosovës	5 kW	29.12.2022
111	Person Fizik D.K.	Solare	Komuna e Prishtinës, Republika e Kosovës	5 kW	29.12.2022
112	Person Fizik I.M.	Solare	Komuna e Prishtinës, Republika e Kosovës	14.9 kW	29.12.2022
113	Person Fizik D.S.	Solare	Rr. Jusuf Kelmendi, Komuna e Pejës, Republika e Kosovës	8 kW	29.12.2022
114	HIB PETROL SH.P.K.	Solare	Talinoc I Muhaxherve, Komuna e Ferizajt, Republika e Kosovës	60.76 kW	29.12.2022
115	Person Fizik B.S.	Solare	Gerlicë, Komuna Ferizajt, Republika e Kosovës	6 kW	29.12.2022
116	Person Fizik A.R.	Solare	Xhevë Ladrovci, Komuna Ferizajt, Republika e Kosovës	14.9 kW	29.12.2022
117	Person Fizik S.S.	Solare	Greme, Komuna Ferizajt, Republika e Kosovës	5 kW	29.12.2022
Gjithsej				4202.85 kW	

Projektet e lartcekura priten të realizohen brenda periudhës së përcaktuar sipas planit dinamik të realizimit të projekteve në pajtim me kushtet teknike të kyçe.



Fig. 3.2 Pamje nga realizimi i një gjeneratori për vet-konsum

ZRRE, po ashtu ka pranuar edhe kërkesa tjera nga personat fizik dhe juridik, të cilat janë në fazë të shqyrtimit dhe sipas procedurave në fuqi, pas kompletimit do të lejohen në ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga gjeneratorët për vetë-konsum.

3.6 Monitorimi i ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese

ZRRE, gjatë këtij viti, ka bërë monitorimin e subjekteve juridike që janë të pajisura me Autorizim Final për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese.

ZRRE në mars të vitit 2022 ka marr pjesë edhe në inaugurimin zyrtar të projektit të SELACIT, ku më poshtë gjeni foto nga realizimi i projektit WIND PARK SELAC, Komuna e Mitrovicës.





Fig. 3.3 Pamje nga punimet në realizimin e projektit WIND PARK SELAC

Po ashtu, ZRRE ka monitoruar edhe projektet tjera që janë duke u realizuar sipas vendimeve mbi Autorizimet Finale, e të cilat janë në faza të ndryshme të ndërtimit sipas afateve ligjore të dhënura me vendimet përkatëse. Monitorimi i tyre është bërë në vazhdimësi varësisht nga kërkesat që janë dalur gjatë implementimit të tyre.

ZRRE do të vazhdojë me monitorimin e ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese nga Burimet e Ripërtrishme të Energjisë, duke i respektuar të gjitha procedurat dhe kriteret ligjore të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

3.7 Integrimi i tregut

3.7.1 Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike Alpex

Në zbatim të detyrimeve të Traktatit të Komunitetit të Energjisë, Shqipëria dhe Kosova janë zotuar të zbatojnë Paketën e Tretë të Energjisë të Komunitetit të Energjisë, e cila udhëzon palët në lidhje me krijimin dhe funksionimin e një tregu konkurrues të energjisë elektrike. Si rrjedhojë, modelet e tregut në të dyja vendet parashikojnë që nëpërmjet ALPEX të zbatohet Modeli i Synuar Evropian i Tregut, për tregjet e ditës në avancë (DAM) dhe brenda ditës (IDM), të karakterizuara ndryshe dhe si tregje me shumicë bazuar në transaksionet dypalëshe dhe kontratat e lidhura midis dy pjesëmarrësve të tregut jashtë bursës së energjisë elektrike (Over the Counter -OTC) ose ndryshe si një treg i organizuar i ditës në avancë dhe brenda të njëjtës ditës, i organizuar nga Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike-ALPEX.

Më 27 dhjetor 2022, Zyra e Rregullatorit për Energji e Kosovës (ZRRE) dhe Enti Rregullor i Energjisë i Shqipërisë (ERE) mbajtën një mbledhje të përbashkët në Prishtinë për miratimin e rregullave dhe procedurave të tregtimit për ALPEX. Zhvillimi i bursës së energjisë elektrike ALPEX-it krijon treg të përbashkët të energjisë elektrike në Kosovë dhe Shqipëri ku pjesëmarrësit e sektorit mund të blejnë dhe shesin energji me lehtësi. Miratimi i përbashkët i dy organeve rregullative është hapi

përfundimtar në kornizën rregullative që nevojitet për të mundësuar operimin e bursës së energjisë elektrike në mes të dy vendeve.

Bashkimi i tregut në mes të Shqipërisë dhe Kosovës është mënyra më efikase për të ndihmuar maksimizimin e shfrytëzimit të kapacitetit ndërkufitar të energjisë elektrike dhe të transmisionit me çmimin më të ulët të mundshëm. ALPEX-i do të ofrojë platformë transparente për tregtimin e energjisë, ngrit konkurrencën në nivel të çmimit me pakicë dhe krijojë sinjale të çmimit që do të nxisë investime të reja të sektorit privat. Madhësia e tregut të kombinuar të integruar po ashtu ofron hyrje më të lehtë të furnizuesve të rinj dhe kapacitet më të mirë absorbues të gjenerimit nga burimet e ripërtëritshme të energjisë (BRE).

Kjo platformë tregtimi është një hap i madh përpara në krijimin e tregut rajonal të energjisë të Ballkanit Perëndimor. Nga efikasiteti i saj do të përfitojnë përfundimisht konsumatorët e Kosovës dhe Shqipërisë por përfundimisht i tërë rajoni.



Fig. 3.4 Pamje nga mbledhja e përbashkët për miratimin e rregullave dhe procedurave të tregimit për ALPEX

Kjo mbledhje e përbashkët e dy rregullatorëve u dha mundësinë rregullatorëve, pjesëmarrësve të tregut të energjisë dhe akterëve qeveritarë që të diskutojnë përfitimet që do t'i sjellin procedurat e ALPEX-it për bursën e energjisë elektrike sa i përket kërkesave rregullative, dhe rolet që ushtrohen nga secili rregullator në lehtësimin e ALPEX-it dhe qëndrueshmërinë e tij.

3.7.2 Implementimi i Rregullës së Transparencës dhe Integritetit të Tregut me Shumicë të Energjisë (REMIT)

Rregullorja REMIT, e cila është transpozim i rregullores Nr.1227/2011 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian, është aprovuar nga ZRRE në qershor të vitit 2020. Sipas obligimeve të cilat rrjedhin nga

rregulla REMIT, pjesëmarrësit e tregut duhet të regjistrohen në regjistrin nacional të cilin e krijon ZRRE.

ZRRE, ka transpozuar nga formati i ECRB-së formatin e pyetësorëve për mbledhjen e të dhënave nga të licencuarit, i cili iu është dërguar pjesëmarrësve të tregut. Bazuar në të dhënat e dërguara nga pjesëmarrësit e tregut, ZRRE ka krijuar regjistrin kombëtar të pjesëmarrësve të tregut, sipas kërkesave ligjore të dalura nga rregulla REMIT. Rregulla, formularët dhe regjistri kombëtar janë të publikuara në faqen elektronike të ZRRE-së.

3.8 Kriza në sektorin e energjisë

Viti 2021 dhe 2022 u karakterizuan me rritje të çmimeve në tregjet evropiane të energjisë elektrike, që u ndikuan nga kërkesa për gaz në Azi, niveli i ulët i rezervave të gazit në stoqet Evropiane dhe rritja e kërkesës për energji elektrike që erdhi si pasojë e rimëkëmbjes ekonomike pas kufizimeve fillestare të COVID-19, të bashkuara nga një sërë faktorësh ekonomikë, atmosferikë dhe politikë në mbarë botën.

Me 13 janar 2022, Zyra e Rregullatorit për Energji inicioi procesin e Shqyrtimit të Jashtëzakonshëm të të Hyrave të Lejuara Maksimale për kompanitë e rregulluara në sektorin e energjisë elektrike. Një rishikim i tillë është iniciuar nga ZRRE -ja pas rritjes së paprecedentë të çmimeve të importit me shumicë. Bazuar në kuadrin rregullator, kushti i ndikimit material 5% në të ardhurat e furnizuesit universal do të ishte shkas për një rishikim të jashtëzakonshëm të tarifave. Përveç çmimeve të larta të importit dhe rritjes së ndjeshme të kërkesës, situatën e përkeqësuan edhe ndërprerjet e paplanifikuara të termocentraleve.

Pas rishikimit të tarifave në shkurt të vitit 2022, ZRRE-ja ka ndryshuar strukturën tarifore për USS dhe ka vendosur tarifën bllok (në 800 kWh/muaj) si dhe rritjen e të hyrave të lejuara deri në 70% nga viti paraprak.

Qeveria zotoi subvencionin prej 100 milionë euro, krahas 20 milionë eurove të dhëna në vitin 2021.

Rritja e të hyrave të lejuara u rishikua në dritën e subvencionit të paralajmëruar dhe rritja e të hyrave rezultoi rreth 20%, e cila do të mbulohej nga konsumatorët familjarë që konsumojnë energji elektrike më shumë se blloku i përcaktuar.

Përveç fushatës së përgjithshme për kursimin e energjisë, Ministria e Ekonomisë themeloi komitetin teknik emergjent siç parashihet me Udhëzimin Administrativ për situata emergjente. Ky komitet teknik ka bërë rekomandime për Ministren e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik për masat e mundshme mbështetëse për menaxhimin dhe tejkalimin e krizës energjetike.

3.9 Aktivitetet e Rregullatorit në fushën e rregullimit të çmimeve

3.9.1 Shqyrtimi tarifor

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) bazuar në kompetencat e dhëna në legjislacionin primar dhe legjislacionin sekondar për sektorin e energjisë është autoriteti i vetëm përgjegjës për përcaktimin e tarifave për aktivitetet e rregulluara në sektorin e energjisë. ZRRE, përmes procesit të hapur dhe transparent bënë përcaktimin e të hyrave dhe tarifave, kjo është përgjegjësi rregullatore përveç që

është e specifikuar në legjislacion vendor, është e përcaktuar edhe me Direktivën 2009/72/EC lidhur me rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të energjisë elektrike.

Prej gjysmës së dytë të vitit 2021 kemi pasur rritje të shpejtë të çmimeve në tregjet evropiane të energjisë. Kjo rritje është nxitur nga një numër faktorësh si: rritja e kërkesës për gaz natyror nga Azia dhe rezervat e ulëta të stoqeve në Evropë, ku kanë çuar në një rritje të ndjeshme të çmimeve të gazit natyror. Meqenëse termocentralet me gaz janë zakonisht termocentralet margjinale që nevojiten për të mbuluar kërkesën në tregjet e energjisë elektrike, rritja e çmimeve të gazit natyror rezultoi në një rritje të ngjashme të çmimeve të energjisë elektrike. Kjo dinamikë ishte veçanërisht e theksuar në Evropë, ku pushtimi rus i Ukrainës shtoi presion të paprecedentë në tregun energjisë, duke keqësuar më tej krizën e energjisë kur çmimet u rriten në nivele rekord, të cilat do t'i kalonte në kurriz edhe Kosova.

Kostot e blerjes së energjisë elektrike janë ndikuar nga ngjarje të tjera të rëndësishme. Së pari, të dhënat e siguruar sugjerojnë një rritje të ndjeshme të kërkesës maksimale për energji elektrike, si dhe e vëllimit të konsumit të energjisë. Përveç kësaj, ka pasur ndërprerje të konsiderueshme të prodhimit nga njësitë e TC Kosova A dhe TC Kosova B, që përkonin me kërkesën e pikut për energji elektrike, të cilat nuk ishin marrë parasysh në llogaritjen fillestare të tarifës.

Këto efekte u reflektuan edhe në tregun vendor të energjisë elektrike. Duke njohur këto rrethana, Zyra e Rregullatorit për Energji me 13 janar 2022 inicioi procesin e Shqyrtimit të Jashtëzakonshëm të Hyrave të Lejuara Maksimale për kompanitë e rregulluara në sektorin e energjisë elektrike. Shqyrtimet e jashtëzakonshme të tarifave kërkojnë një ndërhyrje rregullatore për përditësimin e parametrave tarifor për t'u siguruar që të ardhurat e lejuara të mbuluara përmes tarifave të miratuara të mbulojnë plotësisht kostot e arsyeshme të ofrimit të shërbimit për konsumatorët e rregulluar. Shqyrtimet e Jashtëzakonshme ndodhin kur ka ndryshim në mes të vlerave të parashikuara dhe të realizuara të parametrave të përcaktimit të tarifave, që tejkalon një prag materialiteti prej të paktën 5%. Në kuadër të këtij procesi, ZRRE përditësoi të Hyrat e Lejuara Maksimale (HLM) e Furnizuesit të Shërbimit Universal, përshtati HLM e Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT), Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH), bazuar në shifrat e përcaktuara në këtë proces.

Paralelisht me procesin e shqyrtimit të jashtëzakonshëm, ZRRE inicio edhe rishikimin e strukturës tarifor për konsumatorët shtëpiak si mekanizëm i paraparë në legjislacionin sekondar për të mundësuar rritjen e efijencës së konsumit të energjisë elektrike dhe reflektimit të kostove të shërbimit.

Duke marrë parasysh kompleksitetin dhe nevojën për përmbyllje në afat sa më të shpejt të këtij procesi, ZRRE ka pasur asistencë teknike të angazhuar përmes USAID, përkatësisht projektit ESA Kosovo Energy Sustainability Activity.

ZRRE-ja si gjithëherë, u ka ofruar mundësinë kompanive të rregulluara dhe konsumatorëve që të shqyrtojnë të dhënat dhe qëndrimet e paraqitura në raportet konsultative.

Shqyrtimi i aplikimeve për të hyrat dhe tarifat e rregulluara në sektorin e energjisë elektrike ndër të tjera ka përfshirë: aktivitetet e blerjes së energjisë me shumicë nga gjeneratorët vendor, importin e energjisë elektrike, aktivitetin e transmetimit të energjisë elektrike, aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike dhe aktivitetin e furnizimit të shërbimit universal (FSHU).

I gjithë ky proces i shqyrtimit ka kaluar përmes konsultimit publik, duke përfshirë edhe takime dhe komunikime me palët e interesit. ZRRE me rastin e përcaktimit të hyrave dhe tarifave për operatorët e rregulluar, ka marrë parasysh dokumentet të cilat janë publikuar në faqen zyrtare të ZRRE-së, si në vijim:

- ZRRE me datë 28 dhjetor 2021 nga Furnizuesi me Shërbim Universal KESCO SH.A (FSHU) ka pranuar aplikacionin për Shqyrtim të Jashtëzakonshëm të Hyrave të Lejuara Maksimale për Furnizuesin me Shërbim Universal.
- ZRRE me datë 28 dhjetor 2021 nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes – KEDS SH.A (OSSH)) ka pranuar aplikacionin për Shqyrtim të Jashtëzakonshëm të Hyrave të Lejuara Maksimale për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH).
- ZRRE me datë 23 dhjetor 2021 nga Operatorit Sistemit të Transmetimit dhe Tregut – KOSTT SH.A (OST/OT) ka pranuar aplikacionin për Shqyrtim të Jashtëzakonshëm të Hyrave të Lejuara për Operatorin e Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT).
- Raport Konsultativ Shqyrtimi i Jashtëzakonshëm i Hyrave të Lejuara Maksimale të Energjisë Elektrike për Operatorët e Rregulluar.
- Raport Konsultativ Shqyrtimi i Strukturës Tarifore për Konsumatorët e Rregulluar të Amvisërive të shërbyer nën FSHU.
- Raport përfundimtar të Hyrat e Lejuara Maksimale të Energjisë Elektrike për Operatorët e Rregulluar, Përgjigje ndaj Komenteve (Viti relevant tarifor 2022).
- Raporti përfundimtar për strukturën tarifore të konsumatorëve të rregulluar të energjisë elektrike i Shqyrtimit të Jashtëzakonshëm të Hyrave të Lejuara Maksimale për operatorët e Rregulluar, përgjigjet në komente te palëve të interesit, i publikuar 8 shkurt 2022.

3.9.2 Blerjet e Energjisë në tregun me shumicë

Si importuese neto i energjisë, Kosova është ndikuar edhe nga rritja e çmimeve evropiane të energjisë elektrike. Kostot e realizuara të blerjes së energjisë me shumicë të Furnizuesit të Shërbimit Universal (FSHU) ishin dukshëm më të larta se kostot e lejuara nga ZRRE dhe ato të realizuara në vitin 2021 dhe projekcioni i kërkuar nga vetë FSHU. Kostoja e propozuar e ZRRE-së për importet e përfshira në tarifa, bazuar në parashikimet e çmimeve në gusht, ishte 90 EUR/MWh për muajt e mbetur të vitit. Parashikimi i vetë Furnizuesit të Shërbimit Universal varionte midis 125 EUR/MWh dhe 143 EUR/MWh. Kostot aktuale të blerjes së energjisë në nëntor arritën në 322.87 euro, që përbën një rritje prej 257% krahasuar me parashikimin e ZRRE-së, e përfshirë në tarifat aktuale dhe një rritje prej 142% krahasuar me parashikimin e Furnizuesit të Shërbimit Universal. Kjo është reflektuar në një ndryshim të ndjeshëm në mes të kostove të lejuara të blerjes së energjisë së importit dhe atyre të realizuara nga sektori.

Çmimet e energjisë elektrike të tregtuara në tregun e ditës në avancë në bursat HUPX/HUDEX kanë qenë të larta, një rritje të konsiderueshme duke arritur kulmin e tij në vlerën 496 Euro/MWh gjatë muajit gusht 2022. Ndërkohë më datë 30 korrik 2022 çmimi në ora 20:00 ka shkuar deri 1,047 Euro/MWh.

Blerjet e energjisë elektrike në tregun me shumicë përfshijnë blerjet e energjisë nga KEK-u, nga gjeneratorët e burimeve të ripërtrithshme të kyçura në rrjetin e transmetimit dhe rrjetin e shpërndarjes, si dhe nga blerjet e energjisë nga importi që realizohen në tregje të organizuara.

Çmimet e prodhimit për Gjeneratorin publik (KEK SH.A) janë të derregulluara nga data 1 prill 2017. Kjo energji ofrohet në tregun e energjisë me shumicë, me prioritet për Furnizuesin me Shërbim Universal, dhe pas përcaktimit të sasive të nevojshme për furnizim me qëllim të mbulimit të kërkesave të konsumatorëve me të drejtë të shërbimit universal, ndërsa pjesa e mbetur e energjisë së prodhuar nga KEK ofrohet në tregun me shumicë.

Përveç blerje të energjisë për furnizimin e konsumatorëve fundor, në tregun me shumicë realizohen tregtimi i energjisë për mbulimin e humbjeve dhe shërbimeve ndihmëse nga Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes.

Prodhimi duhet të jetë i balancuar me kërkesën për energji elektrike në kohë reale, për të mundësuar funksionimin e sigurt të sistemit elektroenergjetik. Sistemi elektroenergjetik i Kosovës është i dizajnuar ashtu që prodhimi i energjisë elektrike varet kryesisht nga termocentralet, por energjia e prodhuar nga gjenerimi vendor nuk mjafton për të mbuluar kërkesën për energji në kohën e kërkesës maksimale, gjithashtu paraqiten teprica gjatë kërkesës minimale. Prandaj për të menaxhuar sistemin elektroenergjetik në mënyrë efikase paraqitet nevoja për importe (gjatë kërkesës maksimale) dhe eksporte (gjatë kërkesës minimale) që realizohen në tregun me shumicë.

Burimet e energjisë elektrike në tregun me shumicë nga të cilat bëhet mbulimi i kërkesës së energjisë në vend janë: prodhimi i energjisë nga KEK-u, hidrocentralet, centralet solare, turbinat me erë dhe blerjet e energjisë nga importi. Të dhënat energjetike dhe financiare të tregut me shumicë të lejuara për vitin 2022 janë të përmbledhura në tabelën në vijim:

Tab. 3.8 Kostot e lejuara për blerje të energjisë

Kostot e lejuara për blerje të energjisë për FSHU	GWh	€/MWh	€'000
Sasitë e furnizuara nga KEK	4,013	29.50	118,373
Gjeneratorët në nivel të OST	591,7	65,77	38,914
Gjeneratorë në nivel të OSSh-së	44,36	44,36	2,030
Importi	127	172	21,805
Gjithsejtë sasitë e furnizuara	4,821	37.57	181,122
Subvencionet			(100,000)
Kostot e blerjes së energjisë pa subvencione			81,122
Kostoja e Marzhës			2,154
Gjithsejtë kostot e blerjes së energjisë	4,821		83,275

Nga të dhënat e paraqitura në tabelën e mësipërme vërehet se kostoja e planifikuar për blerje të energjisë me shumicë pas zbritjes së subvencionit të Qeverisë së Republikës së Kosovës është 83mil€.

3.9.3 Të hyrat e lejuara maksimale për konsumatorët e rregulluar tarifor

Kostot e arsyeshme të cilat janë përdorur për përcaktimin e të hyrave të lejuara maksimale për konsumatorë e rregulluar me obligim shërbimi universal përfshijnë: kostot me pakicë të furnizuesit, kostot e bartshme (kostot e rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes), kostot e blerjeve të energjisë, kapitali punues, borxhi i keq, përshtatjet e kostove të realizuara etj. Të hyrat e furnizuesit me shërbim universal mundësojnë që ai të mbulojë kostot e secilit aktivitet të zingjirit të furnizimit duke filluar

nga aktiviteti i gjenerimit dhe minierave, transmetimit, shpërndarjes deri tek furnizuesi. Pra, furnizuesi mbledh nga konsumatorët fundor kostot e përgjithshme të furnizimit me energji elektrike, të cilat i paguan më pastaj tek secila palë varësisht nga kostot e shërbimit.

Vlenë të theksohet se kostot e blerjes së energjisë nga importet dhe kostot e bartshme (OST/OT dhe OSSH) janë rritur shumë për shkak të rritjes së kostove me shumicë të energjisë në tregje të energjisë elektrike.

Pra të hyra totale të kërkuara nga FSHU janë 468.6 milion euro në raport me 347.3 milion (zbritur për 100 milion të subvencioneve të zotuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës) të lejuara nga ZRRE.

Detajet e këtyre kostove për vitin 2022 janë të paraqitura në tabelën në vijim:

Tab. 3.9 Të hyrat e lejuar maksimale të Furnizuesit me Shërbim Universal

MAR-i i Furnizuesit me Shërbim Universal	Njësia	Propozimi i FSHU-së 2022	Propozimi ZRRE 2022
Parametrat e indeksimit			
Norma e interesit It (t-1)	%		5.53%
Kostot me pakice te furnizuesit			
OPEX - $OPMC_t = OPMC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - E_t) * (1 - P_t)$	€m	5.42	5.41
Korrigjimi për OPEX te vitit 2020 dhe 2021	€m		0.42
Zhvierësimi - $DEPCT = DEPCT_{-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - P_t)$	€m	0.1	0.1
Kostot e bartshme			
Kostot e OST	€m	18.34	20.56
Kostot e OSSH	€m	174.50	179.56
Kostot për fondin e BRE	€m	3.54	3.53
Kapitali punues (WCLCt)			
$WCLC = (1 / 12) * It * (RETRt + WHPCt + PSTCt - NTFRt)$	€m	2.31	1.35
Kostot për blerjen e energjisë			
Kostot e blerjes së energjisë me shumicë	€m	203.30	83.28
Taksa për licencë			
Taksa për licencë	€m	0.07	0.04
Borxhi i keq (BDTA)			
BDTA	%	2.4%	2.4%
BDTA	€m	13.13	9.73
Përshtatjet e të hyrave për FSHU			
Përshtatjet e vitit 2021	€m	47.44	43.30
Të hyrat e lejuara maksimale	€m	468.60	347.28

Më poshtë në mënyrë grafike është paraqitur pjesëmarrja e kostove sipas aktiviteteve në kostot e përgjithshme për furnizim me energji elektrike të konsumatorëve të rregulluar.




Fig. 3.5 Pjesëmarrja e kostove sipas aktiviteteve

Shënim: Fondi për Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë (BRE) është fondi i krijuar dhe menaxhuar nga operatori i tregut në përputhje me rregullën për skemën mbështetëse.

3.9.4 Tarifat e rregulluara për konsumatorët me shërbim universal – Struktura e re

Tarifat e rregulluara të përcaktuara nga ZRRE për vitin relevant tarifaror 2022, janë parashikuar të mbulojnë kostot e shërbimit me energji elektrike për të gjithë konsumatorët e rregulluar nga furnizuesi me shërbim universal. Konsumatorët të cilët janë faturuar me tarifa të rregulluara janë konsumatorët e kyçur në nivelet e tensionit 35kV, 10kV dhe 0.4kV, ndërsa konsumatorët e kyçur në nivelin e tensionit 220kV dhe ata në 110kV furnizohen me çmime të parregulluara (çmime të tregut).

ZRRE përcakton tarifën e rregulluar për konsumatorët që e gëzojnë të drejtën e furnizimit në kushte të shërbimit universal. Kriteret se cilët konsumatorë e gëzojnë këtë të drejtë janë të vendosura në Ligjin për Energjinë Elektrike, sipas të cilit: “Të drejtën e furnizimit me shërbim universal e gëzojnë të gjithë konsumatorët familjar, dhe jo familjar që kanë qarkullim vjetor jo më shumë se dhjetë (10) milion euro, ose jo më shumë se pesëdhjetë (50) punonjës”.

Pas ndarjes së subvencioneve prej 100 milion euro nga Qeveria e Republikës së Kosovës për të mbuluar kostot në rritje të blerjes së energjisë dhe për të ulur ndikimin e tarifave të energjisë te konsumatorët ZRRE ka përcaktuar tarifën me strukturën e re tarifore ku ka rezultuar që: rritje prej 0% të tarifave për konsumatorëve biznesorë dhe konsumatorët shtëpiak për nivelin e konsumit deri në 800 kWh dhe aplikim të tarifës së re prej 12.52 € cent/kWh për energjinë elektrike të konsumuar në kohën e tarifës së lartë dhe 5.90 €cent/kWh për energjinë e konsumuar në tarifën e ulët.

Struktura e tarifave me pakicë e energjisë elektrike për konsumatorët me shërbim universal (tarifat e rregulluara) është dizajnuar ashtu që të mbulojë të hyrat e përcaktuara në vlerë prej 347.28 milion euro.

ZRRE përmes konsultimit publik për Strukturën Tarifore, i publikuar nga ZRRE më 17 janar të vitit 2022, ka propozuar strukturën tarifore dhe nivelin e tarifave të nevojshme për mbulimin e kostove të realizuara të importit. Përmes Raportit Konsultativ, ZRRE kishte potencuar rritjen e ndjeshme të konsumit të energjisë elektrike në Kosovë dhe kishte analizuar ndërlidhjen në mes të rritjes së konsumit të energjisë dhe vendimit të Bordi të ZRRE-së të vitit 2017 për ndryshimin e strukturës tarifore. Struktura tarifore e aplikuar nga viti 2017 nuk përmbante as elemente të sezonalitetit dhe as stimuj të efijencës së energjisë. Për më tepër, ndryshimi i tarifës në vitin 2017 kishte zvogëluar nxitjen për efijencë të energjisë që më parë imponohej nga Bllok-Tarifa Progressive e cila siguronte që një sasi e caktuar e energjisë elektrike të konsumohet me çmim më të përballueshëm ndërsa blloqet e sipërme të reflektojnë koston e ofrimit të asaj energjie në sistem. Ndryshimi i atëhershëm i strukturës tarifore ndikoi në rritje të paqëndrueshme të konsumit të energjisë elektrike në vend. Vëllimi i energjisë elektrike të konsumuar në vitin 2021 ishte 41% më i lartë se ai i vitit 2017. Rritja e konsumit të energjisë u shoqërua edhe me rritje rekorde të ngarkesës maksimale të pikut, që mbingarkoi rrjetet dhe aftësinë e kapaciteteve transformuese për të liferuar këtë energji tek konsumatorët. Diferenca në mes të vitit 2021 dhe të gjitha viteve të mëparshme, veçanërisht gjatë muajve të dimrit, sugjeron një rritje të konsumit të energjisë elektrike dhe përdorimit të energjisë elektrike për ngrohje e që mund të ketë rezultuar nga ngrohja me energji elektrike e konsumatorëve të cilët para ndryshimit të strukturës tarifore mund të kenë përdorur alternativa të tjera.

Struktura re tarifave për konsumatorët familjar ka ndryshuar dhe tani ka dy blloqe tarifore: 0-800 kWh (bloku i parë) dhe >800 kWh (bloku i dytë).

Struktura e tarifave për konsumatorët e rregulluar është paraqitur në tabelën e më poshtme:

Tab. 3.10 Struktura e tarifave të rregulluara për konsumatorët fundor për vitin 2022

Grupi Tarifor	Niveli i tensionit të furnizimit	Elementi Tarifor	Njësia	Koha gjatë	Tarifa
1	35 kV	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		11.19
		Fuqia e angazhuar	€/kW/muaj		5.85
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e Lartë	4.92
			€/kWh	Tarifë e Ulët	3.16
		Energjia reaktive (Q)	€/kVArh		0.67
2	10 kV	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		4.62
		Fuqia e angazhuar	€/kW		5.04
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e Lartë	5.73
			€/kWh	Tarifë e Ulët	3.69
		Energjia reaktive (Q)	€/kVArh		0.67
3	0.4 kV Kategoria I (konsumatorët me energji reaktive)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		2.57
		Fuqia e angazhuar	€/kW		2.97
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e Lartë	6.69
			€/kWh	Tarifë e Ulët	4.96
		Energjia reaktive (Q)	€/kVArh		0.67
4	0.4kV Kategoria II	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		2.97
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e vetme	8.83
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e Lartë	10.71
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e Ulët	5.30
5	0.4kV matësi 2 tarifor (familjarë)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		1.74
		0-800kWh (Blloku i parë)	€/kWh	Tarifë e Lartë	6.75
			€/kWh	Tarifë e Ulët	2.89
		>800kWh (Blloku i dytë)	€/kWh	Tarifë e Lartë	12.52
		€/kWh	Tarifë e Ulët	5.90	
6	0.4kV matësi 1 tarifor (familjarë)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		1.74
		0-800 (Blloku i parë)	€/kWh	Tarifë e Ulët	5.32
		>800 (Blloku i dytë)	€/kWh	Tarifë e vetme	10.07
7	0.4kV (familjarë pa matës)	Konsumi i vlerësuar:			
		Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		1.74
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë mesatare	6.75
8	Ndriçimi Publik	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		3.21
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e vetme	9.24

Tarifa e lartë (ditë) aplikohet prej orës 07:00 - 22:00 gjatë periudhës 1 tetor deri më 31 mars
Tarifa e lartë (ditë) aplikohet prej orës 08:00 - 23:00 gjatë periudhës 1 prill deri më 30 shtator
Konsumatori ngarkohet me energji reaktive mbi atë të lejuarën që korespondon me $\cos(\Phi) < 0.95$

Para dizajnit të tarifave duhet përcaktuar edhe kostot e bartshme të FSHU-së, siç janë kostot për shfrytëzimin e rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes. Këto kosto të bartshme janë të përshkuara në vijim.

3.9.5 Të hyrat dhe tarifat për shfrytëzimin e sistemit të transmetimit, operimin e sistemit dhe tregut

Gjatë vitit 2022, ZRRE ka kryer procesin e shqyrtimit të jashtëzakonshëm dhe përshtatjeve të rregullta vjetore për OST/OT për të marrë në konsideratë: faktorin e efikasitetit, indeksimin e kostove për normën e inflacionit që aplikohet për shpenzimet operative, riparimet & mirëmbajtje. Po ashtu janë aplikuar përshtatjet e kostove të blerjes së humbjeve, shpenzimet e kthimit dhe zhvlerësimit që

rezultojnë nga investimet e planifikuara sipas planit zhvillimor dhe kostot tjera të arsyeshme për operim të sistemit të transmetimit.

ZRRE aplikon “Rregullimin e bazuar në stimuj” e cila bazohet në parimin që tarifatat për monopole natyrore (tarifat e rrjeteve) duhet të vendosën në një mënyrë që imiton konkurrencën, pasi që çdo kompani që operon në një mjedis konkurrues pritet të përmirësojë efikasitetin e tyre operacional.

Me qëllim të sigurisë së furnizimit, liberalizmit dhe integritit të tregjeve të energjisë elektrike, integritit të kapaciteteve të reja gjeneruese, reduktimit të humbjeve dhe përmirësimin e parametrevave tjerë teknik të rrjetit, janë lejuar të hyrat e nevojshme për operimin e rrjetit të transmetimit. Vlen të theksohet se kostot e blerjes së energjisë për mbulimin e humbjeve të lejuara kanë qenë 13.92 milion euro, derisa të realizuara për vitin 2021 kanë qenë 10.83 milion euro, që janë rritur për shkak të rritjes së çmimeve në tregje të energjisë elektrike.

Në tabelën e më poshtme janë paraqitur të hyrat e lejuara maksimale të aprovuara nga Bordi i ZRRE-së për vitin relevant tarifor 2022 për OST/OT.

Tab. 3.11 Të hyrat e lejuara maksimale për OST/OT

Të hyrat e lejuara maksimale për OST/OT -2022	mil€
Shpenzimet Operative	7.35
Zhvlerësimi	12.66
Kthimi I lejuar	11.63
Humbjet e lejuara	13.92
Fondi	10.67
Shërbimet ndihmëse	7.00
Përshtatjet	
Të hyrat e parregulluara	-0.06
Të hyrat nga mekanizmi ITC	-3.60
Përshtatjet për 2017 dhe PR1	-1.26
Të hyrat nga KEK-u	-5.92
Faktori Korigjue i të hyrave KREV	-13.55
MAR-i Final	38.84

Të hyrat e lejuara maksimale për KOSTT do të mblidhen përmes tarifave të aprovuara nga ZRRE bazuar në Metodologjinë e përcaktimit të tarifave të sistemit të transmetimit, Operimit të Sistemit, dhe Operimit të Tregut.

Në tabelën në vijim është prezantuar struktura e tarifave për shfrytëzimin e sistemit të transmetimit, Operimin e Sistemit dhe dhe tregut për vitin relevant tarifor 2022.

Tab. 3.12 Struktura e tarifave të OST/OT për vitin 2022

Grupi tarifor	Elementi tarifor	Njësia	Tarifa
Prodhimi i kyçur në Transmetim	Tarifa e Operatorit të Sistemit	€/MWh	1.965
	Tarifa e Operatorit të Tregut	€/MWh	0.025
Prodhimi i kyçur në Shpërndarje	Tarifa e Operatorit të Sistemit	€/MWh	0.104
	Tarifa e Operatorit të Tregut	€/MWh	0.025
Operatori i Shpërndarjes	Tarifa e Operatorit të Sistemit	€/MWh	1.726
	Tarifa e Operatorit të Tregut	€/MWh	0.023
Furnizimi	Tarifa e SHST 400/220 kV	€/kW/vit	4.745
	Tarifa e SHST 110 kV	€/kW/vit	9.675
	Tarifa e Operatorit të Sistemit	€/MWh	1.726
	Tarifa e Operatorit të Tregut	€/MWh	0.023
	Tarifa e Fondit të BRE	€/MWh	0.732

3.9.6 Të hyrat dhe tarifat për shfrytëzimin e sistemit të shpërndarjes

Pas shqyrtimit të aplikimit të shoqërisë OSSH Sh.a, ZRRE ka shqyrtuar dhe vlerësuar kostot e parashikuara ndaj atyre të realizuara, si dhe treguesve teknikë, ekonomik dhe financiar të operatorit të shpërndarjes të bazuar në Rregullën për të Hyrat e OSSH-së.

ZRRE pas konsultimit publik me të gjitha palët e interesit ka shqyrtuar komentet dhe kërkesat e tyre, dhe më pastaj ka bërë përcaktimin e të hyrave të lejuara maksimale për OSSH-në për vitin 2022.

Vlen të theksohet se kostot e blerjes së energjisë për mbulimin e humbjeve të lejuar në OSSH kanë qenë 106.6 milion euro derisa humbjet e realizuara në vitin 2021 ishin 86.7 milion euro, që janë rritur për shkak të rritjes së çmimeve në tregje të energjisë elektrike.

Në tabelën e më poshtme janë paraqitur të hyrat e lejuara maksimale të aprovuara nga Bordi i ZRRE-së për vitin relevant tarifor 2022 për OSSH.

Tab. 3.13 Të hyrat e lejuara maksimale për OSSH për vitin relevant tarifor 2022

Të hyrat e lejuara maksimale për OSSHë -2022	mil€
Shpenzimet Operative	26.42
Zhvlerësimi	18.36
Kthimi I lejuar	17.17
Obligimet ndaj KOSTT për OS dhe OT parashikim	1.61
Humbjet e lejuara	106.65
Të hyra e parregulluara PRR	-5.50
Përshtatjet (2017 dhe PRR1)	-1.50
Taksa për licencë	0.10
Faktori Korigjue i të hyrave KREV	16.25
MAR-i Final	179.56

Pas përcaktimit të të hyrave e lejuara maksimale duhet përcaktuar tarifat ashtu që të mblidhen të hyrat e aprovuara.

Të hyrat e lejuara maksimale për OSSH do të mblidhen përmes tarifave të aprovuara nga ZRRE bazuar në Metodologjinë e përcaktimit të tarifave për shfrytëzimin e sistemit të shpërndarjes.

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur struktura e tarifave për shfrytëzimin e Sistemit të Shpërndarjes për vitin 2022.

Tab. 3.14 Struktura e tarifave për OSSH për vitin 2022

Tarifat e konsumatorëve të kyçur në OSSH		
Niveli i tensionit	Njësia	Tarifa
35 kV	€/kWh	1.69
10 kV	€/kWh	2.56
0.4 kV	€/kWh	3.86

3.9.7 Vlerat Hyrëse për përcaktimin e të hyrave të lejuara maksimale për PRR3

Gjatë vitit 2022 ZRRE ka përcaktuar Vlerat hyrëse për Periudhën rregullative 2023-2027 që janë parametrat kryesorë të cilat përdoren për llogaritjen e të hyrave të lejuara maksimale të OST/OT-së dhe OSSH-ë. Shqyrtimet e vlerave hyrëse do të iniciohen nga rregullatori kurdo që rrethanat e ndryshuara kërkojnë iniciimin e një shqyrtimi të tillë. Ndryshimet në vlerat hyrëse duhet të bëhen vetëm në atë masë që këto ndryshime të jenë të arsyeshme, të justifikuara dhe të caktuara me kujdes.

OST/OT dhe OSSH mund t'i propozojë rregullatorit shqyrtimit të vlerave hyrëse. Rregullatori do t'i përgjigjet kërkesës së tillë me një shkresë që paraqet arsyetimet për vendimin e ZRRE-së për të filluar apo për të mos filluar shqyrtimin.

Vlerat pasuese specifikohen si vlera fikse të përcaktuara në shqyrtimin periodik, të cilat do të aplikohen gjatë viteve relevante deri në shqyrtimin e vlerave hyrëse dhe përbëhen nga:

- Jetëgjatësia e aseteve;
- Mesatarja e ponderuar e kostos së kapitalit;

- Niveli i lejuar i humbjeve;
- Faktori i ndarjes së humbjeve;
- Faktori i efikasitetit; dhe
- Ndonjë parametër tjetër hyrës që rregullatori mund ta konsiderojë të nevojshëm.

3.9.7.1 Kategorizimi dhe jetëgjatësia e asetëve

Një ndër parametrat hyrës me rëndësi që është përcaktuar në vitin 2018 që përdoret për përcaktimin e të hyrave të lejuara gjatë PRR3 e tutje është “Kategorizimi dhe Jetëgjatësia e Aseteve”. Gjatë përcaktimit të këtyre parametrave, ZRRE ka marrë për bazë jetëgjatësinë teknike, ekonomike si dhe praktikat më të mira rregullatore. Jetëgjatësia e asetëve të aplikuara për asetet brenda RAB futet në nivelin e zhvlerësimit që OSSH merr për ato asete brenda çdo periudhe kontrolli (ose vit). Ky proces është kryer në vitin 2018 përmes konsultimit publik dhe është marrë vendim për jetëgjatësinë e përdorur për OSST/OT.

Kategoritë e asetëve dhe jetëgjatësia për asetet e OST/OT-në është dhënë në tabelën në vijim:

Tab. 3.15 Asetet dhe jetëgjatësia e tyre për OST/OT (KOSTT)

Nr.	Kategoritë e Aseteve	Jetëgjatësia (vjet)
I	Ndërtesat, rrugët, rrjetet e kanalizimeve, furnizimi me ujë, pusët, ashensorët	50
II	Rrjeti i TL, shtyllat	40
III	Rrjeti i tensionit të ulët, nënstacionet, transformatorët, etj.	30
IV	Kamionet, korpa dhe makineri për punë	10
V	Kontrolli dhe Telekomunikimi, pajisje të ndryshme, mbrojtja nga zjarri	8
VI	Mobilet, pajisjet për zyrë	7
VII	Pajisjet e TI, softuerë, patente, licenca, vetura, etj.	5

Një përmbledhje e kategorive të asetëve të përcaktuara për OSSH është dhënë në tabelën në vijim:

Tab. 3.16 Asetet dhe jetëgjatësia e tyre për OSSH (KEDS)

Nr.	Kategoritë e Aseteve	Jetëgjatësia (vjet)
I	Ndërtesat e administratës	50
II	Rrjetet e TM, nënstacionet, transformatorët e energjisë, dhe pajisjet	30
III	Rrjetet e TU, nënstacionet, transformatorët e energjisë, dhe pajisjet	25
IV	Stacionet e transformatorit (TMRR dhe TMT) ⁴ dhe pajisjet	15

⁴ TMRR dhe TMT janë transformatorët matës të rrymës dhe tensionit

V	Njehsorët dhe pajisjet matëse, Kamionë, korpa dhe makineri për punë	10
VI	Mobilet, pajisjet për zyrë	7
VII	Pajisjet e punës, aparatet e pajisjet lexuese, veturat, Kompjuterët, pajisjet TI, softuerët	5

ZRRE ka vendosur kategoritë e aseteve dhe jetëgjatësinë e tyre gjatë shqyrtimit të kaluar periodik (PRR2) dhe nuk e konsideron të nevojshme ndryshimin e tyre.

3.9.7.2 Mesatarja e Ponderuar e Kostos së Kapitalit

ZRRE pas konsultimit publik ka aprovuar “Mesataren e Ponderuar e Kostos së Kapitalit” në seancën e mbajtur më 16 nëntor 2022 e cila do të jetë 7.69% reale. Kjo vlerë aplikohet për tërë periudhën rregullative 2023-2027 për OST/OT dhe OSSH, e cila është paraqitur në tabelën më poshtë:

Tab. 3.17 WACC-u i përcaktuar për PRR3 për OST/OT (KOSTT) dhe OSSH (KEDS)

Parametri	PRR 2	PRR 3
Norma reale pa risk	3.70%	3.65%
Primi i borxhit	3.50%	2.09%
Kostoja reale e borxhit	7.20%	5.74%
Norma e tatimit	10%	10%
Ekuiteti beta	1	0.88
ERP	4.50%	5.04%
Kostoja e kapitalit neto, reale para tatimit	9.10%	8.98%
Kapitali i brendshëm	40%	40%
WACC, reale para tatimit	8.30%	7.69%

Mesatarja e Ponderuar e Kostos së Kapitalit të një firme është kostoja mesatare e fondeve, e cila llogaritet në koston e kapitalit të përdorur aktualisht, si dhe vendimet financiare të marra në periudhat e paraprake. Për të zgjedhur një kosto mesatare, burimet e ndryshme të financimit duhet të peshohen (ponderohen) sipas shumës së secilit financim të mbajtur nga kompania. Këto peshime për burimet e financimit mund të jenë: sipas vlerës kontabël në libra ose vlerat e tregut që përfaqësojnë koston aktuale oportune të financimit.

3.9.7.3 Caku i reduktimit të humbjeve dhe lakorja e humbjeve të lejuara

Një ndër vlerat hyrëse të përcaktuara për periudhën rregullative është edhe caku dhe lakorja e reduktimit të humbjeve në OST dhe OSSH. ZRRE pas konsultimit publik me datë 7 nëntor 2022, ka publikuar Raportin Përfundimtar - Caku për Reduktimin e Humbjeve dhe Përgjigjet ndaj komenteve, të paraqitura nga palët e interesit në lidhje me Raportin Konsultativ, ndërsa vendimi është marrë në seancën e mbajtur më 16 nëntor 2022.

ZRRE ka përcaktuar që objektivi i humbjeve të lejuara për PRR 3 për OST do të jetë 1.75%, i cili bazohet në trendin e humbjeve të realizuara në vitet e fundit 2019, 2020 dhe 2021, si dhe paraqet një stimulim që Operatori i Sistemit të vazhdojë të operojë në nivelin e eficiencës ekzistuese.

ZRRE ka vlerësuar se caqet për reduktimin e humbjeve të OSSH-së në PRR3 në bazë të humbjeve të lejuara në fund të PRR 2, performancës së OSSH-së në PRR1 dhe PRR2, efektin e investimeve të realizuara, mundësit e reale dhe të arsyeshme të investimeve edhe në periudhën e ardhshme bazuar në përvojat nga PRR1 dhe PRR 2, praktikat rregullatore lokale dhe rajonale, trendet e reduktimit të humbjeve në vitet e fundit të OSSH-së, Strategjinë e energjisë për periudhën 2022-2031, etj.

Tab. 3.18 Humbjet e lejuara në rrjete për periudhën e tretë rregullative për periudhën 2023-2027

Humbjet e lejuara	Njësia	2023	2024	2025	2026	2027
Lejimi i humbjeve për OST	%	1.75	1.75	1.75	1.75	1.75
Caku i reduktimit të humbjeve	%		-	-	-	-
Faktori i ndarjes së humbjeve	%	50/50	0	0	0	0
Lejimi i humbjeve për OSSH	%	15.1	14.7	13.3	12.1	11.1
Caku i reduktimit të humbjeve	%	-	0.4	1.4	1.2	1.0
Faktori i ndarjes së humbjeve	%	50/50	0	0	0	0

3.9.7.4 Faktori i Efikasitetit

Faktorët e eficiencës përdoren nga rregullatorët në mbarë botën për të nxitur konkurrencën e tregut në tregjet monopolistike. Ato kufizojnë çmimet e paarsyeshme dhe vendosin stimuj që shoqëritë të funksionojnë në mënyrë efikase. Bazuar në opinionin e ekspertëve dhe faktorët e efikasitetit të zbatuar nga rregullatorët e tjerë, propozimi përfundimtar i ZRRE-së mbetet se duhet të zbatohet një Faktor i Efikasitetit OPEX prej 1.5% në vit për KEDS-in (OSSH) dhe KOSTT-in (OST/OT) gjatë PRR3.

Kjo është në pajtim shtrirjet për faktorët e efikasitetit të bazuar në vendimet rregullatore në rajon si dhe ka mbështetje në krahasimin me performancën rajonale të operatorëve të rrjetit.

Tab. 3.19 Vlerat hyrëse – Faktori i Efikasitetit i përcaktuar për OST/OT dhe OSSH

Vlerat Hyrëse- Faktori i Efikasitetit	Njësia	2023	2024	2025	2026	2027
OST/OT- KOSTT	%	1.5	1.5	1.5	1.5	1.5
OSSH- KEDS	%	1.5	1.5	1.5	1.5	1.5

3.9.8 Tarifat e energjisë termike

Në pajtim me legjislacionin primar – nenet 47 dhe 48 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) është përgjegjëse për përcaktimin e metodologjisë së tarifave dhe aprovimin e tarifave në sektorin e rregulluar të energjisë.

Brenda kompetencave dhe obligimeve të veta ligjore, Zyra e Rregullatorit për Energji ka nxjerrë Rregullën për Vendosjen e Çmimeve të Energjisë Termike. Rregulla përcakton procedurat për dorëzimin, shqyrtimin e aplikacionit tarifor dhe aprovimin e tarifave, si dhe Metodologjinë për llogaritjen e të hyrave maksimale të lejuara dhe tarifave.

Skematikisht, Metodologjia tarifore tregohet si më poshtë:




Fig. 3.6 Skema e llogaritjes së të hyrave të lejuara

Nga paraqitja skematike vërehet se kostot të cilat ndërmarrja duhet t'i mbulojë përbëhen nga kostot operative, nga zhvlerësimi që paraqet mundësinë që ndërmarrja të zëvendësojë asetet e veta, koston e humbjeve të rrjetit dhe kthimin në Bazën e Rregulluar të Aseteve (RAB).

Procesi i përcaktimit të tarifave dhe aprovimit të tyre për sezonin 2022/2023 është bërë në dy hapa:

1. Përcaktimi i të Hyrave të Lejuara Maksimale, bazuar në: i) informatat dhe të dhënat e parashikuara në aplikacionin për tarifa; ii) informatat e paraqitura gjatë raportimit rregullativ të realizimeve në sezonin e kaluar 2021/2022; dhe iii) bashkërendimi mes realizimeve aktuale dhe atyre të projektuara, që është bazuar në dallimin midis të hyrave të planifikuara dhe atyre aktuale të sezonit të kaluar të ngrohjes.
2. Llogaritja e tarifave bazuar në të Hyrat Maksimale të Lejuara dhe në strukturën tarifore.

Për përcaktimin e të Hyrave të lejuara të ndërmarrjeve të energjisë termike (ngrohjes qendrore) për sezonin 2021/2022, në pajtim Rregullën për Vendosjen e Çmimeve të Energjisë Termike, ZRRE ka ndërmarrë si vijon:

- 1) Vlerësimin dhe përcaktimin e kostove operative të lejuara;
- 2) Vlerësimin dhe përcaktimin e zhvlerësimit;
- 3) Përcaktimin e Kthimit të lejuar në RAB (kthimit në investime), i cili përfshin:
 - a) përcaktimin e RAB-it – vlerësimi dhe aprovimi i asetëve të kompanisë, verifikimi dhe aprovimi i investimeve të planifikuara dhe kapitali punues; dhe
 - b) llogaritjen e Normës së kthimit të lejuar (RoR)/ WACC;
- 4) Vlerësimin dhe përcaktimin e koston të lejuar për humbjet në rrjet.

ZRRE-ja ka angazhuar ekspertizën në dispozicion për të bërë një vlerësim sa më real të informatave të parashikuara të dorëzuara nga ndërmarrjet. Është bërë një analizë gjithëpërfshirëse dhe vlerësim i informatave të paraqitura, që është përcjellur me krahasimin e të dhënave respektive nga sezonet

e kaluara, me qëllim që të bëhet përcaktimi (parashikimi) sa më i saktë i të hyrave të lejuara për sezonin 2022/2023.

Në kuadër të shqyrtimit tarifor për ndërmarrjet e energjisë termike: NQ Termokos dhe NQ Gjakova, ZRRE ka hartuar Raportet Rregullative për përcaktimin e të hyrave maksimale të lejuara dhe për përcaktimin e tarifave të energjisë termike për sezonin 2022/2023.

Pas shqyrtimit të dokumenteve përkatëse të shqyrtimit tarifor, në seancën e 12 tetorit 2022, Bordi i ZRRE-së ka aprovuar të Hyrat e Lejuara Maksimale (HLM) për NQ Termokos për sezonin 2022/2023, në vlerë prej 8,233,676 €. Tarifat e reflektuara nga HLM të NQ Termokos për sezonin e ngrohjes 2022/2023, kanë mbetur në të njëjtin nivel me ato të sezonit të kaluar.

Vendimet e nxjerra:

- V_1602_2022 -për aprovimin e të Hyrave Maksimale të Lejuara (MAR) për NQ Termokos që do të mblidhen nga tarifrat e energjisë termike (ngrohjes) për konsumatorët fundorë për sezonin 2022/2023;
- V_1603_2022 -për aprovimin e tarifave të energjisë termike për konsumatorët fundorë të NQ Termokos për sezonin e ngrohjes 2022/2023.

Ndërsa për NQ Gjakovën, pas shqyrtimit të raporteve dhe dokumenteve përkatëse, të Hyrat e Lejuara Maksimale (HLM) janë aprovuar në vlerë 839,755 €, në seancën e Bordit të ZRRE-së të datës 29 dhjetor 2022. Gjithashtu, tarifrat e reflektuara nga HLM të NQ Gjakova për sezonin e ngrohjes 2022/2023, kanë mbetur në të njëjtin nivel me ato të sezonit të kaluar.

Vendimet e nxjerra:

- V_1640_2022 -për aprovimin e të Hyrave Maksimale të Lejuara (MAR) për NQ Gjakova që do të mblidhen nga tarifrat e energjisë termike (ngrohjes) për konsumatorët fundorë për sezonin 2022/2023;
- V_1641_2022 -për aprovimin e tarifave të energjisë termike për konsumatorët fundorë të NQ Gjakova për sezonin e ngrohjes 2022/2023.

Struktura dhe nivelet e tarifave të Energjisë termike për NQ Termokos dhe NQ Gjakova është paraqitur si më poshtë.

Tab. 3.20 Struktura e tarifave të energjisë termike për vitin 2022/2023

Tarifat e energjisë termike - Sezoni 2022/2023					
Komponentët e tarifës me matje	Njësia	NQ Termokos		NQ Gjakova	
Tarifa Mujore për Kapacitetin Termik (komponenta fikse)	[€/kW/muaj]	0.78		0.85	
Tarifa për Furnizim/Konsum të En. Term. (komponenta variabile)	[€/MWh]	36.25		54.65	
Komponentët e tarifës pa matje	Njësia	Konsumatorë shtëpiak	Konsumatorë Kom.&Inst.	Konsumatorë shtëpiak	Konsumatorë Kom.&Inst.
Tarifa mujore për Kapacitetin Termik (komponenta fikse)	[€/m ² për muaj]	0.11	0.14	0.09	0.13
Tarifa për Furnizim/Konsum të En. Term. (komponenta variabile)	[€/m ² për muaj]	0.65	0.81	0.81	1.16
Gjithsej tarifa për konsumatorët pa matje	[€/m ² për muaj]	0.76	0.95	0.90	1.29

3.10 Aktiviteti i Rregullatorit në fushën e mbrojtjes së konsumatorëve

Në përputhje me nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, Rregullatori është përgjegjës për zgjidhjen e ankesave dhe kontesteve ndërmjet konsumatorëve dhe ndërmarrjeve të energjisë, operatorëve të sistemit dhe ndërmarrjeve energjetike, si dhe ndërmjet dy ndërmarrjeve energjetike. Përveç kompetencave tjera të dhëna në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, ZRRE është përgjegjës për sigurimin e aplikimit të legjislacionit për mbrojtjen e konsumatorëve në sektorin e energjisë në Kosovë.

Sipas dispozitave të Rregullës për zgjidhjen e ankesave dhe kontesteve në sektorin e energjisë, të gjithë konsumatorët kanë të drejtë që të parashtrijnë ankesa që kanë të bëjnë me shërbimet e ofruara nga furnizuesi ose operatori i sistemit, e që këto ankesa fillimisht duhet t'i drejtohen furnizuesit ose operatorit të sistemit, si organi i shkallës së parë, i cili bën shqyrtimin e ankesës dhe nxjerr përgjigje brenda afatit ligjor. Konsumatori pas marrjes së përgjigjes mund t'i drejtohet Rregullatorit për shqyrtim të mëtutjeshëm të ankesës së tij.

Rregullatori gjatë vitit 2022 ka regjistruar 118 ankesa zyrtare të konsumatorëve të cilët kanë shfrytëzuar të drejtën e tyre kundër përgjigjeve të lëshuara nga ana e Furnizuesit, Operatorit të sistemit të shpërndarjes dhe KOSTT, ka kthyer në rishqyrtim 109 ankesa të Furnizuesit dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, si dhe 62 ankesa të konsumatorëve lidhur me shqyrtimin e saktësisë së matjes. Gjatë vitit 2022 Rregullatori ka të regjistruar edhe 3 konteste të ngritura të të licencuarve (ndërmarrjeve energjetike), përkatësisht kontestin e ngritur nga KOSTT kundrejt KEDS dhe KESCO si dhe kontestin kundër KEK. Rregullatori përveç ankesave të konsumatorëve të regjistruara dhe të zgjidhura, ka ofruar mbështetje edhe në dhënien e informacionit, shpjegimeve, konsultimeve verbale, postës elektronike, si dhe përmes telefonit për të gjithë konsumatorët e energjisë.

Numri i ankesave të pranuar sipas kategorive të konsumatorëve është paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tab. 3.21 Ankesat e konsumatorëve sipas kategorive, 2022

Ankesat e konsumatorëve sipas kategorive	Numri	Përqindja [%]
Konsumator shtëpiak	88	74.58
Konsumator komercial	28	23.73
Konsumator industrial	2	1.69
Gjithsej	118	100.00

Në figurën e mëposhtme është paraqitur numri i ankesave të konsumatorëve sipas natyrës së tyre.




Fig. 3.7 Numri i ankesave të konsumatorëve sipas natyrës së tyre

Më poshtë është paraqitur sqarimi i natyrave të ankesave të konsumatorëve të regjistruara për vitin 2022:

- **Kontestimi i faturave të energjisë elektrike**, ka të bëjë me ankesat e konsumatorëve për rastet e gabimeve në lexim dhe leximeve jo të rregullta, e që me këtë rast konsiderohet se kanë dhënë një pasqyrim jo të saktë të gjendjes reale të shpenzimit të energjisë elektrike.
- **Kontestimi i shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike**, ka të bëjë me ankesat e konsumatorëve, të cilët ndërmarrja e energjisë i ka ngarkuar me fatura për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike (rikthim i humbjeve). ZRRE në bazë të Ligjit për Energjinë elektrike dhe dispozitave ligjore të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe kontesteve në sektorin e Energjisë për këto raste të ankesave është jokompetente, dhe i ka udhëzuar konsumatorët që t'i drejtohen Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative.
- **Kontestimi i lidhjeve/kyçjeve të reja**, ka të bëjë me ankesat e konsumatorëve të cilëve ju është mohuar e drejta për lidhje të re nga operatori i sistemit të shpërndarjes. Në këto raste të ankesave, konsumatorët për të realizuar lidhjen e re janë detyruar nga ndërmarrja që së pari të kryejnë pagesat e borxheve në shifrën e vjetër e cila ka ekzistuar më herët.
- **Kontestimi i ngarkesave shtesë**, ka të bëjë me ankesat e konsumatorëve lidhur me faturimet shtesë nga faturimi i rregullt. Këto ankesa janë si rezultat i mos regjistrimit të saktë të shpenzimit të energjisë elektrike, si rrjedhojë e defektit të ndonjë sistemi matës.
- **Kontestimi i borxhit të energjisë elektrike**, ka të bëjë me ankesat e konsumatorëve që kanë të bëjnë me problemet rreth mos definimit të saktë të borxhit të energjisë elektrike të pa inkasuar nga ana e furnizuesit në rastet e shitblerjes së pronës, dhe për pronat që kanë qenë të uzurpuara.

- **Kontestim i grupit tarifor**, ka të bëjë me ankesat e konsumatorëve për ndërrim të grupit tarifor, e ku konsumatorët kërkojnë që për arsye të ndryshme të ndërrojnë grupin tarifor.
- **Kontestimi i Pelqimeve elektroenergjetike**, ka të bëjë me ankesat e konsumatorëve apo edhe të aplikuesve për lidhje të reja dhe të cilët kanë të bëjnë me zgjidhjet teknike të ofruara nga operatori i sistemit.
- **Kontestimi i faturave të ngrohjes “Termokos”**, ka të bëjë me ankesat e konsumatorëve të cilët kanë kontestuar borxhet dhe me hershme të akumuluar për shkak të mos ngrohjes cilësore.

Gjatë vitit 2022, Rregullatori ka zgjidhur 291 ankesa të konsumatorëve, ku përfshihen edhe ankesat të cilat janë kthyer për rishqyrtim tek furnizuesi dhe operatori i sistemit të shpërndarjes, si dhe kërkesat e konsumatorëve për shqyrtimin e saktësisë së matjes. Nga numri i përgjithshëm i ankesave të zgjidhura, 220 prej tyre janë vendosur në favor të konsumatorëve apo shprehur në përqindje 75.60%, ndërsa 71 ankesa të konsumatorëve apo 24.40% janë refuzuar si të pabaza. Të gjitha ankesat e shqyrtuara nga ana e operatorëve, e të cilat janë proceduar te Rregullatori, janë rishqyrtuar edhe njëherë nga Rregullatori me qëllim të vërtetimit të zgjidhjes së plotë të ankesave sipas kërkesave të konsumatorëve, si dhe janë njoftuar konsumatorët. Në të gjitha rastet e rishqyrtuara konsumatorët janë pajtuar me zgjidhjet e ofruara.




Fig. 3.8 Ankesat e zgjidhura, 2022

Numri i ankesave të konsumatorëve, të regjistruara dhe zgjidhura nga Rregullatori sipas viteve është paraqitur në figurën e mëposhtme.




Fig. 3.9 Ankesat e konsumatorëve të regjistruara dhe zgjidhura 2011-2022

3.10.1 Vendimet e Bordit të Rregullatorit në fushën e mbrojtjes së konsumatorëve

Në bazë të Rregullës për zgjidhjen e ankesave dhe kontesteve në sektorin e energjisë, konsumatorët dhe të licencuarit kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë kundër vendimit të Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve (DMK) si instancë e shkallës së parë në Bordin e Rregullatorit si instancë e shkallës së dytë.

Gjatë vitit 2022 konsumatorët kanë parashtruar 16 ankesa në Bordin e Rregullatorit kundër vendimeve të DMK. Nga 16 ankesat e regjistruara, Bordi i Rregullatorit i ka shqyrtuar të gjitha këto ankesa dhe i ka refuzuar si të pabaza.

Furnizuesi KESCO gjatë vitit 2022 ka parashtruar 9 ankesa në Bordin e Rregullatorit kundër vendimeve të DMK. Nga 9 ankesat e regjistruara Bordi i ka shqyrtuar të gjitha këto ankesa dhe i ka refuzuar si të pabaza.

Gjithashtu gjatë vitit 2022 Bordi i Rregullatorit ka shqyrtuar 6 rekomandime të nxjerra nga DMK për ankesat e konsumatorëve komercial dhe industrial, me ç'rast Bordi ka aprovuar të gjitha këto rekomandime.

3.10.2 Aktivitetet tjera në mbrojtjen e konsumatorëve

ZRRE gjatë këtij viti raportues, përveç ankesave të regjistruara, stafi i Rregullatorit ka zhvilluar edhe 756 takime dhe 985 biseda telefonike me palët, përfshirë edhe komunikimin elektronik, të cilët i janë drejtuar zyrës për çështje të ndryshme kontraktuale mes konsumatorëve dhe të licencuarve. Gjatë komunikimit me konsumatorët, stafi i Rregullatorit i ka sqaruar çështjet e ngritura nga konsumatori, si dhe ka udhëzuar palët për rregullat, procedurat, si dhe për të drejtat dhe detyrimet e tyre lidhur me furnizimin me energji.

Gjatë vitit 2022 Rregullatori ka pranuar edhe 26 ankesa të konsumatorëve përmes postës, të cilat edhe përkundër faktit që është dashur t'iu drejtohen të licencuarve apo gjykatave, insistimi i tyre ka qenë që t'i drejtohen Rregullatorit për zgjidhjen e ankesave të tyre. Vlen të theksohet se natyra e këtyre ankesave kryesisht ka qenë për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike, kompensim

dëmi apo edhe kërkesa të cilat nuk janë në domenin e shqyrtimit të rregullatorit. Rregullatori në të gjitha këto raste i'u është përgjigjur me shkrim konsumatorëve duke i udhëzuar të njëjtit për procedurat e mëtejme lidhur me ankesat e tyre.

Ashtu edhe si viteve të mëhershme, por edhe gjatë vitit 2022 Rregullatori ka pasur bashkëpunim të ngushtë edhe me Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, ku gjatë këtij viti raportues ka pranuar edhe disa ankesa të konsumatorëve nga ky institucion. Këto ankesa janë pranuar dhe shqyrtuar nga ana e Rregullatorit në përputhje me dispozitat ligjore.

Gjatë vitit 2022 një numër i vendimeve të Rregullatorit janë apeluar nga palët e pakënaqura në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative dhe Gjykatën Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështje Administrative, për të vlerësuar ligjshmërinë e vendimeve administrative. Rregullatori gjatë vitit 2022 në bazë të vendimeve të Gjykatës Themelore në Prishtinë ka përgatitur 16 përgjigje në padi, 5 përgjigje në ankesa, 3 ankesa kundër paditësve KEDS, KESCO dhe konsumatorëve ndaj vendimeve të Bordit të Rregullatorit. Përveç përgjigjeve në padi, duhet theksuar se gjatë këtij viti raportues Rregullatori ka qenë i angazhuar edhe në 31 seanca gjyqësore në Gjykatën Themelore në Prishtinë dhe Gjykatën Komerciale si palë e paditur. Vlen të theksohet se edhe si vitet paraprake po ashtu edhe në këtë vit raportues numri i proceseve gjyqësore që Rregullatori ka ndjekur vazhdon të jetë i lartë dhe po kërkon angazhim mjaft të madh.

Është më rendësi të theksohet se deri më tani asnjë vendim i Rregullatorit në procedurën administrative nuk është kthyer në rishqyrtim si pasojë e moszbatimit të ligjshmërisë nga organi administrativ, por që të gjitha këto padi kundër vendimeve të Rregullatorit janë refuzuar si të pabaza duke lënë në fuqi vendimet e atakuara.

4 BASHKËPUNIMI ME PALËT TJERA DHE TRANSPARENCA

ZRRE ka treguar transparencë të plotë në ushtrimin e funksionit të saj duke mbajtur seancat e Bordit të hapura për publikun dhe duke publikuar të gjitha vendimet. Përmes komunikatave, njoftimeve, përgatitjes së buletinit dhe publikimeve të tjera në faqen elektronike dhe atë në Facebook është informuar publiku i gjerë me kohë për të gjitha aktivitetet dhe ngjarjet e ZRRE.

Të gjitha palët e interesuar mund të kenë në dispozicion të dhënat e publikuara duke u qasur drejtpërdrejt përmes faqes elektronike të ZRRE në lidhjen: <http://www.ero-ks.org/zrre/sq/te-dhena>.

Po ashtu me qëllim të informimit sa më të mirë, ZRRE vazhdimisht ka informuar konsumatorët dhe publikun e gjerë për të gjitha aktivitetet që ka zhvilluar. Me këtë qëllim gjatë vitit 2022 janë lëshuar mbi tetëdhjetë e dy njoftime dhe komunikata të cilat u janë dërguar mediave dhe janë publikuar në faqen elektronike dhe atë të facebook.

4.1 Përfshirja e Publikut në proceset rregulative përmes Konsultimeve Publike

ZRRE gjatë vitit 2022 ka zhvilluar 16 diskutime publike për shqyrtimin e dokumenteve të ndryshme rregulative.

- Zyra e Rregullatorit për Energji në fillim të dhjetorit 2021 ka filluar procesin e shqyrtimit të jashtëzakonshëm të tarifave për aktivitetet në sektorin e energjisë elektrike. ZRRE-ja ka publikuar Raportet Konsultativ në të cilat janë paraqitur qëndrimet e ZRRE-së për shqyrtimin e jashtëzakonshëm të tarifave për të mbuluar ndryshimin e ndjeshëm në kostot e blerjes së energjisë elektrike dhe për të rivendosur furnizimin me energji elektrike për konsumatorët. Krahas këtij raporti është publikuar edhe raporti konsultativ që kishte për synim të marrë qëndrimet e palëve të interesit për propozimet e ZRRE-së për ndryshimin e strukturës tarifore për të rritur eficiencën e konsumit të energjisë elektrike.
- Me 7 shkurt 2022, Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE), në seancën e tij të tretë (III) ka aprovuar të Hyrat e Lejuara Maksimale për operatorët e rregulluar (Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Tregut/KOSTT; Operatori i Sistemit të Shpërndarjes/KEDS dhe Operatori për Furnizim me Shërbim Universal FSHU/KESCO). Të Hyrat e Lejuara Maksimale për Furnizuesin me Shërbim Universal FSHU/KESCO janë aprovuar në vlerë prej 347.15 milion€, për Operatorin e Sistemit të Transmetimit dhe Tregut/KOSTT janë aprovuar në vlerë prej 38.84mil€, për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes/KEDS janë aprovuar në vlerë prej 179.56mil€. Aprovimi i të Hyrave të Lejuara Maksimale për Furnizuesin e Shërbimit Universal (FSHU) është përshtatur për 90 milion euro të subvencionit të fundit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, si dhe 10 milion euro të alokuara në janar 2022, për blerjet e energjisë elektrike për konsumatorët e rregulluar.
- Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE), në seancën e tij të IV-të ka aprovuar tarifën e energjisë elektrike për vitin tarifor 2022, për Operatorin e Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (KOSTT); Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (KEDS) dhe për Furnizuesin me Shërbim Universal (KESCO). Tarifën me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët jo familjarë, në kuadër të Shërbimit Universal do të mbesin të njëjta si vitin e kaluar ndërsa tarifën për

konsumatorët familjarë, për nivelin e konsumit deri në 800 kWh në muaj, do të mbesin të njëjta, ndërsa diferenca e konsumit mbi 800 kWh për muaj, do të faturohet me tarifën e ulët (gjatë natës) prej 5.9 dhe tarifën e lartë (gjatë ditës) prej 12.52 cent.

- Me 14 mars, ZRRE ka vënë në diskutim publik Raportin e Vlerësimit të Konkurrencës në Sektorin e Energjisë në Kosovë 2020-2021. Raporti ka ofruar një analizë të konkurrencës në tregun e energjisë elektrike me shumicë dhe pakicë në Kosovë gjatë viteve 2020 dhe 2021 dhe bazohet në analizën e strukturës së tregut dhe indekseve të përqendrimit të tregut si përqindja e tregut, HHI, raporti i përqendrimit (RP), Treguesi i Furnizuesit Kryesor (PSI) dhe Indeksi i Furnizimit Rezidual (RSI).
- Me 8 prill, ZRRE ka vënë në diskutim publik plotësim ndryshimin e Rregullës për Vendosjen e Çmimeve të Energjisë Termike dhe Rregullën për Zhvillimin e Profileve të Ngarkesave në Sistemin Energjetik në Kosovë.
- Me 28 prill, ZRRE ka vënë në diskutim publik Metodologjinë e Taksave për Kyçje në Rrjetin e Shpërndarjes. Metodologjia e Taksave për Kyçje në Rrjetin e Shpërndarjes ka për qëllim që të përcaktojë taksat për kyçje në rrjetin e shpërndarjes të aplikuesve të ri dhe taksat për ngritjen e kapacitetit për shfrytëzuesit aktual të rrjetit shpërndarës, si dhe të sigurojë procedura dhe informata gjithëpërfshirëse për përdoruesit ekzistues dhe përdoruesit e ardhshëm të sistemit të shpërndarjes, të cilët kërkojnë kyçje të reja ose modifikime të kyçjeve ekzistuese.
- Duke qenë se këto kërkesa kanë drejtpërdrejtë implikime në Metodologjinë e Taksave për Kyçje në Rrjetin e Shpërndarjes, ZRRE ka ftuar në dëgjim publik të gjitha Odat Ekonomike në Kosovë dhe Shoqërinë Civile, për tu konsultuar dhe debatuar lidhur me këtë Metodologji në mënyrë që pastaj ZRRE të vlerësojë mundësitë për ndryshime eventuale bazuar në dispozitat ligjore në fuqi.
- Me 5 maj, ZRRE ka vënë në diskutim publik Plotësim/Ndryshimin e Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë.
- Me 13 qershor, ZRRE ka vënë në diskutim publik Parimet e Përcaktimit të Tarifave për Shfrytëzimin dhe Taksave për Kyçje në Sistemin e Shpërndarjes. Qëllimi i miratimit të ndryshimeve dhe plotësimeve të kësaj Rregulle është që të vendosen parimet për përgatitjen e Metodologjive nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) mbi përcaktimin e tarifave për shfrytëzim dhe taksave për kyçje në sistemin e shpërndarjes.
- Me 13 korrik, ZRRE ka vënë në diskutim publik Planin Zhvillimor të Ndërmarrjes N.P Termokos Sh. A. Ky Plan zhvillimor dhjetëvjeçarë i sistemit të energjisë termike, përmban masat dhe planifikimet në mënyrë që të garantohet përshtatshmëri e sistemit, siguri e furnizimit me ngrohje për konsumatorët e kyçur në këtë sistem, planifikimet për zhvillimin, modernizimin dhe zgjerimin e rrjetit të ngrohjes në qytetin e Prishtinës.
- Me 13 shataor, ZRRE ka vënë në diskutim publik Raportet Konsultative për Vlerat Hyrëse për Periudhën Rregullative 2023 – 2027 për Operatorin e Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (OST/OT-KOSTT) dhe Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH-KEDS).
- Në shator, ZRRE ka vënë në diskutim publik Raportin Rregullativ për përcaktimin e të Hyrave Maksimale të Lejuara për ngrohtoren e qytetit Termokos Sh.A. Raporti paraqet shqyrtimin e kërkesës dhe vlerësimin preliminar për të Hyrat e Lejuara për sezonin 2022/2023 të ndërmarrjes Termokos Sh.A. Raporti është përgatitur bazuar në Rregullën për Vendosjen e

Çmimeve të Energjisë Termike, përmes të cilës përcaktohen procedurat për dorëzimin, shqyrtimin e aplikacionit tarifor dhe aprovimin e tarifave, si dhe metodologjia për llogaritjen e të hyrave të lejuara dhe tarifave.

- Me 4 tetor, Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka publikuar Draft/Rregulla për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapacitete të Reja Gjeneruese, Sistemeve të Reja të Transmisionit dhe Distribucionit të Gazit, përfshirë Interkonektorët, Tubacionet Direkte për Energji Termike dhe Linjat Direkte të Energjisë Elektrike dhe Tubacionet Direkte të Transmisionit të Gazit Natyrorë.
- Me 2 nëntor, Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka publikuar Rregullën për Konsumatorët vetë-gjenerues. Kjo Rregull përcakton parimet dhe mekanizmin e rregulluar për mbështetjen e konsumatorëve të energjisë elektrike që dëshirojnë të gjenerojnë energji elektrike në ambientet e tyre bazuar në teknologjinë e ripërtëritshme për përdorim vetanak, ndërtimin e kapaciteteve vet-gjeneruese, parimet e mbështetjes së Prosumatorëve dhe procedurën e aplikimit për t'u bërë Prosumator, Skemën Mbështetëse të Faturimit Neto, tarifën e Prosumatorëve si një kontribut adekuat në uljen e ndikimit të tyre në koston e sistemit energjetik, kërkesat minimale teknike për instalimet e teknologjisë së ripërtëritshme të Prosumatorëve dhe rregullimin e mekanizmit të Prosumatorëve që veprojnë Bashkërisht për banesat/ndërtesat kolektive.
- Me 15 nëntor, Zyra e Rregullatorit për Energji, ka vendosur në diskutim Rregullat e APLEX, përkatësisht, Procedura e Tregtimit, Rregullat e ALPEX-it, Kushtet e Përgjithshme, Procedura e Klerimit dhe shlyerjes dhe Përkufizimet e Alpex.
- Me 4 dhjetor, Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE), ka vendosur në konsultim publik Planin Zhvillimor i Transmetimit 2023-2032; Planin Zhvillimor të Rrejtit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes 2023-2032
- Me 10 dhjetor 2022, Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE), ka vendosur në konsultim publik draftin e Bilancit vjetor të energjisë elektrike për vitin 2023. Ky Bilanc është hartuar nga Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Tregut KOSTT sh. a. në pajtim me Ligjin Nr. 05/L-081 për Energjinë (Neni 8) si dhe dokumentin Rregulla dhe metodologjia për përgatitjen e bilanceve të energjisë elektrike. Bilanci vjetor i energjisë elektrike paraqet planin vjetor të shpenzimit të energjisë elektrike në raport me energjinë elektrike në dispozicion. Bilanci vjetor i energjisë elektrike bazohet në nevojat e planifikuara të konsumit të energjisë elektrike për vitin 2023, i cili është parashikuar të furnizohet nga gjenerimi vendor dhe importi i energjisë elektrike. Po ashtu në bilanc parashikohet edhe eksportimi i tepricave të energjisë elektrike.

4.2 Raportimi dhe bashkëpunimi me Kuvendin e Kosovës

Si çdo vit edhe gjatë vitit 2022 rregullatori ka vazhduar me raportimet e rregullta në Kuvendin e Kosovës si dhe sipas kërkesave që ka marrë nga komisionet parlamentare ka pasur edhe raportime të tjera lidhur me çështje të ndryshme rregullative të sektorit të energjisë.

- Bordi i Rregullatorit, gjatë vitit 2022, kanë paraqitur Raportin vjetor për vitin 2021 para Komisionit Parlamentar për Ekonomi, Punësim, Tregti, Industri, Ndërmarrësi dhe Investime Strategjike. Përfaqësuesit e Rregullatorit kanë raportuar për aktivitetet që ndërlidhen me

fushëveprimin e Rregullatorit, si dhe funksionimin e sektorit të energjisë, duke analizuar të dhënat e të licencuarve, përfshirë edhe zhvillimin e tregut të energjisë në Kosovë.

- Bordi i Rregullatorit, me 07.11. 2022, kanë paraqitur Raportin vjetor financiar për vitin 2021 para Komisionit Parlamentar për Buxhet, Punë dhe Transfere.
- Me kërkesë të Komisionit për Ekonomi, Punësim, Tregti, Industri, Ndërmarrësi dhe Investime Strategjike. ZRRE-ja përgjatë vitit 2022 ka përgaditur dhe dorëzuar raportet e rregullta tremuore në të cilat janë përshkruar me detale aktivitetet e ZRRE-së dhe gjenda e Sektorit të Energjisë.

4.3 Takime me palët e tjera të interesit

Kryesuesi i Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji z. Ymer Fejzullahu, ka marrë pjesë në edicionin Java e Zhvillimit të Qëndrueshëm në Kosovë. Kryesuesi i Bordit ka qenë pjesë e Panelit ku është diskutuar Pakoja e Pastër e Energjisë, Mundësitë legjislative dhe zbatuese për Kosovën. Kryesuesi i Bordit ka ndarë me pjesëmarrësit, të arriturat e deritashme me zbatimin e kornizës ligjore rregullative aktuale që mbulojnë fushën e Burimeve të Ripërtëritshme dhe perspektivën e ardhshme në zhvillimin e kornizës rregullative që do të mundësojnë zbatim efektiv të ligjeve dhe tranzicion të suksesshëm në të ardhmen.

Bordi i ZRRE, ka mbajtur një takim të përbashkët me përfaqësuesit e Ambasadës Amerikane në Kosovë, të cilët, për së afërmi u njoftuan rreth zhvillimeve të fundit në sektorin e energjisë, dhe në veçanti, u diskutua rreth situatës së krijuar si pasojë e procesit gjyqësor, në të cilin proces, me një vendim për masë të përkohshme, është pezulluar ekzekutimi i vendimit të ZRRE-së për tarifat me pakicë të energjisë elektrike. ZRRE i njoftoi përfaqësuesit e Ambasadës Amerikane për paqartësitë e implementimit si edhe për vështirësimin e mëtejshëm të situatës tashmë të rënduar të sektorit të energjisë në vend. Ndër të tjera diskutime, u elaboruan edhe veprimet procedurale të ndërmarra në këtë proces nga ZRRE, e së fundmi me parashtrimin e mjetit të jashtëzakonshëm juridik, krahas kërkesës për Mendim Juridik, në Gjykatën Supreme të Kosovës, si edhe me kërkesat tjera për sqarime ligjore tek organet kompetente të drejtësisë lidhur me implementimin e vendimit gjyqësor.

Bordi i ZRRE, ka mbajtur një takim të përbashkët me përfaqësuesit e Agjencisë Franceze për Zhvillim (AFD), për të diskutuar për rrethanat dhe sfidat me të cilat është duke u ballafaquar aktualisht sektori i energjisë. Në këtë takim u diskutuan gjithashtu edhe nevojat potenciale për investime në këtë sektor, e në veçanti për mundësitë e investimeve në projekte të burimeve të ripërtëritshme të energjisë dhe në projekte për efikasitet të energjisë, përmes ofrimit të kredive dhe granteve për mbështetje dhe asistencë teknike në zhvillimin e tyre.

Me 23 Mars, 2022, Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji priti në takim delegacionin e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Agjencisë së Energjisë të Danimarkës. Në kuadër të takimit u diskutua rreth gjendjes aktuale të sektorit të energjisë, duke përfshirë rolin e ZRRE-së në këtë sektor dhe planet për zhvillimin e këtij sektori. Në këtë takim u diskutuan edhe fushat e bashkëpunimit në mes ZRRE-së dhe Agjencisë së Energjisë të Danimarkës (DEA), e cila është duke shqyrtuar opsione të ndryshme për mbështetje të tranzicionit të energjisë në Kosovë.

Bordi i ZRRE, ka mbajtur një takim të përbashkët me grupin Parlamentarë të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, të cilët, për së afërmi u njoftuan rreth zhvillimeve në sektorin e energjisë.

ZRRE i njoftoi grupin parlamentar të AAK-së me punën që është duke u bërë në këtë institucion rreth sigurisë së furnizimit në vend dhe planet e ZRRE-së, që energjia që konsumohet të jetë me kosto të përballeshme për konsumtorë. Po ashtu grupi parlamentar i AAK -së u njoftua me rrjedhat e energjisë në vend gjatë kësaj periudhe duke përfshirë edhe importin dhe eksportin. Ndër të tjera diskutime, u elaboruan edhe veprimet procedurale të ndërmarra nga ZRRE-ja gjatë Licencimit të Eletrosever dhe pritjet për përmbushjen e Obligimet nga palët që dalin nga Vendimi i ZRRE-së.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji priti në takim delegacionin e Bankës Botrore, Bordi ka njoftuar delegacionin e bankës Botërore për zhvillimet e fundit në sektorin e Energjisë si dhe me sfidat me të cilat po ballafaqohet ku sektor. Tutje gjatë takimit është diskutuar rreth Strategjisë së Energjisë 2022-2031, përfshirë këtu edhe kontributin e Zyrës së Rregullatorit për Energji.

Bordi i ZRRE, ka mbajtur një takim të përbashkët me përfaqësuesit e MCC-së, për të diskutuar rreth modaliteteve të implementimit të programit i cili ndërthet në vete tri projekte, rezervat dhe arbitrazh i energjisë (bateritë me kapacitet 170 MW, që ofrojnë rezervë për 340MWh), zhvillimin e fuqisë punëtore dhe përfshirjen e grave në sektorin e energjisë si edhe Projektin e Institucionit Amerikan të Katalizatorit për Zhvillim, ku në tërësi, këto projekte arrijnë vlerën e mbi 200 milion dollarëve.

Bordi i ZRRE, ka pritur në takim përfaqësuesit e KFOR-it Britanik, të cilët u njoftuan për së afërmi me gjendjen aktuale të sektorit të energjisë. Ndër të tjera, u diskutua rreth situatës së krijuar si pasojë e vendimit të Gjykatës së Apelit, sfidat dhe vështirësitë që i ka shkaktuar ky vendim në implementim, si edhe tema tjera që ndërlidhen me sektorin e energjisë.

4.4 Bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare

Bashkëpunimi me NARUC/TETRATECH/USAID

Përfaqësues të ZRRE-së kanë marrë pjesë në Programin e Barazisë Gjinore për Fuqinë Punëtore. Ky program i financuar nga USAID u është ofruar industrive që tradicionalisht janë të dominuara nga burrat. Ky është një program që u dedikohet udhëheqësve të kompanive/institucioneve dhe zhvillon aftësitë dhe mjetet e nevojshme për të rritur barazinë gjinore, diversitetin dhe përfshirjen në vendin e punës. Programi ka bërë vlerësimin organizatës në lidhje me barazinë gjinore, dhe ka ofruar trajnim për menaxhimin e ndryshimit duke përgatitur menaxherat të bëhen agjentë të ndryshimit brenda organizatës. Programi ka zhvilluar aftësitë për të cilat menaxherët kanë pasur nevojë:

- Të identifikojnë boshllëqet e barazisë gjinore brenda organizatës;
- Të zhvillojnë një rast që demonstroi se si organizata do të përfitojë nga barazia gjinore;
- Të ndërmarrin veprimet të caktuara dhe të prekshme për të rritur barazinë gjinore në organizatë;
- Të angazhojnë më shumë udhëheqës burra dhe gra brenda organizatës të cilët mbështesin ndryshimin e synuar në lidhje me barazinë gjinore.

Me mbështetjen e (USAID), Shoqata Kombëtare e Komisionerëve të Shërbimeve Rregullatore (NARUC) në vazhdimësi ndihmon autoritetet rregullatore kombëtare (NRA) përmes ndërtimit të kapaciteteve dhe lehtësimit të bashkëpunimit të ngushtë midis rregullatorëve dhe palëve të tjera të interesit në Evropën Juglindore. Qëllimi i përgjithshëm i kësaj ndihme është të mbështesë zhvillimin e tregjeve konkurruese dhe transparente të energjisë dhe integrimin e tyre me pjesën tjetër të

Evropës, me anë të së cilës optimizohen kapacitetet transmetuese të energjisë elektrike dhe interkoneksionet.



Fig. 4.1 Pamje nga takimi i përbashkët i NARUC me Rregullatorët e Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë dhe Greqisë

USAID ka filluar iniciativën e Bashkimit të Tregut të Energjisë Elektrike të Evropës Juglindore (SEE-MC), dhe NARUC, në bashkëpunim me Rregullatorin e Greqisë, po e mbështet SEE-MC duke përmirësuar gatishmërinë e tri vendeve (Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni) për bashkimin e tregjeve të energjisë si dhe avancimin dhe zhvillimin e tregut të brendshëm.

Hap fillestar i kësaj iniciative është organizimi i punëtorive që përqendrohet në zhvillimin e tregut të brendshëm dhe bashkimin e tregjeve të këtyre tri vendeve, ku do të ndahet përvoja greke në krijimin e tregjeve të energjisë si dhe funksionimin e tij (tregu i një dite para dhe tregu brenda ditës), dhe më vonë mundësia e bashkimit të këtij tregu me tregun e Greqisë.

Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet ZRRE-së dhe TETRA TECH/ESA

ZRRE dhe TetraTech kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi lidhur me angazhimin e praktikantëve të cilët dëshirojnë t'i bashkohen sektorit të energjisë. Marrëveshja e bashkëpunimit ka për qëllim tu ofrojë studentëve dhe të diplomuarve një mundësi për të fituar përvojë në një mjedis profesional përmes punës praktike në ZRRE.

Ky Aktivitet i Qëndrueshmërisë së Energjisë (ESA) synon të përmirësojë sigurinë energjetike të vendit duke fuqizuar kapacitetin dhe qëndrueshmërinë e institucioneve vendore për ta çuar përpara zhvillimin e tregut të energjisë. Një nga objektivat kryesore të këtij programi është të mbështetet institucionet vendore dhe kompanitë private të burimeve të rinovueshme të energjisë (BRE) për të fuqizuar dhe ngritur kapacitetin e tyre për të promovuar dhe zbatuar projektet e BRE në Kosovë. Për

këtë qëllim është duke u zhvilluar programi i praktikës “Energjia e re”, i cili promovon integrimin e fuqisë punëtore të të rinjve, nga komunitetet e marginalizuara dhe të tjerët për të kryer punën praktike në institucionet kryesore të vendit dhe kompanitë private energjetike në Kosovë.

ZRRE ka shfaqur gatishmëri bashkëpunimi dhe tashmë ka pranuar një numër praktikantësh nga programi ‘Energjia e Re’ dhe për një periudhë gjashtë mujore ato do të pajisen me njohuri dhe shkathtësi të rregullimit të sektorit të energjisë.

Së pari, ZRRE-ja u siguron praktikantëve hapësirën dhe mjetet e nevojshme të punës. Gjithashtu ZRRE përshtat detyrat e punës që përputhen me fushën e studimit të praktikantëve dhe përvojën e mëparshme, duke bërë përpjekje që të maksimalizojë mësimin eksperimental të tyre.

Praktikantët monitorohen/mbikëqyren nga një punonjës me përvojë, i cili udhëzon praktikantin gjatë angazhimit të tij/saj me ZRRE-në.

Aktivitet e Parnetritetit me Rregullatorin e Austrisë

Me mbështetjen Financiare të Rregullatorit të Austrisë, përfaqësues të Zyrës së Rregullatorit për Energji në qershor të vitit 2022, kanë qëndruar në Austri, ky partneritet i ka mundësuar stafit profesional të ZRRE të përfitoj nga praktikatat më të mira rregullative që kanë rregullatorët evropian.

Aktivitetet e partneritetit me ERRA

Me ftesë të Shoqatës Regjionale të Rregullatorëve të Energjisë (ERRA), Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka prezantuar në Budapest përvojën e ZRRE-së në shqyrtimin e fundit të tarifave të energjisë elektrike.

ZRRE është ftuar të prezantojë shqyrtimin tarifor si praktikë të mirë ndërkombëtare, duke pasur parasysh nevojën për mbulimin e kostos së furnizimit me energji elektrike dhe nevojën për nxitje të eficiencës së energjisë përmes vendosjes së bllok tarifës.

ZRRE ka theksuar shtytësit kryesor të rritjes së kostos së furnizimit, rritjen e nevojës për import të energjisë dhe rritjen e kostos së importit si pasojë e krizës globale të energjisë. ZRRE poashtu ka tërhequr vëmendjen në rritjen e paqëndrueshme të kërkesës për energji elektrike si pasojë e heqjes së bllok-tarifës në vitin 2017.

Shqyrtimi tarifor i ZRRE ka restauruar stabilitetin financiar në sektor, ka përmirësuar likuiditetin dhe qëndrueshmërinë financiare të sektorit dhe ka ulur problemet e furnizimit me energji elektrike

4.5 Pjesëmarrja e Rregullatorit në aktivitetet ndërkombëtare

Pjesëmarrja në aktivitetet ndërkombëtare është konsideruar nga ZRRE-ja si një ndër elementet kryesore që i shërben forcimit institucional, rritjes së njohurive dhe eksperiencës së stafit të saj. Në vijim janë paraqitur aktivitet kryesore dhe pjesëmarrja aktive në organizatat ndërkombëtare, në konferencat ndërkombëtare, tryezat punuese apo takimet multilaterale dhe bilaterale.

4.5.1 Pjesëmarrja në Bordin Rregullativ të Komunitetit të Energjisë (ECRB)

Komuniteti i Energjisë (KE) është organizatë ndërkombëtare e themeluar përmes Traktatit ndërkombëtarë (i ashtuquajtur Traktati i Komunitetit të Energjisë) në tetor 2005 në Athinë, ku marrin pjesë vendet e Bashkimit Evropian dhe regjionit të Evropës juglindore dhe të Detit të Zi. Aktivitetet e

KE gjatë vitit 2018 janë fokusuar drejt përmbushjes së synimeve të përbashkëta: implementimin e “acquis communautaire”, zhvillimin e kornizës rregullative të harmonizuar në nivel regional, si dhe liberalizimin dhe integrimin e tregjeve të sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror.

Palët Kontraktuese të KE janë: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Serbia, Moldavia, Ukraina dhe Gjeorgjia. Në cilësinë e pjesëmarrësve janë shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, ndërsa Norvegjia, Turqia, Armenia dhe kanë statusin e Vëzhguesit.




Fig. 4.2 Shtetet anëtare të Komunitetit për Energji të Evropës Juglindore

Traktati i Komunitetit të Energjisë (TKE) është një komponentë kyçe strategjike e Unionit Evropian (UE) për Evropën Jug-Lindore dhe një mjet efektiv i para-aderimit, që synon të zgjerojë përfitimet nga Tregu rajonal për Energji, para se vendet e rajonit të bëhen anëtarë të UE.

Institucionet kryesore të KE-së janë: Këshilli i Ministrave (KM), Grupi i përhershëm i nivelit të lartë (GPNL), Bordi Rregullativ i Komunitetit të Energjisë (ECRB), Sekretariati i KE i vendosur në Vjenë, dhe katër forumet këshilluese: për energji elektrike, gaz natyror, çështjet sociale dhe naftën.

Bordi Rregullativ i Komunitetit të Energjisë (ECRB – “Energy Community Regulatory Board”) është institucion i themeluar sipas nenit 58 të TKE, që përbëhet nga Autoritet Rregullative të palëve kontraktuese, pjesëmarrësve dhe vëzhguesve. ECRB ka rolin e një trupi koordinues të autoriteteve rregullative për harmonizimin e kornizës rregullative, shkëmbimin e njohurive, dhe zhvillimin e praktikave për zbatimin e Traktatit.

Bazuar në dispozitat e Traktatit të KE, ECRB ka këto përgjegjësi:

- Këshillon Këshillin Ministror si dhe PHLG-së, për çështje statusore, teknike dhe rregullative;
- lëshon rekomandime për palët, në pajtim me dispozitat e Traktatit, për mosmarrëveshje ndër-kufitare, etj;

- merr masa ndaj palëve, nëse autorizohet nga KM;
- ndihmon bashkëpunimin dhe koordinimin midis autoriteteve rregullative;
- jep rekomandime dhe përgatitë raporte, në lidhje me funksionimin e tregjeve të energjisë; dhe
- kërkon përmbushjen e detyrimeve nga palët sipas TKE.

Për përmbushjen e përgjegjësisë, ECRB është e organizuar në grupe punuese të cilat zhvillojnë aktivitetet në fushat përkatëse. ECRB udhëhiqet nga kryetari i zgjedhur për çdo vit nga përfaqësuesit e rregullatorëve nacional, dhe nënkryetari i cili është i deleguar nga Komisioni Evropian.




Fig. 4.3 Struktura e Bordit Rregullativ të Komunitetit të energjisë

4.5.2 Aktivitetet e Rregullatorit në kuadër të ECRB-së

Sipas obligimeve ndaj KE-së, ZRRE-ja ka të emëruar anëtarët e vet në ECRB dhe në çdo grup punues, si dhe merr pjesë aktivisht në punën e Bordit dhe grupeve punuese përkatëse. Për shkak të restriksioneve nga pandemia COVID-19, gjatë vitit 2022, aktivitetet e grupeve punuese kanë qenë të kufizuara, përderisa takimet kanë qenë kryesisht 'online'. Megjithatë, përkundër kufizimeve, ECRB dhe grupet punuese përkatëse kanë ndërmarrë aktivitetet e rregullta sipas programit të punës të ECRB-s.

4.5.2.1 Grupi Punues për Energji Elektrike

Ky Grup punues, gjatë vitit 2022, ka zhvilluar aktivitetet dhe takimet e rregullta 'online' në kuadër të fushëveprimtarisë së vet; për punë më efektive ky grup ka ndërmarrë aktivitetet përmes nëngrupeve ('Task Force'-TF) si në vijim:

- **TF1 – Hapja dhe integrimi i tregut me shumicë të energjisë elektrike** - Me qëllim që të mbështes hapjen efektive të tregut regional të energjisë elektrike në Komunitetin e Energjisë, ky nëngrup është fokusuar në aktivitetet për mbështetjen rregullative, integrimin e tregjeve 'një-ditë-para' dhe 'brenda-ditës' në Evropën Jug-lindore, përfshirë balancimin ndërkufitar.
- **TF2 – Operimi i sistemit** – aktivitetet e këtij nën-grupi janë përqendruar në krijimin e një kornize rregullative – Udhëziesin për operim të sistemit, , kryesisht në vlerësimin e konrizës

ligjore për kontrollin e tensionit dhe menaxhimin e fuqisë reaktive nga Operatorët e Sistemeve.

○ **TF3 – Monitorimi i tregut me shumicë të energjisë elektrike:**

Monitorimi i Tregut si një komponentë kyçe e përgjegjësi rregullative, përfshinë njoftimin e plotë me performancën e tregut dhe perspektivat zhvillimore duke mundësuar promovimin e konkurrencës, mbrojtjen e konsumatorëve, eficiencën e energjisë, investimet dhe sigurinë e furnizimit.

○ **TF4 – Integrimi i energjisë së ripërtëritshme dhe balancimi**– Në kuadër të kësaj task force janë vlerësuar sfidat rregullative të integritit të energjisë së ripërtëritshme në sistemet e energjisë dhe përgjegjësinë e prodhuesve të energjisë nga burimet e ripërtëritshme për balancim të sistemit si dhe fleksibiliteti i sistemeve.

○ **TF5 – Opinionet për Kodet e rrjetit të energjisë elektrike dhe udhëzimeve rregullative** – detyrë kryesore e këtij nëngrupi ka qenë shqyrtimi i koordinuar dhe dhënia e mendimit për kodet e rrjeteve të energjisë elektrike dhe udhëzimeve përkatëse rregullative.

○ **TF6 – Zbatimi i kodeve të rrjetit dhe rregulloreve udhëzuese**– Sipas kësaj detyre, EWG do të shqyrtojë procesin e monitorimit të ACER dhe ENTSO-E dhe do të raportojë mbi aktivitetin e monitorimit, dhe kryesisht fokusohet në monitorimin e zbatimit të Kodeve të Rrjetit- Kodit të Kyçjes.

4.5.2.2 Grupi Punues për Gaz (GPG)

Ky grup punues aktivitetet e veta i përqendron në çështjet e rregullimit të sektorit të gazit natyror, harmonizimin e kornizës rregullative në nivel rajonal dhe çështjet tjera të ndërlidhura me zhvillimin e infrastrukturës së gazit natyror në rajonin e E.JL. Me qëllim të efikasitetit dhe trajtimit të çështjeve specifike aktivitetet janë ndërmarrë përmes këtyre nëngrupeve të veçanta (“Task Force” – TF):

○ **TF1 – Monitorimi i tregut me shumicë të gazit natyror** - Monitorimi i tregut si një komponentë kyçe e përgjegjësi rregullative përfshinë njoftimin e plotë me performancën e tregut dhe perspektivat zhvillimore duke mundësuar promovimin e konkurrencës, mbrojtjen e konsumatorëve, eficiencën e energjisë, investimet dhe sigurinë e furnizimit me gaz natyror.

○ **TF2 – Implementimi i Kodit të rrjetit për Menaxhimin e kongjescionit** - Aktivitetet në kuadër të kësaj taske force janë përqendruar në monitorimin e kongjescionit në pikat interkonektive duke konsideruar tregtimin e kapaciteteve në tregjet dytësore dhe përdorimin e kapacitetit ‘me ndërprerje’, si dhe analizën e kontratave ekzistuese afatgjata.

○ **TF3 – Implementimi i Kodit të rrjetit për Mekanizmin e alokimit të kapaciteteve** – aktivitetet janë përqendruar në përfshirjen e Autoriteteve rregullative nacionale dhe Operatorëve të sistemit të transmissioinit të gazit në përzgjedhjen e platformës së përbashkët të rezervimit të kapaciteteve, me qëllim të implementimit të nenit 37 të Kodit të rrjetit për alokim të kapaciteteve.

○ **TF4 – Mjedis i favorshëm rregullativ për investime** – aktivitetet e këtij nën-grupi janë përqendruar në krijimin e një kornize rregullative stabile, të qëndrueshme dhe të harmonizuar në nivel rajonal, si një parakusht themelor për të tërhequr investimet në infrastrukturën e gazit natyror.

- **TF5 – Opinionet për Kodet e rrjetit të gazit natyror dhe udhëzimeve rregullative** – detyrë kryesore e këtij nëngrupi ka qenë shqyrtimi i koordinuar dhe dhënia e mendimit për kodet e rrjeteve të energjisë elektrike dhe udhëzimeve përkatëse rregullative.

4.5.2.3 Grupi punues për konsumatorë dhe tregjet me pakicë

Në kuadër të ECRB ekziston grupi punues për konsumatorë me nëngrupet e veta, i cili merret me aktivitetet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e konsumatorëve, tarifën dhe çmimet me pakicë, marrëdhëniet kontraktuale mes furnizuesit dhe konsumatorëve, si dhe kualitetin e furnizimit me energji dhe rregullimin e cilësisë së tensionit.

- **TF1 – Monitorimi i tregut me pakicë** - Monitorimi i tregut si një komponentë themelore e përgjegjësi rregullative përfshinë njoftimin e plotë me performancën e tregut dhe perspektivat zhvillimore për të mundësuar krijimin e një kornizë efektive që balancon nevojat e pjesëmarrësve të tregut dhe promovimin e konkurrencës, mbrojtjen e konsumatorëve, eficientë të energjisë, investimet dhe sigurinë e furnizimit.
- **TF2 – Mbrojtja e konsumatorëve** – duke qenë se mbrojtja e konsumatorëve konsiderohet si ndër detyrat kryesore të Autoriteteve rregullative, rrjedhimisht kjo përgjegjësi përcillet edhe në organizatat regjionale / ndërkombëtare si ECRB, CEER dhe MEDREG. Aktivitetet janë fokusuar në bashkëpunimin e këtyre 3 trupave regjional për shkëmbimin e përvojave më të mira dhe efikasë në fushën e mbrojtjes së konsumatorëve.
- **TF3 – Kualiteti i furnizimit** - Arritja e një shkalle të kënaqshme të kualitetit të furnizimit në vazhdimësi mbetet një aktivitet bazë i Autoriteteve rregullative, e po ashtu edhe monitorimi i kualitetit të furnizimit me energji elektrike dhe gaz.
- **TF4 – Komunikimi publik i rregullatorëve** – Detyrë kryesore e këtij nëngrupi ka qenë vlerësimi i procedurave dhe mënyrave të komunikimeve publike nga Autoritetet rregullatore kombëtare si dhe identifikimi i mjeteve efektive dhe inovative të komunikimit publik për të arritur audiencë të re.

4.5.2.4 Grupi punues për REMIT

Në kuadër të këtij grupi kanë funksionuar 4 task forca:

- **TF1 – Udhëzuesi për REMIT**- do të vlerësojë nëse udhëzimet përkatëse të zhvilluara nga ACER mund të përdoren në mënyrë të njëjtë ose nevojiten përshtatje me specifikat e Palëve Kontraktuese ose versionin "REMIT light" të zbatueshëm në Komunitetin e Energjisë. Në rastin e fundit, grupi i punës do të zhvillojë udhëzime të veçanta të ECRB-së.
- **TF2 – Mirëmbajtja e regjistrimit qendror**: do të vlerësojë mundësinë për ta bërë regjistrimin dhe krijimin e regjistrimit qendror, duke përfshirë kërkesat e mundshme të TI-së për mbledhjen e automatizuar të të dhënave të regjistrimit.
- **TF3 – Platforma për informata të brendshme**: Kjo task forcë do të diskutojë dhe vlerësojë nevojën për platformën e centralizuar për publikimin e informacionit të brendshëm.
- **TF4 – Implementimi i REMIT**: Rregullatori do të raportojë për rastet, hetimet e ndërmarra etj. në lidhje me REMIT, duke përfshirë edhe rastet e diskutuara dhe të koordinuara nga ECRB.

- **TF5 – Regjimi i ndëshkimeve:** Roli i task-forcës do të jetë të zgjedhë një nga disa anëtarët e BE-së si pikë referimi, kundrejt të cilit do të vlerësojë regjimet e ndryshme të ndëshkimeve të aplikuara ose që do të zbatohen në Palët Kontraktuese.
- **TF4 – Koordinimi i hetimeve:** Roli i ECRB sipas EnC REMIT është të lehtësojë dhe koordinojë hetimet e Rregullatorëve, në raste të veçanta që kanë një ndikim ndërkufitar. Akti Procedural i ECRB REMIT ofron një kuadër operacional për një koordinim të tillë të lehtësuar nga kjo task forcë.

4.6 Aktivitetet e prokurimit

Rregullatori vazhdon të ndjek procedurat e prokurimit nga Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP), të cilat ndonjëherë, si pasojë e ndryshimit të ligjit për prokurimin publik, janë të stërzgjatura dhe sjellin vështirësi në sigurimin e shërbimeve dhe furnizimeve të cilat janë të domosdoshme për një funksionim normal të zyrës.

5 RAPORTIMI FINANCIAR PËR RREGULLATORIN

Zyra e Rregullatorit për Energji financohet nga të hyrat vetanake, në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, kreu 4, përkatësisht nga taksat që mbliidhen nga operatorët e licencuar në sektorin e energjisë.

5.1 Të hyrat

Të gjitha të hyrat e mbledhura të Zyrës së Rregullatorit për Energji janë depozituar në pajtim me nenin 64 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, në llogarinë zyrtare bankare të krijuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit.

Në vitin 2022, Zyra e Rregullatorit për Energji ka realizuar të hyra në shumë prej 1,174,798.10€. Duke pasur parasysh që shuma totale e buxhetit të shpenzuar nga ZRRE në vitin 2022 është 708,181.09€, të hyrat e pashpenzuara në shume prej 466,617.01€, në pajtim me nenin 23 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, janë derdhur në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Tab. 5.1 Të hyrat

Përshkrimi	Shuma
Të hyrat vetanake 2022	1,174,798.10 €
Shpenzimet 2022	(708,181.09) €
Të hyrat e derdhura në Buxhetin e Republikës së Kosovës	466,617.01 €

5.2 Buxheti

Kuvendi i Republikës së Kosovës me ligjin nr.06/L-066 Ligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, miratoi buxhetin e Zyrës së Rregullatorit për Energji në shumë prej 953,660€, i cili në tërësi është alokuar si grant qeveritar, përkundër faktit që me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, ZRRE financohet nga të hyrat vetanake dhe vetëm në rastet kur këto të hyra janë të pamjaftueshme, atëherë ZRRE mund të shfrytëzoj ndarje buxhetore në formë të grantit qeveritar. Sipas kategorive ekonomike buxheti i ZRRE-së është si në vijim:

Tab. 5.2 Buxheti në fillim të vitit

Përshkrimi	Buxheti
Paga dhe mëditje	475,148.00 €
Mallra dhe shërbime	385,712.00 €
Shpenzime komunale	22,000.00 €
Shpenzime kapitale	70,800.00 €
Gjithsej	953,660.00 €

Me vendim të Qeverisë të datës 09.11.2022 nr. 14/106, buxheti i Zyrës së Rregullatorit për Energji është shkurtuar për 200,000€. Buxheti është shkurtuar në kategorinë ekonomike “mallra dhe shërbime” meqenëse AQP në mungesë të ofertave të përgjegjshme nuk ka arritur të përzgjedhë OE për kryerjen e projektit shërbimet e auditimit / verifikimit të investimeve kapitale të realizuara në Rrjetin e Shpërndarjes. Shprehur në përqindje buxheti i ZRRE-së është shkurtuar për 21 %.

Tab. 5.3 Buxheti final

Përshkrimi	Buxheti
Paga dhe mëditje	475,148.00 €
Mallra dhe shërbime	185,712.00 €
Shpenzime komunale	22,000.00 €
Shpenzime kapitale	70,800.00 €
Gjithsej	753,660.00 €

5.3 Shpenzimet buxhetore

Për financimin e aktiviteteve të zhvilluara në vitin 2022, ZRRE ka shpenzuar 708,181.09€.

Sipas klasifikimit ekonomik, shpenzimet e ZRRE-së janë:

Tab. 5.4 Shpenzimet sipas kategorive ekonomike

Përshkrimi	Shuma
Paga dhe mëditje	439,868.92 €
Mallra dhe shërbime	180,980.88 €
Shpenzime komunale	17,076.45 €
Shpenzime kapitale	70,254.84 €
Gjithsej	708,181.09 €

Realizimi i buxhetit në raport me buxhetin e mbetur pas shkurtimeve është 93.97 %.

Shkalla e realizimit të buxhetit sipas kategorive ekonomike, e shprehur në përqindje, është e paraqitur në tabelën më poshtë.

Tab. 5.5 Realizimi i buxhetit i shprehur në përqindje

Përshkrimi	Buxheti	Shpenzimet	Ndryshimi	Realizimi në %
Paga dhe mëditje	475,148.00 €	439,868.92 €	35,279.08 €	92.58%
Mallra dhe shërbime	185,712.00 €	180,980.88 €	4,731.12 €	97.45%
Shpenzime komunale	22,000.00 €	17,076.45 €	4,923.55 €	77.62%
Shpenzime kapitale	70,800.00 €	70,254.84 €	545.16 €	99.23%
Gjithsej	753,660.00 €	708,181.09 €	45,478.91 €	93.97%




Fig. 5.1 Buxheti dhe shpenzimet për vitin 2022

Në tabelat në vijim pasqyrohen shpenzimet sipas kodeve ekonomike.

Tab. 5.6 Pagat dhe mëditjet

Pagat dhe mëditjet	Shuma
Pagat neto	365,348.86 €
Tatimi në të ardhura personale	32,627.36 €
Kontributi pensional i punëdhënësit	20,946.35 €
Kontributi pensional i të punësuarve	20,946.35 €
Gjithsej	439,868.92 €

Tab. 5.7 Mallrat dhe shërbimet

Mallrat dhe shërbimet	Shuma
Mëditje për udhëtim zyrtar brenda vendit	32.00 €
Akomodimi për udhëtime zyrtare brenda vendit	1,623.00 €
Shpenzimet e udhëtimit zyrtar jasht vendit	2,984.88 €
Mëditje për udhëtim zyrtar jasht vendit	8,392.65 €
Akomodimi për udhëtime zyrtare jasht vendit	3,943.88 €
Shpenzime tjera për udhëtime zyrtare jasht vendit	1,235.61 €
Shpenzime për Internet	3,734.93 €
Shpenzimet e telefonisë mobile	5,097.07 €
Shpenzimet postare	286.80 €
Shërbimet arsimi dhe trajnimi	- €
Shërbime të ndryshme intelektuale dhe këshillëdhënëse	4,079.95 €
Shërbime shtypjeje	26.00 €
Shërbime kontraktuese tjera	455.00 €
Shpenzimet për anetaresim	6,560.00 €
Mobilje	4,212.00 €
Kompjuter	- €
Hardver për TI	- €
Pajisje tjera	- €
Furnizime për zyrë	4,177.82 €
Furnizim me pije	3,160.88 €
Akomodimi	- €
Derivate për gjenerator	464.48 €
Karburant për vetura	5,445.94 €
Regjistrimi i automjeteve	315.00 €
Sigurimi i automjeteve	833.83 €
Taksë komunale e rëxhistrit të automjeteve	30.00 €
Sigurimi i ndërtesave	11,895.40 €
Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve	2,163.00 €
Mirëmbajtja e ndërtesave	3,928.20 €
Mirëmbajtja e teknologjisë informative	994.90 €
Mirëmbajtja e mobileve dhe pajisjeve	- €
Qiraja për ndërtesa	89,742.12 €
Qiraja për pajisje	1,465.60 €
Qiraja për makineri	5,477.56 €
Reklamat dhe konkurset	- €
Drekat zyrtare	812.50 €
Pagesa e tatimit në qira	7,409.88 €
Gjithsej	180,980.88 €

Siç shihet nga tabela 5.7, shuma e mjeteve të shpenzuara për këtë kategori të shpenzimeve është 180,980.88€.

Shpenzimet buxhetore në baze të aktiviteteve janë si vijon:

Tab. 5.8 Shpenzimet sipas aktiviteteve

Shpenzimet sipas aktiviteteve	Shuma
Shpenzimet e udhëtimit	18,212.02 €
Shërbimet e telekomunikimit	9,118.80 €
Shpenzimet për shërbimet	11,120.95 €
Blerja e mobileve dhe pajisjeve	4,212.00 €
Blerje tjera mallra dhe shërbime	7,338.70 €
Derivate dhe lende djegëse	5,910.42 €
Shërbimet e regjistrimit dhe sigurimeve	13,074.23 €
Mirëmbajtja	7,086.10 €
Qiraja	104,095.16 €
Shpenzimet e marketingut	- €
Shpenzimet e përfaqësimi	812.50 €
Gjithsej	180,980.88 €

Tab. 5.9 Shpenzimet komunale

Shpenzimet komunale	Shuma
Rryma	16,510.47 €
Uji	257.05 €
Shpenzimet e telefonit	308.93 €
Gjithsej	17,076.45 €

Tab. 5.10 Shpenzimet kapitale

Shpenzimet kapitale	Shuma
Pajisje të teknologjisë informative	70,254.84 €
Gjithsej	70,254.84 €

6 SEKTORI I ENERGJISË ELEKTRIKE

6.1 Karakteristikat e sektorit të energjisë elektrike

Sistemi energjetik në Republikën e Kosovës, i përbërë nga gjenerimi i energjisë elektrike, transmetimi i energjisë elektrike, shpërndarja e energjisë elektrike dhe furnizuesit si dhe tregtarët me shumicë, është i dizajnuar kryesisht për të prodhuar energji elektrike bazë, e cila bazohet në linjit si lëndë e parë, por jo edhe për mbulimin e ngarkesave maksimale dhe balancimin e sistemit i cili mbetet sfida e madhe për të gjithë pjesëmarrësit në sektor.

Gjatë vitit 2022 në Kosovë nuk ka kapacitete të reja gjeneruese, andaj kapacitetet të instaluar prodhuese janë prej 1,568 MW, përfshirë edhe kapacitetet gjeneruese nga BRE, ku kapaciteti operativ konsiderohet rreth 1,236 MW, prej të cilave termocentralet (TC) me linjit përbëjnë rreth 77.69 %, ndërsa pjesa tjetër përbëhet nga HC Ujmani, BRE në transmetim dhe BRE tjera (hidrocentralet, panelet solare dhe centralet me erë) me 22.31 %.

Pjesa më e madhe e konsumit është mbuluar nga prodhimi vendor, por për shkak të vjetërsisë së termocentraleve dhe jofleksibilitetit të mjaftueshëm për t'iu përshtatur kërkesës në periudha të ndryshme e sidomos në kohën e pikut, atëherë është ngritur nevoja për importe por ndonjëherë edhe eksporte për balancimin e sistemit.

Figura më poshtë paraqet prodhimin, importin, eksportin dhe kërkesën e energjisë elektrike gjatë dhjetë viteve të fundit.




Fig. 6.1 Prodhimi, importi dhe kërkesa e energjisë 2011 - 2022

6.1.1 Tregu i energjisë elektrike

Tregu i energjisë elektrike në Kosovë në vazhdimësi është duke u zhvilluar dhe është i ndërlidhur në mënyrë të pandashme me tregun rajonal dhe më gjerë.

Kosova dhe Shqipëria kanë vazhduar me aktivitetet lidhur me krijimin e bursës së përbashkët për tregun një-ditë-para (day ahead) dhe atij brenda-ditës (intraday), e poashtu edhe në bashkimin e tregjeve të energjisë elektrike. Grupet punuese dhe përfaqësuesit e të dy vendeve, kanë mbajtur takime të përbashkëta në lidhje me planin e veprimit për kryerjen e këtyre aktiviteteve për përgatitjen e dokumenteve të nevojshme për funksionalizimin e Bursës Shqipëtare dhe bashkimit të tregut ndërmjet dy vendeve.

Në Kosovë ende nuk ka treg të organizuar një-ditë-para apo brenda-ditës, andaj tregtimi i energjisë elektrike me shumicë kryhet kryesisht përmes kontratave bilaterale mes prodhuesve dhe furnizuesve (tregtarëve). Një pjesë e energjisë elektrike për të plotësuar kërkesën vendore për nevojat e konsumatorëve me të drejtën e furnizimit si shërbim universal (FSHU), për mbulimin e humbjeve të sistemit, si dhe për konsumatorët me çmime të derregulluara, importohet (blihet) përmes kontratave bilaterale në treg të lirë dhe/ose në tregjet rajonale të organizuara një-ditë-para apo brenda-ditës (përmes tregtarëve).

HC Ujmani, edhe në vitin 2022 ka vazhduar të tregtoj tërë energjinë në treg të lirë duke respektuar parimet e Procedurës për tregtim të Energjisë Elektrike.

Energjia elektrike e prodhuar nga KEK sipas Marrëveshjes për Furnizim me Shumicë⁵ (MFSH) ofrohet për Furnizuesin që furnizon konsumatorët me të drejtë të Shërbimit Universal dhe për mbulimin e humbjeve të sistemit, si dhe tepricat tregtohen në tregun me shumicë në pajtim me “Procedurën për Tregtimin e Energjisë elektrike⁶”.

Duke pasur parasysh vjetërsinë e termocentraleve, mungesën e gjeneratorëve rregullues, sistemi energjetik i Kosovës nuk ka fleksibilitet për t’iu përshtatur kërkesës, sidomos kërkesës së lartë në kohën e pikut, prandaj lind nevoja për importe gjegjësisht eksporte të energjisë elektrike. Nga gjithsej kërkesa për energji elektrike në nivel të vendit 6,547 GWh (përfshirë edhe humbjet në transmetim dhe shpërndarje), pjesa më e madhe mbulohet nga prodhimi (gjeneratorët) vendor, kurse pjesa tjetër mbulohet nga importet e energjisë elektrike.

Tabela më poshtë paraqet balancimin e sistemit, prej nga shihet se vendi ynë gjatë vitit 2022 ka qenë neto importues.

⁵ [https://mzhe-ks.net/repository/docs/MARREVESHJE PER FURNIZIM ME SHUMICE - tetor2012_KKDFE.pdf](https://mzhe-ks.net/repository/docs/MARREVESHJE_PER_FURNIZIM_ME_SHUMICE_-_tetor2012_KKDFE.pdf)

⁶ [http://ero-ks.org/2019/Treau/Procedura per Tregtimin e Energjise Elektrike.pdf](http://ero-ks.org/2019/Treau/Procedura_per_Tregtimin_e_Energjise_Elektrike.pdf)

Tab. 6.1 Balancimi i sistemit elektroenergjetik 2022

	Balancimi i sistemit elektroenergjetik 2022	GWh	%
1	Prodhimi nga gjeneratorët në transmetim	6,147	94%
2	Prodhimi nga gjeneratorët në shpërndarje	168	3%
3	Importi	761	12%
4	Gjithsej energjia në disponim	7,076	108%
5	Eksporti	787	12%
6	Net import/eksport	26	0%
7	Devijimet e sistemit (marrje nga sistemi)	-186	-3%
8	Transiti	2,475	38%
9	Kërkesa nacionale	6,547	
10	Humbjet në transmetim	118	2%
11	Konsumi i konsumatorëve në rrjetin e transmetimit	132	2%
12	Konsumi LLOMAG	101	2%
13	Ngarkimi në rrjetin e shpërndarjes	6,196	
14	Humbjet në shpërndarje	1,403	23%
15	Neto konsumi në shpërndarje	4,794	77%

Në krahasim me vitin 2021, prodhimi nga gjeneratorët që dërgojnë energjinë elektrike në transmetim ka pasur ngritje për 1.7%. Importi në vitin 2022 është ulur për 41.9% krahasuar me vitin paraprak, e poashtu edhe eksporti ka pësuar rënie për 5.72%. Kërkesa nacionale në vitin 2022 ka qenë 6,547GWh. Vlen të theksohet se devijimet në vitin 2022 kanë qenë 40.9% më të larta se vitin paraprak, kryesisht për shkak të devijimeve për mbulimin e konsumit në katër komunat veriore të vendit.

KOSTT vazhdon të operoj si zonë Rregulluese brenda Bllokut Rregullues Kosovë- Shqipëri, ku balancimi i sistemit është përgjegjësi e plotë e KOSTT, që nënkupton edhe mbulimin e të gjitha devijimeve të sistemit përgjegjësinë në lidhje me operimin e sigurt të sistemit interkonektiv, si dhe alokimin e kapaciteteve ndërkufitare dhe menaxhimin e kongjestionëve që nënkupton mbledhjen e të hyrave nga tregtimet ndërkufitare, përveç alokimit të kapaciteteve ndërkufitare me Serbinë.

Në figurën më poshtë është paraqitur rrjedha e energjisë elektrike nga gjenerimi, transmetimi deri te shpërndarja te konsumatorët, si dhe rrjedhat e energjisë elektrike drejt rrjeteve rajonale dhe nga rrjetet rajonale përfshirë transitin.




Fig. 6.2 Rrjedhat e energjisë elektrike në sistem në vitin 2022

6.1.2 Adekuacia e gjenerimit dhe siguria e furnizimit

Gjenerimi vendor nuk është i mjaftueshëm për të mbuluar ngarkesën maksimale në sistemin elektroenergjetik të Kosovës. Kjo mungesë e energjisë për të plotësuar kërkesën nacionale mbulohet me importe të energjisë elektrike.

Kapaciteti i përgjithshëm operativ i gjeneratorëve në Kosovë është 1,236 MW, derisa ngarkesa maksimale gjatë këtij viti ka qenë 1,429 MW, andaj raporti i adekuacisë së gjenerimit ndaj ngarkesës maksimale është 86.5 %.

Në tabelën më poshtë janë paraqitur në baza mujor ngarkesat maksimale dhe minimale gjatë vitit 2022.

Tab. 6.2 Ngarkesat maksimale dhe minimale në vitin 2022

Ngarkesa 2022	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
	MWh/h	MWh/h	MWh/h	MWh/h	MWh/h	MWh/h	MWh/h	MWh/h	MWh/h	MWh/h	MWh/h	MWh/h
Maksimale	1,429	1,291	1,311	1,077	857	721	768	764	699	879	1,135	1,372
Minimale	715	562	486	369	294	306	337	332	324	350	413	782

Derisa sistemi i gjenerimit ka mungesa lidhur me adekuacinë, sistemi i transmetimit përmban rezerva të mjaftueshme për të mundësuar rrjedha të energjisë elektrike për plotësimin e kërkesës vendore, përshirë edhe mbulimin e ngarkesës maksimale (pikut), si dhe për të mundësuar transit nëpër linjat interkonektive.

Tabela më poshtë tregon ngarkesat maksimale dhe minimale (P_{max} dhe P_{min}) të sistemit elektroenergetik të Kosovës ndër vite, kohën e ndodhjes së tyre, prodhimin, si dhe importin dhe eksportin përkatës të energjisë elektrike.

Tab. 6.3 Ngarkesat maksimale dhe minimale të sistemit elektroenergetik

Viti	Ngarkesa maksimale							Ngarkesa minimale						
	Pmax			Prodhimi	Importi	Eksporti	Devijimi*	Pmin			Prodhimi	Importi	Eksporti	Devijimi*
	[MW]	Data	Ora	[MW]	[MW]	[MW]	[MW]	[MW]	Data	Ora	[MW]	[MW]	[MW]	[MW]
2015	1,129	31.12	20:00	825	308	0	-4	272	30.08	04:00	250	0	50	-72
2016	1,160	31.12	18:00	797	321	0	42	246	12.06	06:00	711	0	310	155
2017	1,161	11.01	20:00	660	415	0	86	286	3.06	06:00	733	50	440	57
2018	1,203	31.12	18:00	787	271	0	145	265	27.06	06:00	577	5	430	-113
2019	1,253	31.12	18:00	861	348	16	60	289	7.06	06:00	435	15	140	21
2020	1,251	21.12	11:00	819	350	32	114	288	9.08	04:00	548	12	280	-8
2021	1,398	21.12	23:00	819	360	147	366	310	5.08	20:00	416	600	374	332
2022	1,429	24.01	23:00	946	629	267	121	294	9.08	04:00	561	401	654	14

* Devijimi i sistemit ndaj sistemit interkonektiv

Siç është cekur më herët, energjia e nevojshme për mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit dhe shpërndarjes fillimisht sigurohen në mënyrë proporcionale nga energjia e mbetur nga KEK pas alokimit të energjisë për shërbimin universal, kurse pjesa tjetër e energjisë për mbulimin e humbjeve sigurohet nga importi, në një treg.

6.2 Burimet primare të energjisë

Viteve të fundit ka një ngritje të kapaciteteve prodhuese nga BRE si: energjia e ujit, energjia e erës, energjia diellore, por në Kosovë ende vazhdon të dominoj energjia e prodhuar nga linjiti si burim primar i energjisë, që në një rën anë mundëson një siguri të prodhimit të energjisë elektrike afatgjate, mirëpo mbetet si problem ndikimi në mjedis për shkak të emetimit të gazrave serrë dhe ndotësve tjerë.

6.2.1 Prodhimi dhe konsumi i linjitit

Prodhimi i linjitit në vitin 2022 ka qenë 8.28 mil. ton, ndërsa konsumi 8.40 mil. ton, sasi këto që janë pothuajse të njëjta në krahasim me vitin 2021.

Prodhimi dhe konsumi i linjitit sipas muajve, për vitin 2022 është paraqitur në tabelën 6.4.

Tab. 6.4 Prodhimi dhe konsumi i linjitit në vitin 2022

Prodhimi/konsumi i linjitit	Totali	Jan	Shku	Mars	Prill	Maj	Qer	Korr	Gush	Shta	Tet	Nën	Dhje
Prodhimi i linjitit (t*1000)	8,279	783	781	637	649	694	592	638	573	844	755	602	731
Konsumi i linjitit (t*1000)	8,404	746	719	891	720	699	724	612	617	593	599	698	785
Konsumi i linjitit në treg (t*1000)	153	17	28	31	28	23	25	0	0	0	0	0	0

Në figurën e mëposhtme mund të shihet prodhimi dhe konsumi i linjit gjatë viteve 2011 – 2022.




Fig. 6.3 Prodhimi dhe konsumi i linjitit në vitet 2011 – 2022

6.3 Prodhimi i energjisë elektrike

6.3.1 Kapacitetet prodhuese të energjisë elektrike

Kapaciteti total operativ i gjenerimit të energjisë elektrike në Kosovë është 1,236 MW, prej të cilit 960 MW apo 77.7% janë nga termocentralet dhe pjesa tjetër janë hidrocentrale dhe burimet të ripërtitshme të energjisë (hidrocentrale, centrale me erë dhe panele fotovoltaike).

Kapaciteti i njësive gjeneruese është paraqitur në tabelën e mëposhtme sipas llojit të burimit primar, kapacitetit instalues dhe operativ, kufijtë minimal dhe maksimal të prodhimit si dhe vitit të futjes në operim.

Tab. 6.5 Kapacitetet gjeneruese në sistemin elektroenergetik të Kosovës

Njësitë prodhuese	Kapaciteti i njësive (MW)			Futja në operim
	Instaluar	Neto	Min/max	
TC Kosova A1	65	Nuk operon		1962
TC Kosova A2	125	Nuk operon		1964
TC Kosova A3	200	144	100-130	1970
TC Kosova A4	200	144	100-130	1974
TC Kosova A5	210	144	100-135	1975
TC Kosova A	610	432		
TC Kosova B1	339	264	180-260	1983
TC Kosova B2	339	264	180-260	1984
TC Kosova B	678	528		
HC Ujmani	35.00	32.00		1981
HC Lumbardhi I	8.08	8.00		(1957) 2006
HC Dikanci	4.02	3.34		(1957) 2013
HC Radavci	1.00	0.90		(1934) 2010
HC Burimi	0.95	0.85		(1948) 2011
Lumbardhi II	6.20	6.20		2020
Gjithsej HC (jasht skemës mbështetëse)	55.25	51.29		
EGU Belaja	8.06	8.06		2016
EGU Deçani	9.81	9.81		2016
HC Hidroline-Albaniku III	4.27	4.27		2016
HC Brod II	4.80	4.80		2015
HC Restelica 1&2	2.28	2.28		2016
HC Brodi III	4.70	4.70		2016
HC Brezovica	2.10	2.10		2017
HC Orqusha	4.00	4.00		2021
HC Lepenci 3	10.00	10.00		2019
HC Dilli com	0.31	0.31		2020
HC Hidroline-Albaniku II	3.55	3.55		2020
HC ECO Energji	1.00	1.00		2020
HC Hidroline-Albaniku IV	1.12	1.12		2021
HC Restelica 3	2.35	2.35		2021
HC Brod I	2.48	2.48		2021
HC Sharri	6.45	6.45		2021
HC Vica	4.60	4.60		2021
HC Shterpca	5.30	5.30		2021
Wind Power	1.35	1.35		2010
Air Energy-Kitka	32.40	32.40		2018
SOWI Kosova	103.41	103.41		2021
PV LedLight Technology	0.10	0.10		2015
PV ONIX SPA	0.50	0.50		2016
PV Birra Peja	3.00	3.00		2018
PV Frigo Food Kosova	3.00	3.00		2018
PV Eling	0.40	0.40		2019
PV SGE	3.00	3.00		2019
Gjithsej BRE (në skemën mbështetëse)	224.34	224.34		
Gjithsej	1,567.59	1,235.63		

6.3.2 Prodhimi i energjisë elektrike

Prodhimi i gjithmbarshëm i energjisë elektrike në vitin 2022 ka qenë 6,315 GWh, ndërsa në vitin 2021 ka qenë 6,207 GWh, që do të thotë se ka një rritje prej 1.7 %. Ndërsa, krahasuar me bilancin e energjisë elektrike për vitin 2022 prodhimi është realizuar rreth 95.7 %.

Tabela më poshtë paraqet prodhimin nacional si dhe shpenzimet vetanake sipas njësive dhe muajve gjatë vitit 2022.

Tab. 6.6 Prodhimi i energjisë elektrike në vitin 2022

Prodhuesit GWh	Gjithsej	Jan	Shku	Mar	Pri	Maj	Qer	Korr	Gush	Shta	Tet	Nën	Dhje
TC A3 bruto	831.5	90.7	8.1	106.3	103.1	73.8	38.2	39.9	93.1	75.8	18.3	100.7	83.3
TC A4 bruto	983.4	90.5	98.4	101.3	81.4	52.2	35.1	94.5	107.0	28.2	89.5	101.6	103.5
TC A5 bruto	480.6	80.2	87.7	65.5	0.0	85.8	99.3	62.2	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
TC A Shpenz vet	275.1	31.6	23.2	31.6	21.7	26.2	22.1	23.7	22.7	13.5	13.8	23.3	21.8
TC A prag	2,020.3	229.8	171.0	241.6	162.9	185.7	150.5	172.9	177.4	90.5	94.1	179.0	165.1
TC B1 bruto	2,148.1	205.3	176.2	197.4	189.2	139.6	187.1	68.2	203.8	200.3	191.9	180.5	208.6
TC B2 bruto	1,902.8	58.8	177.7	196.0	190.2	174.5	197.3	203.9	43.3	155.7	166.9	148.5	190.1
TC B Shpenz vet	393.4	26.5	33.5	37.8	36.4	31.1	37.1	27.0	23.9	34.9	35.2	31.8	38.0
TC B prag	3,657.5	237.5	320.3	355.7	343.0	283.0	347.3	245.0	223.2	321.1	323.6	297.2	360.6
Ujmani	77.8	3.5	3.5	4.1	9.2	11.6	5.3	5.5	4.4	3.5	4.7	6.9	15.6
Lumbardhi	28.6	0.9	0.6	0.8	4.0	5.3	3.1	0.0	0.0	0.0	0.0	2.7	11.4
Kitka	87.8	9.2	8.5	7.7	9.1	4.2	5.4	6.6	5.9	7.1	6.5	7.3	10.4
Sowi	275.1	29.0	29.9	26.3	25.5	14.6	16.2	16.4	14.6	27.5	17.6	30.8	26.7
HC Distr.	167.8	7.3	8.6	9.6	29.0	30.9	17.9	11.5	5.6	6.7	6.2	12.2	22.3
Gjithsej	6,315.1	517.2	542.4	645.7	582.7	535.3	545.7	457.9	431.0	456.4	452.7	536.1	612.1
Bilanci 2022	6,598.0	543.5	588.5	716.3	566.7	591.6	596.7	428.0	400.2	397.7	559.4	594.2	615.3
Raporti tot./bil	95.7%	95.2%	92.2%	90.1%	102.8%	90.5%	91.5%	107.0%	107.7%	114.8%	80.9%	90.2%	99.5%

Prodhimi bruto i termocentraleve në vitin 2022 ka qenë 6,346 MWh, prej të cilit 668 MWh apo 10.5% është konsumuar nga vet termocentralet si shpenzim vetanak. Një pjesë e këtyre shpenzimeve vetanake (për të dy gjeneratorët TC Kosova A dhe TC Kosova B) realizohet drejtpërsëdrejti nga impiantet e brendshme, ndërsa pjesa tjetër futet në sistemin e transmetimit dhe pastaj konsumohet nga termocentralet.

Figura e mëposhtme paraqet pjesëmarrjen e gjeneratorëve në prodhimin e përgjithshëm të energjisë elektrike në vitin 2022.




Fig. 6.4 Prodhimi i njësive gjeneruese në vitin 2022

Prodhimi i BRE-ve të kyçura në rrjetin e transmetimit në vitin 2022 ka qenë 469.4 GWh dhe është më i lartë për 57.8 % krahasuar me vitin 2021, për shkak të operimit me kapacitet te plotë prej 103.41 MW të centralit me erë Sowi. Ndërsa prodhimi i BRE-ve të kyçura në rrjetin e shpërndarjes ka qenë 167.8, dhe është për 20.2 % më i lartë krahasuar me vitin 2021.

Tabelat e mëposhtme paraqesin prodhimin e energjisë elektrike nga BRE-të të kyçura në rrjetin e transmetimit, përkatësisht në rrjetin e shpërndarjes.

Tab. 6.7 Prodhimi i BRE-ve të kyçura në rrjetin e transmetimit në vitin 2022

BRE në transmetim	Kapaciteti instalues MW	Prodhimi MWh	Pjesëmarrja në prodhim* %
HC Ujmani	35.00	77,828	16.58
HC Kaskada Lumbardh	32.15	28,615	6.10
Air Energy/Kitka	32.40	87,822	18.71
PEE Selaci	103.41	275,121	58.61
Gjithsej BRE	202.96	469,387	100%

* Pjesëmarrja e njësive gjeneruese ndaj prodhimit të BRE në transmetim

Tab. 6.8 Prodhimi i BRE-ve të kyçura në rrjetin e shpërndarjes në vitin 2022

BRE në distribucion	Kapaciteti instalues	Prodhimi	*Pjesëmarrja në prodhim
	MW	MWh	%
Hydroline	4.58	17,258	10.28
Dikanci	4.02	9,607	5.73
Radavci	1.00	3,207	1.91
Burimi	0.95	1,241	0.74
Eurokos-JH	4.80	42,167	25.13
HC Brezovica	2.10	4,663	2.78
HC Orqusha	4.00	15,102	9.00
HC Lepenci 3	9.99	29,226	17.42
HC Eko Energji	1.00	1,220	0.73
HC Dilli com	0.31	1,425	0.85
Me ere	1.35	144	0.09
Solar-C	0.10	118	0.07
Solar-Feti	0.10	0	0.00
Solar Onix	0.50	638	0.38
Solar Birra Peja	3.00	4,184	2.49
Solar Frigo Food	3.00	4,187	2.50
Centrali solar"Eling"	0.40	646	0.39
Centrali Solar Green Energy	3.00	4,020	2.40
HC Sharri	6.45	10,279	6.13
HC Vica	4.60	10,233	6.10
HC Shterpca	5.30	8,234	4.91
NG. Gjakova		1	0.00
Gjithsej BRE	60.55	167,798	100%

* Pjesëmarrja e njësive gjeneruese ndaj prodhimit të BRE në distribucion

Operimi i njësive gjeneruese

Krahasuar me vitin e kaluar numri i rënieve nga operimi i njësive gjeneruese me linjit ka qenë pothuajse e njëjtë. Në tabelën e mëposhtme janë të paraqitura të gjitha llojet dhe shpeshtësia e ndaljeve dhe disponueshmëria në orë pune e termocentraleve për vitin 2022, ku vërehet se disponueshmëria e njësive gjeneruese të TC Kosova A3 dhe TC Kosova A5 ka qenë e mirë.

Tab. 6.9 Ndalesat e njësive gjeneruese 2022

2022	TC Kosova A			TC Kosova B	
	A3	A4	A5	B1	B2
Ndalesat e planifikuara	5	4	5	3	3
Ndalesat e paplanifikuara	4	2	1	7	5
Rëniat	2	2	0	9	4
Gjithsej ndalesa	11	8	6	19	12
Orë pune	5,956	6,961	3,602	7,778	7,277

Orët e operimit të njësive gjeneruese të TC Kosova A dhe TC Kosova B në formë grafike janë paraqitur në figurën e mëposhtme, me variacione sipas njësive, ku vërehet se njësia B1 dhe B2 kanë operuar rreth 86 % të orëve të vitit, përderisa në vitin 2021 kanë operuar 84% në vit.




Fig. 6.5 Operimi i njësive gjeneruese në vitin 2022

Figura e mëposhtme paraqet prodhimin e njësive gjeneruese për periudhën 2011 – 2022.




Fig. 6.6 Prodhimi i energjisë elektrike për vitet 2011 – 2022

6.4 Sistemi i transmetimit

Transmetimi si aktivitet i rregulluar i energjisë është përgjegjës për funksionimin, menaxhimin, mirëmbajtjen, zhvillimin dhe ndërtimin e rrjetit të transmetimit dhe linjave të transmetimit dhe

balancimin e sistemit, si dhe për të siguruar aftësinë afatgjatë të rrjetit për të përmbushur kërkesat që nevojiten për transmetimin e energjisë elektrike.

Rrjeti i transmetimit të sistemit elektroenergjetik të Kosovës është mjaft i zhvilluar dhe ofron siguri të mjaftueshme të sistemit dhe është i ndërlidhur mirë me sistemin rajonal dhe Evropian përmes linjave interkonektive me:

- Shqipërinë, Maqedoninë Veriore, Malin e Zi dhe Serbinë – me linja 400 kV;
- Shqipërinë dhe Serbinë – me linja 220 kV; dhe
- Serbinë - me dy linja 110 kV.

Rrjeti i transmetimit të sistemit elektroenergjetik të Kosovës plotëson nevojat vendore të transmetimit si dhe kriterin N-1 për të gjithë nivelit e tensionit të lartë.

Në tabelat e mëposhtme janë paraqitur kapacitetet transformuese dhe linjat e rrjetit të transmetimit, sipas nivelit të tensionit:

Tab. 6.10 Nënstacionet në rrjetin e transmetimit

Transformimi (kV/kV)	Pronari	Nr. i NS	Nr. i TR	Fuqia (MVA)
400/220	KOSTT	1	3	1200
400/110	KOSTT	2	4	1200
220/110	KOSTT	3	9	1350
220/35	Feronikel	1	2	320
220/35/10(20) (Besiana)	KOSTT	1	1	40
220/10(20) (Besiana)	KOSTT	-	1	40
220/10(20)	KOSTT	1	2	80
110/35/10(20)	KOSTT	6	7	277.5
110/35/6.3	Trepça	1	2	126
110/6.3	Trepça	-	1	31.5
110/35	Ujmani	1	1	20
110/6.3	Sharri	1	2	40
110/10(20)	KOSTT	14	26	949.5
110/35	KOSTT	7	19	641
110/10	KOSTT	2	8	252
35/110 (Deçan)	Kelkos	-	1	40
Gjithsej		41	89	6,608

Tab. 6.11 Linjat në rrjetin e transmetimit

Tensioni (kV)	Pronari	Gjatësia (km)
400	KOSTT	279.5
220	KOSTT	238.5
110	KOSTT	912.1
Gjithsej		1,430.1

Skema më poshtë paraqet informata bazë mbi numrin e nënstacioneve (NS), transformatorëve (TR) dhe fuqinë instaluese transformuese, gjatësinë e linjave, si dhe centralet e kyçura në nivelin përkatës të tensionit.




Fig. 6.7 Të dhënat bazë të rrjetit të transmetimit

6.4.1 Rrjedhat e energjisë elektrike në rrjetin e transmetimit

Sistemi i transmetimit në Kosovë është i ndërlidhur mirë me sistemin rajonal dhe Evropian përmes linjave interkonektive me vendet fqinje dhe ka kapacitete të mjaftueshme për të përballuar rrjedhat e energjisë në sistem, për të mbuluar kërkesën e konsumatorëve nga prodhimi vendor dhe importi por edhe për eksportet eventuale të tepricave të energjisë elektrike, e po ashtu edhe për energjinë e cila kalon si transit nga vendet tjera.

Duhet theksuar se transiti i energjisë elektrike ngarkon rrjetin duke shtuar humbjet, amortizimin e rrjetit, si dhe nevojën për mirëmbajtje të rrjetit të transmetimit, për të cilat operatori kompensohet përmes Mekanizmit ITC. Transiti i energjisë elektrike rrjetin e Kosovës në vitin 2022 ka qenë 2,475 GWh apo rreth 26.1 % krahasuar me kërkesën.

Figura e mëposhtme paraqet rrjedhat e energjisë nëpër të gjitha linjat ndërlidhëse (interkonektive) në të dyja drejtimet (hyrje, dalje).




Fig. 6.8 Rrjedhat e energjisë nëpër linjat ndërlidhëse (interkonektive)

6.4.2 Investimet në sistemin e transmetimit

Gjatë vitit 2022 në rrjetin e transmetimit janë bërë investime, ku projektet investive janë paraqitur në kategoritë si më poshtë:

Projektet që kanë përfunduar në vitin 2022 janë nën afat garantues njëvjeçar

Gjatë vitit 2022, projekti ka përfunduar teknikiisht dhe financiarisht që nënkupton se është me afat garantues njëvjeçar dhe asetet kanë kaluar në Sistemin e Transmetimit:

- Linja 110 kV e dyfishtë dhe ajo kabllorike, NS Fushë Kosova;

Projektet të financuara nga KOSTT, të cilat kanë filluar në vitin 2021 dhe 2022 dhe janë në fazën e implementimit

Projekti në Kastriot (2021) që përfshinë:

- Ndërtimi i NS. 110/35/10(20) kV Kastrioti me transformator 40MVA, dhe
- Ndërtimi i linjës/kabllos 110kV për kyçje të nënstacionit të ri 110/35/10(20) kV Kastrioti,

Projekti në Fushë Kosovë (2022) që përfshinë:

- Ndërtimi i NS. 110/35/10(20) kV Fushë Kosova.

Disa prej projekteve të parapara për të filluar implementimin në vitin 2022, por duhet të ritenderohen por sipas preferimeve të Auditit gjeneral dhe konform Ligjit për ndërtim dhe Ligjit për prokurim:

- Projekti (ID/011):NS Malishevë AIS 220/35/10(20)kV; dhe
- Furnizimi dhe instalimi i Transformatorëve të fuqisë për NS Malisheva dhe NS Fushë Kosova;

Projektet e fazës së VI dhe VII – Financim nga Banka Gjermane për Zhvillim KfW të realizimit të projekteve.

Sipas Planit Investues ky grup i projekteve është planifikuar të financohet bashkëfinansim KfW /KOSTT. Huamarrja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës, KfW (Kreditanstalt für Wiederaufbau) dhe KOSTT në kuadër të bashkëpunimit ndërshtetëror ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës Federale të Gjermanisë. Projektet e planifikuara janë si më poshtë:

- a. Shërbimet konsulente për përgatitjen e tender dosjes dhe mbikëqyrje të realizimit të projekteve;
- b. LOT 1 - NS 110/10(20) kV Dragashi me transformatorë 2x40MVA dhe linja transmetuese;
- c. LOT 2 - Rehabilitimi i NS dhe furnizimi me transformatorë të fuqisë 40MVA;
- d. LOT 3: Dizajni, furnizimi dhe instalimi i transformatorëve të fuqisë;
- e. LOT 4: Linjat transmetuese.

Gjatë vitit 2022 është aplikuar për fondin IPA 2023 (Instrument for Pre-Accession Assistance) në EU për donacion për projektin:

- Ri-vitalizimi dhe përforcimi i segmentit të linjës 110 kV NS Kosova A - NS Bardhi - NS Ilirida - NS Vallaq

Gjithashtu, gjatë vitit 2022 ka vazhduar implementimi i projekteve të nënshkruara për projektet:

- Adaptimi i harduerit dhe softuerit të SCADA-s në NS Rahoveci 110/35/10kV dhe NS Palaj110/35/10kV;
- Adaptimi i Harduerit dhe Softuerit për SCS në NS Gjakova 2;
- Furnizimi me instrumente dhe vegla pune për mirëmbajtje të pajisjeve telekomunikuese;
- Furnizimi me kablllo optike ADSS;
- Furnizimi me klima ne Nenstacionet e KOSTT;
- Furnizim me Harduer.

Për dy projektet e para kontratat janë nënshkruar në fund të vitit 2021.

6.4.3 Ngarkesat maksimale dhe kërkesa për energji në sistemin elektroenergetik

Për të analizuar funksionimin e sistemit elektroenergetik, ndër të tjera rëndësi ka edhe vlera e ngarkesave maksimale (pikut) e për këtë merren zakonisht pesë (5) ngarkesat maksimale të realizuara në orë dhe ditë të ndryshme të vitit. Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur vlerat e ngarkesave maksimale (pikut) për vitin 2022.

Tab. 6.12 Vlerat e ngarkesave maksimale (pikut) në vitin 2022

Ngarkesa maksimale Pmax (MW)	Data	Ora
1,429	24.01.2022	23
1,389	26.01.2022	23
1,375	13.01.2022	18
1,349	22.01.2022	24
1,341	12.01.2022	19

Ngarkesa maksimale në sistemin elektroenergetik të Kosovës është regjistruar me 24 janar 2022 në orën 23:00 në vlerë 1,429 MW, që është më e lartë se ngarkesa maksimale në vitin 2021 ku ka qenë 1,398 MW. Ngarkesa minimale është regjistruar më 29 maj 2022 në ora 06:00 në vlerë 294 MW

Siç është cekur edhe më lartë, për shkak të jofleksibilitetit të sistemi energjetik, e sidomos jofleksibilitetit në termocentralet ekzistuese, ndodhë që në të njëjtën ditë, madje edhe në të njëjtën orë të kemi importe dhe eksporte të energjisë elektrike. Por, në përgjithësi brenda të njëjtës ditë, në orët e ditës (tarifa e lartë) prodhimi nuk e mbulon kërkesën dhe nevojitet të importohet energji elektrike, ndërsa gjatë natës (tarifa e ulët) ka teprica të energjisë elektrike të cilat duhet të eksportohen.

Në diagramin më poshtë është paraqitur mesatarja për orë e kërkesës, prodhimit dhe shkëmbimi i energjisë elektrike, nga ku shihet relacioni i tyre gjatë periudhave të ndryshme ditore.




Fig. 6.9 Diagrami ditësi si mesatare vjetore për orë për vitin 2022

Dallimi në mes të mesatares mujore të maksimumeve dhe minimumeve ditore të konsumit gjatë muajve të vitit 2022 është paraqitur në diagramin e mëposhtëm.




Fig. 6.10 Mesatarja mujore e kërkesës dhe ngarkesat maksimale/minimale ditore 2022

Reduktimet si pasojë e mungesës së energjisë elektrike

Bazuar në raportet e operatorëve, gjatë vitit 2022 janë raportuar reduktime të energjisë si pasojë e mungesës së energjisë në sasi prej 21,553 MWh.

Duhet theksuar se Bordi i ZRRE në fund të vitit 2018 ka nxjerrë vendimin për ndalimin e reduktimeve për mungesë të energjisë, përveç në rastet kur rrezikohen stabilimentet.

Siç mund të vërehet nga diagrami më poshtë, me gjithë përpjekjet për eliminimin e reduktimit të furnizimit për shkak të mungesës së energjisë elektrike, gjatë viteve janë realizuar reduktime. Viteve të fundit reduktimet janë zvogëluar dukshëm dhe në disa vite janë eliminuar plotësisht, përveç vitit të fundit ku janë raportuar reduktime për shkak të gjendjes emergjente energjetike.

Figura më poshtë paraqet reduktimet për mungesë të energjisë elektrike ndër vite.




Fig. 6.11 Reduktimet e konsumit gjatë viteve 2011 - 2022

6.4.4 Kërkesa për energji elektrike dhe humbjet në rrjetin e transmetimit

Kërkesa e përgjithshme nacionale e energjisë elektrike në vitin 2022 ka qenë 6,547 GWh dhe paraqet një zvogëlim prej 4.9 % krahasuar me vitin 2021, kur ka qenë 6,885 GWh, kurse krahasuar me parashikimin në bilancin elektroenergjetik 2022 kërkesa është për 8.36 % më e ulët.

Në tabelën 6.13 është paraqitur kërkesa e përgjithshme dhe humbjet në transmetim të realizuara në vitin 2022 dhe të krahasuara me bilancin elektroenergjetik 2022.

Tab. 6.13 Kërkesa e përgjithshme dhe humbjet në rrjetin e transmetimit në vitin 2022

2022	Kërkesa bruto realizim	Kërkesa bruto bilanci	Raporti Realiz./Bilanc	Humbjet në transmetim realizimi		Humbjet në transmetim bilanci	
	MWh	MWh	%	MWh	%	MWh	%
Janar	816,880	813,523	100.41	15,396	1.88	16,372	2.01
Shkurt	630,636	655,411	96.22	11,194	1.77	13,706	2.09
Mars	685,772	708,682	96.77	12,819	1.87	13,551	1.91
Prill	541,521	608,926	88.93	8,255	1.52	11,286	1.85
Maj	433,860	477,431	90.87	6,297	1.45	7,596	1.59
Qershor	395,143	437,158	90.39	7,333	1.86	7,999	1.83
Korrik	436,067	468,303	93.12	8,490	1.95	8,273	1.77
Gusht	418,634	480,154	87.19	9,116	2.18	8,491	1.77
Shtator	405,624	434,704	93.31	8,161	2.01	9,048	2.08
Tetor	480,225	589,272	81.49	7,578	1.58	11,532	1.96
Nëntor	561,036	640,733	87.56	9,569	1.71	13,405	2.09
Dhjetor	741,922	830,314	89.35	14,046	1.89	15,402	1.85
Gjithsej	6,547,320	7,144,611	91.64	118,253	1.81	136,661	1.91

Nga viti 2011 ka stabilizim të kërkesës për energji elektrike, me luhatje të vogla nga viti në vit, dhe në vitin e fundit vërehet një ulje e vogël që mund të shihet në figurën e mëposhtme.




Fig. 6.12 Kërkesa e përgjithshme në sistemin elektroenergetik 2011-2022

Kërkesa e përgjithshme e energjisë elektrike ndahet në konsumin e konsumatorëve të kyçur në rrjetin e transmetimit, konsumin në sistemin e shpërndarjes (përfshirë humbjet), konsumin vetanak për nevojat e stabilimenteve prodhuese, si dhe humbjet e transmetimit, dhe kjo është paraqitur në tabelën e mëposhtme e ndarë sipas kategorive për vitin 2022.

Tab. 6.14 Kërkesa sipas kategorive dhe humbjet e energjisë

Kërkesa për energji 2022	Total
	MWh
Konsumi bruto në shpërndarje*	6,196,349
Konsumatorët e parregulluar	131,535
Konsumi intern i KEK-ut	101,182
Humbjet në transmetim	118,253
Kërkesa e përgjithshme	6,547,320
Shpenzimet vetanake të KEK nga transmetimi	120,356

(*) Energjia elektrike e pranuar në shpërndarje nga transmetimi + prodhimi në shpërndarje

Energjia elektrike që merret nga rrjeti i transmetimit për konsumin vetanak për nevojat e stabilimenteve prodhuese në vitin 2022 ka qenë 120 GWh, prej të cilave 96 GWh për gjeneratorët e TC Kosova A dhe 24 GWh për TC Kosova B.

Kërkesa për energji elektrike ndryshon sipas periudhës së shpenzimit por edhe sipas kategorive të konsumatorëve, dhe kjo është paraqitur në formë tabelare në vijim ku janë përfshirë edhe humbjet në rrjetin e transmetimit dhe shpërndarjes (humbjet teknike dhe komerciale)


Tab. 6.15 Pjesëmarrja e kategorive të ndryshme në kërkesën e përgjithshme 2022

2022/GWh	Gjithsej	Jan	Shk	Mar	Prill	Maj	Qer	Korr	Gush	Sht	Tet	Nen	Dhje
Konsumi në amvisëri	3,121	395.1	342.2	332.6	258.4	209.0	173.0	200.0	204.3	177.4	226.4	248.6	354.2
Konsumi komercial	1,194	142.0	78.9	107.6	91.0	85.9	89.4	99.8	102.1	83.2	91.9	100.8	121.6
Konsumi industrial	610	44.6	40.7	49.9	46.3	58.2	56.6	58.6	49.5	46.9	50.0	51.7	56.9
Humbjet komerciale	646	87.9	65.5	83.9	69.5	28.7	26.2	22.2	17.0	43.2	44.4	76.7	80.5
Humbjet teknike	757	121.1	83.4	90.0	60.8	39.0	36.3	39.4	28.7	38.2	50.6	64.3	105.0
Humbjet në transmetim	118	15.4	11.2	12.8	8.3	6.3	7.3	8.5	9.1	8.2	7.6	9.6	14.0
Kons. i mbr. i KEK-ut	101	10.7	8.8	9.0	7.3	6.7	6.3	7.6	7.9	8.6	9.4	9.2	9.6
Gjithsej	6,547	816.9	630.6	685.8	541.5	433.9	395.1	436.1	418.6	405.6	480.2	561.0	741.9

Kërkesa për energji elektrike, e paraqitur në tabelën 6.15, ndryshon sipas muajve, dhe te disa kategori ky ndryshim është mjaft i theksuar, si p.sh. konsumi familjar dhe humbjet komerciale që janë më të larta në sezonin dimëror, gjë që është kryesisht për shkak të shfrytëzimit të energjisë elektrike për ngrohje.

Humbjet në sistemin e transmetimit, janë në nivel të pranueshëm falë investimeve të bëra nga KOSTT dhe janë përafërsisht në të njëjtin nivel me humbjet në rrjetet transmetuese në rajon dhe Evropë.

Në figurën më poshtë janë paraqitur humbjet në përqindje në rrjetin e transmetimit ndaj kërkesës përgjithshme të sistemit elektroenergetik të Kosovës.


Fig. 6.13 Humbjet në përqindje në rrjetin e transmetimit 2011-2022

Humbjet e paraqitura në figurën më lartë janë humbjet në përqindje të kalkuluara ndaj kërkesës vendore, ndërsa për nivelin e humbjeve në transmetim ndikon e tërë energjia e futur në sistemin e transmetimit. Pra për kalkulimin e përqindjes së humbjeve ndaj ngarkimit të rrjetit të transmetimit duhet që të përfshihen përveç kërkesës vendore edhe rrjedhat tjera siç është transiti si dhe energjia për shpenzimet vetanake të gjeneratorëve, etj. Përqindja e humbjeve në transmetim e llogaritur në këtë formë është 1.25 %.

6.5 Sistemi i shpërndarjes së energjisë elektrike

Rrjeti i shpërndarjes, si aktivitet i rregulluar i energjisë, është përgjegjës për operimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të shpërndarjes dhe menaxhimin e gjeneratorëve të kyçur në sistemin e shpërndarjes.

Rrjeti i shpërndarjes përbëhet nga linjat e tensionit 35 kV, 10(20) kV, 6 kV dhe 0.4 kV, si dhe nënstationet përkatëse të nivelit 35/x kV, 10(20)/0.4 kV dhe 6/0.4 kV.

Të dhënat bazike të nënstationeve dhe linjave përfshirë kapacitetin, transformimin dhe gjatësinë e linjave të sistemit të shpërndarjes janë paraqitur në tabelat në vijim.

Tab. 6.16 Nënstationet dhe transformatorët sipas nivelit të tensionit në OSSH

Transformimi (kV/kV)	Pronari	Nr. i NS	Nr. i TR	Fuqia e instaluar (MVA)
35/10	KEDS	44	94	662
35/10	Privat	11	15	68
35/20	KEDS	2	5	41
35/6 kV	Privat	5	12	43
35/0.4kV	Privat	19	28	25
10(20)/0.4	KEDS	2,551	2,646	1,355
10(20)/0.4	Privat	3,078	3,095	1,567
10/20	KEDS	1	1	109
10/0.4	KEDS	2,893	2,893	909
10/0.4	Privat	1,247	1,253	606
6(3)/0.4	KEDS	66	66	13
6/0.4	Privat	1	1	1
Gjithsej		9,918	10,109	5,399

Tab. 6.17 Linjat në OSSH

Tensioni (kV)	Pronari	Rrjeti ajror (km)	Rrjeti kabllor (km)	Gjithsej (km)
35 kV	KEDS	484	138	622
10(20) kV	KEDS	1,632	546	2,178
10 kV	KEDS	4,165	904	5,069
6 kV	KEDS	42	8	50
3 kV	KEDS	4	1	5
0.4 kV	KEDS	17,915	2,659	20,574
Gjithsej		24,243	4,256	28,499

Skema më poshtë paraqet informata bazë mbi numrin e nënstationeve (NS), transformatorëve (TR) dhe fuqinë transformuese (MVA), gjatësinë e linjave, si dhe centralet kyçura në nivelin përkatës të tensionit.




Fig. 6.14 Të dhënat bazë të sistemit të shpërndarjes

6.5.1 Investimet në sistemin e shpërndarjes

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes investon vazhdimisht në rrjetin e shpërndarjes bazuar në buxhetin e ndarë të investimeve të aprovuar nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë, dhe në këtë mënyrë rritë funksionimin e sistemit të shpërndarjes për të ofruar furnizim të besueshëm me energji elektrike, si dhe rritje të kapacitetit të rrjetit ekzistues. Investimet përfshijnë projekte në rrjetin e tensionit të

mesëm dhe të ulët si dhe në projekte në digjitalizimin dhe modernizimin e rrjetit siç janë SCADA, njehsorët e mençur PLC etj.

Projektet janë zgjedhur duke analizuar kriteret teknike si: humbjet, ngarkesa e rrjetit, rëniet e tensionit, numri i ndërprerjeve, kërkesa e energjisë, rritja e konsumit, vjetërsia e rrjetit si dhe numri i konsumatorëve.

Projektet janë përzgjedhur duke analizuar nevojën për investime në fushat më kritike duke i vlerësuar ato përmes kriterëve të përparësisë për të arritur objektivat kryesore të investimeve, siç janë:

- Zvogëlimi i humbjeve teknike dhe jo teknike,
- Furnizimi i besueshëm dhe më cilësor me energji elektrike,
- Rritja e kapaciteteve ekzistuese të rrjetit dhe modernizimi i rrjetit.

Investimet e bëra përgjatë vitit 2022 nga Departamenti i Investimeve

Konvertimi i daljeve në nivelin e tensionit 20 kV

KEDS ka vazhduar me procesin e implementimit të investimeve në kalimin e daljeve 10kV në operim në nivelin e tensionit 20kV.

Investimet në nivelin 10 [kV]

Distrikti Prishtinë, Daljet Graçanica 1, Graçanica 2 & Hajvalia: Investimi në këto dalje ka ofruar furnizim cilësor dhe të besueshëm për konsumatorët, prej të cilit kanë përfituar gjithsej 3,962 konsumatorë.

Distrikti Ferizaj, Daljet Q.M.I dhe Zona Industriale: Nga ky projekt do të përfitojnë 338 konsumatorë. Implementimi i këtyre projekteve do të vazhdoj edhe gjatë vitit 2022.

Distrikti Pejë, Dalja Gllareva: Investimi në këtë dalje ka arritur t'iu mundësoj konsumatorëve të kësaj zone rritje të sigurisë, besueshmërisë dhe cilësisë teknike të rrjetit të shpërndarjes. Nga ky projekt kanë përfituar gjithsej 1,040 konsumatorë.

Dalja Vitimirica: Gjatë vitit 2022 është marrë parasysh gjendja e konsumatorëve në fjalë, kështu që ndërtimi i dy segmenteve të reja, saktësisht me një gjatësi prej 4.78 [km] ka arritur të sigurojë një infrastrukturë të re energjetike, duke zvogëluar numrin e prishjeve, humbjeve dhe problemet me rënie të tensionit. Nga ky investim kanë përfituar rreth 2,030 konsumatorë.

Dalja Barani: Me këtë projekt po investohet në tërë daljen ku do të përfitojnë 2,385 konsumatorë. Implementimi i të cilit projekt do të vazhdoj edhe pas këtij viti.

Dalja Rugova: Me këtë projekt po investohet në tërë daljen ku do të përfitojnë 993 banorë. Implementimi i të cilit projekt do të vazhdoj edhe pas këtij viti.

Në daljet Barani dhe Rugova po investohet tërësisht në nivelin 10 [kV], duke ndërruar të gjitha linjat, kthinat dhe traformatorët jo të përshtatshëm për operim në 20 [kV], për t'i përgatitur për konvertim në 20 [kV] pas kompletimit të projekteve.

Distrikti Gjakovë, Daljet e furnizuara nga NS Gjakova I 35/10 kV dhe Daljet e furnizuara nga NS Gjakova 2 110/10(20) kV: Cermjani, Dobroshi, Skivjani, Beci, Ura e Terzive, Ponosheci dhe Bistazhini furnizohen nga NS Gjakova I dhe NS Gjakova 2.

Daljet Ereniku dhe Piskota i janë shtuar listës së investimeve për shkak të kombinimit të daljeve ekzistuese në dalje të reja. Nga këto projekte përfitojnë 13,161 konsumatorë, Implementimi i këtyre projekteve do të vazhdoj edhe pas këtij viti.

Daljet e furnizuara nga NS Malisheva 35/10 kV: Carralluka, Mirusha, Bellanica dhe Kijeva furnizohen nga NS 35/10 kV Malisheva, ku nga këto projekte do të përfitojnë 7,636 konsumatorë dhe implementimi do të vazhdoj edhe pas këtij viti.

Në daljet e furnizuara nga NS Gjakova I (Skivjani, Beci, Cermjani, Dobroshi, Ponosheci, Piskota, Ereniku), daljet e furnizuara nga NS Gjakova 2 (Ura Terezive dhe Bistazhini) dhe daljet nga NS Malisheva (Caralluka, Mirusha, Bellanica dhe Kijeva) po investohet tërësisht në nivelin 10 [kV], duke ndërruar të gjitha linjat, kthinat dhe traformatorët jo të përshtatshëm për operim në 20 [kV], për t'i përgatitur për konvertim në 20 [kV] pas kompletimit të projekteve.

Distrikti Mitrovicë, Daljet e furnizuara nga NS Skenderaj 110/10 kV: Qirezi, Likovci, Turiqevci dhe Llausha, ku nga këto investime do të përfitojnë 5,877 konsumatorë dhe implementimi i këtyre projekteve do të vazhdoj edhe pas këtij viti.

Dalja Qytet e Fshatra: Do të investohet tërësisht në dalje dhe do të përfitojnë 2,739 konsumatorë dhe implementimi do të vazhdoj edhe pas këtij viti.

Në daljet e furnizuara nga NS Skenderaji (Qirezi, Likovci, Turiqevci dhe Llausha) dhe daljen Qytet e Fshatra po investohet tërësisht në nivelin 10 [kV], duke ndërruar të gjitha linjat, kthinat dhe traformatorët jo të përshtatshëm për operim në 20 [kV], për t'i përgatitur për konvertim në 20 [kV] pas kompletimit të projekteve.

Investimet në rrjetin e tensionit të ulët

Në gjithë rrjetin e KEDS-it, ka pjesë të rrjetit të cilat kërkojnë investime për shkak të gjendjes së vjetruar. Në mënyrë që të investohet në zonat më kritike, analiza është bërë duke marrë parasysh kriteret e prioriteteve për zgjedhjen e projekteve.

Identifikimi i projekteve më urgjente u bë duke analizuar kriteret teknike si:

- Ngarkesa e rrjetit (Linjave dhe nënstacioneve elektrike)
- Numri i ndërprerjeve
- Rëniat e tensionit
- Vjetërsia e rrjetit
- Numri i konsumatorëve
- Humbjet e energjisë elektrike

Investimet e bëra ne projektet e tensionit të ulët përfshijnë:

- Transformatorë të rinj në zonat që kanë nevojë për investime
- Zëvendësimi i transformatorëve ekzistues me ata të ri; për rritjen e kapacitetit
- Rehabilitimi i rrjetit të tensionit të ulët
- Përforcimi i rrjetit të tensionit të mesëm brenda fushëveprimit të projekteve të TU, në përputhje me planet e ardhshme të daljeve të TM
- Zgjerimi i rrjetit të TM për kyçjen e transformatorëve të ri
- Vendosja e MMO-ve, që do të thotë lëvizja e njehsorëve jashtë në shtyllë ose në ormana tokësorë të njehsorëve

- Kyçja e konsumatorit në njehsorët e vendosur jashtë shtëpive

Distrikti Prishtinë - Në vitin 2022 në kuadër të projekteve të tensionit të ulët janë implementuar projekte në rajonin e Drenasit, Obiliqit, Podujevës dhe Prishtinës. Këto projekte përfshijnë përfundim dhe zgjerim të rrjetit.

Distrikti Prizren - Në vitin 2022 në kuadër të projekteve të tensionit të ulët janë implementuar projekte në rajonin e Suharekës. Këto projekte përfshijnë vetëm projekte të përfundimit të rrjetit.

Distrikti Pejë - Në vitin 2022 në kuadër të projekteve të tensionit të ulët janë implementuar projekte në rajonin e Deçanit. Këto projekte përfshijnë vetëm përfundim të rrjetit.

Distrikti Gjakovë - Në vitin 2022 në kuadër të projekteve të tensionit të ulët janë implementuar projekte në rajonin e Gjakovës dhe Malishevës. Këto projekte përfshijnë përfundim dhe zgjerim të rrjetit.

Distrikti Mitrovicë Në vitin 2022 në kuadër të projekteve të tensionit të ulët janë implementuar projekte në rajonin e Vushtrrisë, Skenderajit dhe Mitrovicës. Këto projekte përfshijnë përfundim dhe zgjerim të rrjetit.

Lidhjet e reja Në kuadër të projekteve të tensionit të ulët janë implementuar edhe projektet e llojit Lidhje të reja. Nga këto projekte është investuar në tërë Kosovën.

Si përfundim, për të gjitha investimet e vitit 2022 për rrjetin TM dhe TU, janë shpenzuar materiale si më poshtë:

Tab. 6.18 Sasitë e materialit të përdorur në vitin 2022

Lloji i materialit	Sasia	Njësia
Transformatorë	195	copë
Shtylla	10,111	copë
Kuti për njehsorë	3,945	copë
Panel i TU	77	copë
Kioska	7	copë
Kthina	80	copë
Kabllo	506,270	m
Përçues	239,450	m
Kapak për puseta	812	copë
Gypa	26,780	copë

Investimet e bëra përgjatë vitit 2022 nga Departamenti i Operimit të Sistemit

Projektet dhe punët e realizuara përgjatë vitit 2022 nga Departamenti i Operimit të Sistemit

Projektet investive të vitit 2022 janë paraqitur në dy pjesë, si projektet në nivel të tensionit të mesëm 10(20) [kV] dhe projektet në nivel të tensionit të ulët në 0.4 [kV]. Klasifikimi i këtyre projekteve është bërë nga natyra e punës së projektit, në projektet 10 [kV] përfshihen:

1. Zhvendosjet dhe rrjeti i ri në rrjetin e tensionit të mesëm;
2. Krijimi i linjave të reja;
3. Investimet në stabilimentet shpërndarëse për operim më të lehtë etj.

Në projektet 0.4 [kV] përfshihet:

1. Rikonstruimi i rrjetit të tensionit të ulët;
2. Zhvendosja dhe instalimi i NS 10/0.4 [kV];
3. Implementimi i njehsorëve të mençur PLC etj.

Pjesa e parë e vitit 2022 karakterizohet me investime në projektet 0.4 [kV], ku është bërë rikonstruimi i rrjetit të tensionit të ulët dhe punë të tjera në këto projekte. Ndërsa gjysma e dytë e vitit kryesisht ka të bëjë me investimet në tension të mesëm, ku janë punuar shkarkime të daljeve 10 [kV], krijimin e linjave të reja, gjithashtu në fund të vitit është intervenuar edhe në shkarkim të daljeve të mbingarkuara 0.4 [kV] dhe në ndërrim të transformatorëve të mbingarkuar. Si përfundim mund të cilësojmë si një vit me rritje të vlerave investive në rrjet të tensionit të mesëm dhe të ulët.

Gjatë vitit 2022, Departamenti i Sistemit të Operimit në sajë të realizimit të projekteve ka investuar në projektet të cilat kanë të bëjnë me fushat si më poshtë:

- **Mirëmbajtja dhe rehabilitimi i rrjetit**
 - o Ndërrime të shtyllave të TM dhe TU;
 - o Pastrim të trasesë së rrjetit të TU dhe TM si masë preventive në krijimin e kushteve për punë të linjave pa qenë të afektuar nga faktorët e jashtëm si degët e pemëve, etj;
 - o Ndërrime të përçuesve dhe shtrëngim i tyre, ndërrim i izolatorëve, shkarkuesve të mbitemensionit, konzollave dhe çdo elementi tjetër, i cili gjatë inspektimit paraprak ka qenë i destinuar të dështoj shumë shpejtë dhe të bëhet burim i prishjes;
 - o Zhvendosja e linjave 10 dhe 0.4 kV me qëllim të mirëmbajtjes dhe rregullimit sa më të lehtë të prishjeve;
 - o Përforcimi i bazamenteve të Trafo shtyllave, shtyllave të konstruksionit metalik;
 - o Rregullim i trafo blindave, konstruksionet metalike të tyre;
 - o Ndërrimin e Transformatorëve të dëmtuar dhe mbingarkuar
- **Pastrimi i linjave shpërndarëse 10, 20 dhe 35 [kV]**
- **Ndërrimi i Transformatorëve të mbingarkuar**
- **Investimet në projektet 10 [kV]**
 - o Projekti: Linja ajrore 10 [kV] Kaçaniku i vjetër
- **Zhvendosje/Dislokim i linjave 10 [kV]**
 - o Projekti: LP 10 [kV] Sllovi
 - o Projekti: LP 10 [kV] NS Peshter – NS Brus 1
 - o Projekti: Lp 10 [kV] Peqani
 - o Projekti: Lp 10 [kV] Maja e Zezë
- **Implementimi i Stabilimenteve shpërndarëse**
 - o Projekti: Stabilimenti Shpërndarës - Sllovi
- **Investimet në projektet 0.4 [kV]**
- **Realizimi i Projekteve PLC**
- **Projektet me qëllim të përmirësimit të rrjedhës së fuqisë dhe përmirësim i rënjeve të tensionit të ulët**

- o Projekti: Përforcimi i tensionit në NS Kramoviku 1
- o Projekti: Përforcimi i tensionit Qarkore Sistemi
- o Projekti: Përforcimi i tensionit – Sadovinë e Jerlive
- o Projekti: Përforcimi i tensionit në TSB Moteli
- o Projekti: Përforcimi i tensionit në Baballoqi 1 dhe Baballoqi 2
- o Projekti: Përforcimi i tensionit në Fshatin Hajvalli (Ulzat 1 & 2)
- o Projekti: Tregu me shumicë
- o Projekti: Fidanishte
- Punimet në balancim të ngarkesave në rrjetin e tensionit të ulët
 - o Projekti: Balancimi i ngarkesave në Junik
 - o Projekti: Balancimi i ngarkesave në Prishtinë
- Realizimi i projekteve ne vendosje te Transformatorëve te rijnë
 - o Projekti: Instalimi i TS në Gjakovë – Smaqi 3
 - o Projekti: Instalimi i TS në Radivojc
 - o Projekti: Instalimi i TS në Vaganicë 2 (B. Sahiti)
 - o Projekti: Instalimi i TS Gërvalla - Shabani
 - o Projekti: Instalimi i TS Zhuri i Ri
 - o Projekti: Instalimi i TS Bajqinë Sogujevët
 - o Projekti: Instalimi i TS Stagovë
- Investimet në pikën matëse

Gjatë vitit 2022 janë investuar njehsorët si në vijim:

 - o 857 njehsorë me matje direkte me komunikim GSM GPRS
 - o 9,178 njehsorë me matje direkte me PLC
 - o 1,081 njehsorë me matje gjysëm indirekte dhe indirekte, prej të cilëve 177 janë njehsorë të rij dhe 904 njehsorë të ndërruar;
 - o 5,816 njehsorë mekanik që janë ndërruar me digjital
 - o 25,788 njehsorë të dedikuar për lidhje të reja
- Investimet në sistemin SCADA
 - o Instalimi i sistemit SCADA në stabilimentin Raskovë
 - o Instalimi i sistemit SCADA në stabilimentin HC Vica
- Integrimi i ndryshimeve të reja në sistemin SCADA – 2022
- Realizimi i Sistemit të Menaxhimit të Shpërndarjes (DMS)
- Ndërrimi dhe instalimi i transformatorëve të fuqisë në nënstacione
 - o Ndërrimi i transformatorëve të fuqisë në NS 35/10 [kV] Gjakova III
 - o Ndërrimi i transformatorëve të fuqisë në NS 35/10 [kV] Badovci
 - o Ndërrimi i transformatorit të fuqisë në NS 35/10 [kV] Besia
 - o Ndërrimi i transformatorit të fuqisë në NS 35/10 [kV] Lipjani
- Mirëmbajtja e nënstacioneve të tensionit të mesëm

6.5.2 Konsumi dhe humbjet në shpërndarje

Rrjedhat e energjisë në shpërndarje përfshijnë konsumin, humbjet teknike dhe ato komerciale, të cilat janë të llogaritura sipas distrikteve dhe sipas muajve të vitit.

OSSH është e organizuar në shtatë distrikte: Prishtina, Mitrovica, Peja, Gjakova, Prizreni, Ferizaji dhe Gjilani. Bazuar në raportimet nga OSSH, konsumi më i lartë është realizuar në distriktin e Prishtinës me 30.4 % ndaj konsumit të përgjithshëm në shpërndarje, ndërsa konsumi më i ulët është në distriktin e Gjilanit me 8.6 % të konsumit të përgjithshëm.

Rrjedhat e energjisë në shpërndarje sipas distrikteve përfshirë edhe humbjet e energjisë elektrike janë paraqitur në tabelën 6.19. Të dhënat për distriktin e Mitrovicës përfshijnë edhe konsumin në komunat veriore, i cili është llogaritur në kategorinë e humbjeve komerciale.

Tab. 6.19 Konsumi dhe humbjet në shpërndarje sipas distrikteve për vitin 2022

Distriktet	Ngarkesa në distrikte	Energjia e faturuar	Humbjet teknike		Humbjet komerciale		Humbjet gjithsej	
	MWh	MWh	MWh	%	MWh	%	MWh	%
Prishtina	1,886,514	1,596,424	221,763	11.76	68,327	3.62	290,090	15.38
Mitrovica	914,837	414,784	75,252	8.23	424,801	46.43	500,053	54.66
Peja	676,481	511,344	98,219	14.52	66,918	9.89	165,137	24.41
Gjakova	547,790	438,831	91,472	16.70	17,486	3.19	108,958	19.89
Prizreni	768,925	644,746	105,104	13.67	19,076	2.48	124,180	16.15
Ferizaji	871,880	726,300	105,663	12.12	39,917	4.58	145,580	16.70
Gjilani	529,922	461,371	59,320	11.19	9,231	1.74	68,550	12.94
Gjithsej	6,196,349	4,793,801	756,792	12.21	645,756	10.42	1,402,548	22.64

Në tabelën më poshtë janë paraqitur kërkesa (ngarkesa), energjia e faturuar si dhe humbjet teknike dhe komerciale në shpërndarje sipas muajve.

Tab. 6.20 Konsumi dhe humbjet në shpërndarje në vitin 2022

Muajt	Ngarkesa	Energjia e faturuar	Humbjet teknike		Humbjet komerciale		Humbjet gjithsej	
	MWh	MWh	MWh	%	MWh	%	MWh	%
Janar	785,883	576,855	121,125	15.41	87,903	11.19	209,028	26.60
Shkurt	606,678	457,778	83,411	13.75	65,490	10.79	148,901	24.54
Mars	657,350	483,520	89,957	13.68	83,873	12.76	173,830	26.44
Prill	516,761	386,434	60,848	11.77	69,479	13.45	130,327	25.22
Maj	397,897	330,237	38,959	9.79	28,702	7.21	67,661	17.00
Qershor	361,362	298,863	36,271	10.04	26,228	7.26	62,499	17.30
Korrik	401,482	339,829	39,404	9.81	22,249	5.54	61,653	15.36
Gusht	392,480	346,822	28,701	7.31	16,957	4.32	45,658	11.63
Shtator	379,973	298,572	38,196	10.05	43,205	11.37	81,401	21.42
Tetor	453,798	358,830	50,552	11.14	44,416	9.79	94,968	20.93
Nëntor	533,396	392,343	64,333	12.06	76,720	14.38	141,053	26.44
Dhjetor	709,290	523,719	105,036	14.81	80,535	11.35	185,570	26.16
Totali i realizuar	6,196,349	4,793,801	756,792	12.21	645,756	10.42	1,402,548	22.64
Totali sipas bilancit	5,893,004	4,820,059	826,381	14.02	246,563	4.18	1,072,945	18.21

Humbjet teknike sipas të dhënave të dërguara nga OSSH arrijnë vlerën 12.21 %, ku ndikim në nivelin e lartë të këtyre humbjeve kanë vjetërsia e rrjetit, gjatësia e linjave, kualiteti dhe lloji i përcuesve dhe transformatorëve, ngarkimi i pajisjeve, si dhe mirëmbajtja e tyre.

Humbjet jo-teknike (komerciale), duke mos përfshirë humbjet (konsumi) në katër komunat veriore, kanë qenë 283.4 GWh dhe përbëjnë 4.57 % të gjithsej kërkesës në shpërndarje. Energjia e pafaturuar në katër komunat veriore të Kosovës ka qenë 362 GWh apo 5.85 %.

Prandaj humbjet e gjithmbarshme jo-teknike ndaj kërkesës së përgjithshme në shpërndarje, përfshirë humbjet në katër komunat veriore të Kosovës, në vitin 2022 kanë qenë 646 GWh, apo 10.42 % ndaj kërkesës së përgjithshme në shpërndarje.

Humbjet totale në sistemin e shpërndarjes janë të matura dhe paraqesin diferencën mes energjisë në hyrje të shpërndarjes dhe energjisë së faturuar. Meqenëse nuk mund të maten veçmas humbjet teknike dhe ato komerciale, atëherë ndarja e këtyre humbjeve bëhet përmes kalkulimit të humbjeve teknike përmes softuerëve përkatës, ndërsa humbjet komerciale më tej kalkulohen si diferencë mes humbjeve totale dhe atyre teknike.

Kërkesa e energjisë elektrike në nivel të Operatorit të Sistemit të Shpërndarje në vitin 2022 është realizuar në vlerën 6,196 GWh, ndërsa në vitin 2021 ka qenë 6,260 GWh, që paraqet një zvogëlim përafërsisht 1.01 %.

Kërkesa në sistemin e shpërndarjes ka rritje të vazhdueshme, për deri sa në vitin e fundit ka pësuar zvogëlim për shkak ndikimit të ndryshimit të strukturës tarifor, vendosja e bllokut tarifor, si dhe temperaturave mesatare më të larta krahasim me vitin e kaluar, kryesisht gjatë sezonit të dimrit. Në figurën e mëposhtme janë paraqitur të dhënat e kërkesës në sistemin e shpërndarjes nga viti 2011 deri 2022.




Fig. 6.15 Kërkesa për energji elektrike në sistemin e shpërndarjes 2011-2022

Edhe përkundër investimeve të realizuara deri më tani në rrjetin e shpërndarjes, humbjet e energjisë elektrike ende mbeten të larta dhe paraqesin problem shqetësues për sektorin e energjisë elektrike. Humbjet po ashtu kanë ndikim negativ edhe në furnizimin e konsumatorëve dhe qëndrueshmërinë financiare të operatorëve të furnizimit dhe shpërndarjes, si dhe tërë sektorin e energjisë.

Kostoja e humbjeve të energjisë elektrike deri në nivelin e përcaktuar nga Rregullatori mbulohet nga tarifa e konsumatorëve. Operatori i sistemit të shpërndarjes bënë përpjekje të vazhdueshme për zvogëlimin e humbjeve në shpërndarje, mirëpo pavarësisht zvogëlimit të humbjeve ndër vite, OSSH nuk ka arritur të përmbush caqet e përcaktuara nga Rregullatori, që do të thotë se kostoja e pjesës së tejkaluar e këtyre caqeve bartet nga vet OSSH.

Më poshtë është paraqitur grafiku me të dhënat për humbjet teknike, komerciale dhe humbjeve gjithsej në shpërndarje nga viti 2011 deri 2022, ku shihet trendi i zvogëlimit të humbjeve por edhe luhatjet në nivelin e humbjeve teknike dhe komerciale.




Fig. 6.16 Humbjet teknike dhe komerciale në shpërndarje për periudhën 2011-2022

Në përgjithësi humbjet e energjisë elektrike në OSSH, përfshirë edhe humbjet (konsumin) në katër komnatat veriore të Kosovës, janë zvogëluar nga 24.6 % sa ishin në vitin 2021 në 22.6 % ndaj kërkesës në shpërndarje.

6.6 Furnizimi me energji elektrike

Furnizimi me energji elektrike për konsumatorët fundor edhe gjatë vitit 2022 ka vazhduar të realizohet nga KESCO i cili është furnizues me obligim të shërbimit universal, i cili ka furnizuar konsumatorët me çmime të rregulluara si dhe kryesisht konsumatorët me çmime të parregulluara për të cilët është mbajtur llogari e veçantë.

Pjesëmarrja e konsumatorëve familjarë në konsumin e përgjithshëm të faturuar edhe më tutje mbetet dominues me rreth 63.27 %, e pasuar nga konsumi komercial me 23.59 %, e pastaj nga konsumi industrial me 12.38 %, dhe në fund nga konsumi në ndriçimin publik me 0.76 %. Krahasuar me vitin e kaluar, kërkesa bruto është zvogëluar për 4.91 %, konsumi i konsumatorëve familjar është zvogëluar rreth 0.47 %, konsumi i konsumatorëve komercial është rritur rreth 4.77 %, si dhe konsumi industrial është zvogëluar rreth 27.6 %.

Në figurën më poshtë është paraqitur pjesëmarrja në përqindje e kategorive të konsumit krahasuar me konsumin e përgjithshëm (e paraqitur me humbje dhe pa humbje).




Fig. 6.17 Pjesëmarrja e kategorive të konsumit - me dhe pa humbje 2022

6.6.1 Faturimi dhe arkëtimi

Energjia e faturuar në sistemin e shpërndarjes në vitin 2022 ka qenë 4,793 GWh dhe paraqet rreth 77.4 % ndaj ngarkesës së sistemit të shpërndarjes, e që krahasuar me vitin 2020 është më e lartë për 1.53 %.

Tabela më poshtë paraqet faturimin, arkëtimin për energji dhe arkëtimin bruto të shpërndarjes si dhe raportin mes faturimit dhe arkëtimin për energji sipas muajve për vitin 2022, ku shihet se në disa muaj ky raport është më i lartë se vlera 100 %, që nënkupton se në këta muaj është arkëtuar energjia elektrike e faturuar për muajt paraprak.

Tab. 6.21 Faturimi dhe arkëtimi sipas muajve në shpërndarje për vitin 2022

Shpërndarja 2022	Ngarkesa	Realizimi	Faturimi	Arkëtimi	Ark/Fat
	MWh	MWh	€	€	%
Janar	785,883	576,855	38,105,121	31,020,715	81.4%
Shkurt	606,678	457,778	32,497,101	29,401,561	90.5%
Mars	657,350	483,520	37,640,122	33,109,280	88.0%
Prill	516,761	386,434	29,864,065	32,756,775	109.7%
Maj	397,897	330,237	25,842,028	26,039,380	100.8%
Qershor	361,362	298,863	23,058,087	23,413,129	101.5%
Korrik	401,482	339,829	25,802,690	22,987,228	89.1%
Gusht	392,480	346,822	26,361,482	26,109,694	99.0%
Shtator	379,973	298,572	15,149,940	24,370,791	160.9%
Tetor	453,798	358,830	26,729,592	23,282,555	87.1%
Nëntor	533,396	392,343	29,844,314	25,156,390	84.3%
Dhjetor	709,290	523,719	40,277,193	34,685,923	86.1%
Gjithsej	6,196,349	4,793,801	351,171,736	332,333,420	94.64%

Energjia elektrike e faturuar dhe arkëtuar (bruto) në shpërndarje si dhe raporti mes faturimit dhe arkëtimit bruto nga viti 2011 deri në 2022 është paraqitur në figurën e mëposhtme.




Fig. 6.18. Faturimi dhe arkëtimi në shpërndarje gjatë viteve 2011-2022

Niveli i arkëtimit vetëm për energji në shpërndarje për vitin 2022 ka qenë 94.64 %, që është për 3.79 pikë përqindje më i lartë se vitin e kaluar, kurse kur llogariten edhe konsumatorët e kyçur në rrjetin e transmetimit atëherë arkëtimi i përgjithshëm arrin në 94.93 %.

Konsumi i kategorizuar sipas nivelit të tensionit dhe grupeve të konsumatorëve që shfrytëzojnë energjinë elektrike për vitin 2022 është dhënë në tabelën më poshtë.

Tab. 6.22 Energjia elektrike e faturuar sipas kategorive tarifore 2022

Kategoritë (GWh)	Gjithsej	Jan	Shku	Mar	Pri	Maj	Qer	Korr	Gush	Shta	Tet	Nën	Dhje
220 kV (Ferronikeli)	47.1	0.8	0.7	0.8	1.1	14.9	13.7	11.1	0.8	0.7	0.8	0.9	0.9
110 kV (Trepça)	23.2	2.1	2.1	2.2	2.2	1.8	1.8	1.7	1.7	1.8	1.9	1.9	2.0
110 kV (Sharrcem)	61.2	2.0	1.1	3.7	5.9	6.2	4.6	5.7	6.6	6.4	6.8	6.1	6.0
35 kV	55.9	3.9	4.1	5.1	4.4	4.6	4.9	5.0	5.0	4.6	4.7	4.7	4.9
10 kV	422.4	35.8	32.6	38.2	32.7	30.7	31.6	35.0	35.3	33.4	35.8	38.2	43.0
Amvisnia	3,116.2	419.9	317.6	327.4	258.4	209.0	173.0	200.0	204.3	177.4	226.4	248.6	354.2
0.4 kV I	434.9	39.5	35.0	39.9	33.4	32.0	34.4	37.7	36.6	32.5	34.3	36.7	42.9
0.4 kV II	727.0	74.0	65.3	69.7	54.7	51.3	52.6	59.7	62.7	47.7	54.1	60.5	74.9
Ndriqimi publik	37.6	3.8	3.2	3.3	2.9	2.7	2.5	2.4	2.8	3.0	3.6	3.6	3.8
Gjithsej faturuar	4,925.3	581.7	461.7	490.2	395.6	353.2	319.0	358.4	356.0	307.4	368.3	401.2	532.7
Konsumi KEK	101.2	10.7	8.8	9.0	7.3	6.7	6.3	7.6	7.9	8.6	9.4	9.2	9.6
Humbjet OSSH	1,402.5	209.0	148.9	173.8	130.3	67.7	62.5	61.7	45.7	81.4	95.0	141.1	185.6
Humbjet KOSTT	118.3	15.4	11.2	12.8	8.3	6.3	7.3	8.5	9.1	8.2	7.6	9.6	14.0
Gjithsej	6,547.3	816.9	630.6	685.8	541.5	433.9	395.1	436.1	418.6	405.6	480.2	561.0	741.9

Energjia elektrike e faturuar në sistemin e transmetimit dhe në sistemin e shpërndarjes në vitin 2022 ka qenë 4,925 GWh, e që shprehur në vlerë monetare (përfshirë edhe TVSH) është 371.24 mil€, ndërsa arkëtimi bruto është 352.40 mil€.

Tabela e mëposhtme paraqet faturimin, arkëtimin, si dhe raportin në mes arkëtimin dhe faturimit.

Tab. 6.23 Faturimi dhe arkëtimi në vitin 2022

2022	Faturimi	Arkëtimi	Ark/Fat
	€	€	%
Konsumatorët e rregulluar	351,171,736	332,333,420	94.64%
Konsumatorët e parregulluar	20,066,906	20,066,906	100.00%
Gjithsej	371,238,642	352,400,326	94.93%

Çmimi mesatar i energjisë elektrike

Çmimi mesatar i shitjes së energjisë elektrike është i bazuar në tarifat për aktivitetet e rregulluara të energjisë elektrike dhe ndryshon varësisht nga kategoria e konsumatorëve, niveli i tensionit në të cilin janë të kyçur konsumatorët dhe shfrytëzimi i energjisë elektrike në tarifa të ndryshme sipas sezonës dhe kohës në të cilën është shfrytëzuar energjia. Ky çmim mesatar i shitjes (pa TVSH) është paraqitur në figurën e mëposhtme. Çmimi mesatar i shitjes poashtu ndryshon edhe sipas distrikteve varësisht nga koncentrimi i aktivitetëve komerciale/industriale që shfrytëzojnë energji elektrike në periudha të caktuara.




Fig. 6.19 Çmimi mesatar i shitjes së energjisë elektrike 2022 (pa TVSH)

Për kategorinë e konsumatorëve familjar çmimi mesatar i energjisë është 6.14 €cent/kWh që është pak më i lartë se në vitin 2021 kur ka qenë 5.60 €cent/kWh, ndërsa për konsumatorët jo-familjar çmimi mesatar i energjisë është 9.27 €cent/kWh që është pak më i lartë se çmimi mesatar në vitin 2021 kur ka qenë 8.39 €cent/kWh.

Në figurën më poshtë janë paraqitur çmimet mesatare të energjisë elektrike për konsumatorët familjar dhe jo-familjar për dhjet vitet e fundit, çmime të cilat nuk përfshijnë TVSH.





Fig. 6.20 Çmimi mesatar i shitjes së energjisë elektrike (pa TVSH) ndër vite

Krahasuar me vendet e rajonit dhe bazuar në të dhënat e nxjerra nga Eurostat për gjashtëmujorin e parë të vitit 2022, Kosova ka çmimin mesatare pa TVSH më të ulët për konsumatorët familjar. Të dhënat e Eurostat-it të kategorizuara sipas konsumit familjar 2500-5000 kWh/vit, për gjashtë mujorin

e parë të vitit 2022 për disa shtete, meqë mungojnë ende të dhënat për gjashtëmujorin e dytë janë paraqitur në figurën e mëposhtme.



*Burimi i të dhënave nga EUROSTAT

Fig. 6.21 Çmimet mesatare për konsumatorët familjar për 6 mujorin e parë 2022 (pa TVSH)

6.7 Importi dhe eksporti i energjisë elektrike

Në përgjithësi, pjesa më e madhe e kërkesës së gjithmbarshme për energji elektrike në sistemin elektroenergetik të Kosovës mbulohet nga gjenerimi vendor i dominuar nga termocentralet, derisa pjesa tjetër sigurohet nga importi i cili realizohet përmes linjave ndërkuftare.

Pjesëmarrja e importit ndaj kërkesës së gjithmbarshme për energji ka qenë 11.63 %, duke shënuar rënie për rreth 7.41 pikë përqindje në raport me vitin e kaluar e që ishte rreth 19.04 %.

Përmes linjave interkonektive nga sistemi rajonal në sistemin elektroenergetik të Kosovës, kanë hyrë 3,376,161 MWh, ndërsa kanë dalë 3,130,739 MWh, ku -245,422 MWh paraqet ndryshimin në mes hyrje-dalje i cili ndahet në neto importin dhe devijimet ndaj sistemit rajonal.

Në tabelën më poshtë janë paraqitur rrjedhat e energjisë elektrike në linjat interkonektive me vendet fqinje.

Tab. 6.24 Rrjedhat e energjisë elektrike në linjat interkonektive për vitin 2022

Rrjedha në linjat interkonektive MWh	400 kV		220 kV		110 kV		Gjithsej	
	Marrje	Dërgim	Marrje	Dërgim	Marrje	Dërgim	Marrje	Dërgim
Shqipëria	113,253	1,008,190	514,989	87,519			628,242	1,095,708
Maqedonia	769,744	449,750					769,744	449,750
Mali i Zi	279,056	1,154,899					279,056	1,154,899
Sërbia	1,582,429	113,193	82,741	169,163	33,950	148,026	1,699,120	430,382
Gjithsej	2,744,481	2,726,031	597,729	256,682	33,950	148,026	3,376,161	3,130,739
Bilanci	-18,451		-341,047		114,076		-245,422	

Importi i realizuar për vitin 2022 ka qenë 761,245 MWh, me të cilin janë plotësuar mungesat e energjisë sidomos në kohën e pikut në sezonin e dimrit kur kërkesa ishte e papërbalueshme për prodhimin vendor.

Kjo sasi përfshinë energjinë elektrike të importuar për konsumatorët e rregulluar dhe të parregulluar, për humbjet në rrjetin e transmetimit dhe humbjet në rrjetin e shpërndarjes, e cila është siguruar përmes kontratave komerciale si dhe përmes shkëmbimit energji për energji në mes të KEK dhe KESH.

Importi i energjisë elektrike për vitin 2022 ka qenë për 550,216 MWh më i ulët se sa në vitin 2021 që ishte 1,311,461 MWh.

Çmimi mesatar i importit të energjisë elektrike me kontrata komerciale gjatë vitit 2022 ka qenë 268.82 €/MWh, dhe krahasuar me vitin e kaluar që ishte 119.29 €/MWh, këtë vit çmimi mesatar i importit është më i lartë për 149.53 €/MWh.

Të dhënat për importet dhe eksportet e energjisë elektrike janë paraqitur në tabelën në vijim.

Tab. 6.25 Importi dhe eksporti i energjisë elektrike për vitin 2022

Importi/Eksport MWh	Importi me kontrata	Importi si shkëmbim	Gjithsej Importi	Eksporti me kontrata	Eksporti si shkëmbim	Gjithsej Eksporti	Net Imp/Eksp
Janar	263,357	4,080	267,437	4,564	838	5,402	-262,035
Shkurt	83,869	0	83,869	18,825	5,350	24,175	-59,694
Mars	48,790	194	48,984	38,723	13,453	52,176	3,192
Prill	18,800	10,777	29,577	75,043	12,945	87,988	58,411
Maj	15,814	8,799	24,613	109,305	15,853	125,158	100,545
Qershor	12,815	0	12,815	98,782	67,585	166,367	153,552
Korrik	29,874	4,329	34,203	18,968	53,946	72,914	38,711
Gusht	25,518	7,152	32,670	14,657	36,648	51,305	18,635
Shtator	9,856	6,285	16,141	62,577	17,069	79,646	63,505
Tetor	42,997	2,968	45,965	50,836	0	50,836	4,871
Nëntor	50,304	3,328	53,632	53,608	0	53,608	-24
Dhjetor	73,944	37,395	111,339	17,110	141	17,251	-94,088
Gjithsej	675,938	85,307	761,245	562,998	223,828	786,826	25,581

Çmimi mesatar i eksportit të energjisë elektrike me kontrata komerciale gjatë vitit 2022 ka qenë 207.36 €/MWh. Përveç eksportit me kontrata, gjithashtu është eksportuar edhe një sasi e energjisë elektrike si shkëmbim (energji për energji) në mes të KEK dhe KESH, gjithsej eksporti i energjisë elektrike për vitin 2022 ka qenë 786,826 MWh.

Siç shihet nga të dhënat e paraqitura më lartë, në vitin 2022 Kosova ka qenë neto eksportuese e energjisë elektrike dhe atë në sasi prej 25,581 MWh, të paraqitura sipas muajve në figurën e mëposhtme.




Fig. 6.22 Importi dhe eksporti i energjisë elektrike në vitin 2022

Tepricat e energjisë elektrike janë kryesisht në orët e natës (në kohën e tarifës së ulët), kur edhe në sistemet rajonale paraqiten teprica, gjë që ndikon që çmimet e eksportit të jenë dukshëm më të ulëta se sa çmimet e importit.

Çmimi i importit dhe eksportit të energjisë elektrike gjatë viteve 2011 - 2022 ka shënuar ngritje dhe rënie. Më poshtë është dhënë figura ku janë paraqitur çmimet e importit dhe eksportit nga viti 2011 deri 2022.




Fig. 6.23 Çmimi mesatar i importit dhe eksportit gjatë viteve

6.8 Standardet e cilësisë së furnizimit dhe shërbimit me energji elektrike

Standardet e cilësisë së furnizimit dhe shërbimit me energji elektrike janë të rregulluara në Rregullën për Standardet e Cilësisë së Shërbimit të Energjisë Elektrike, të cilën rregull Bordi i ZRRE e ka miratuar me datë 05.06.2019. Qëllimi i Rregullës është të përcaktohen treguesit e cilësisë së shërbimit të energjisë elektrike për konsumatorët, lidhur me shërbimet e ofruara, furnizimin e pandërprerë të energjisë elektrike dhe cilësinë e tensionit.

Shërbimet e furnizimit me energji elektrike të cilat janë të përfshira në rregull janë:

- cilësia e shërbimit;
- furnizimi pandërprerë; dhe
- cilësia e tensionit.

Në Rregullën për Standardet e Cilësisë së Shërbimit të Energjisë Elektrike janë të paraqitura treguesit (indikatorët) individual dhe të përgjithshëm të cilësisë së shërbimit të energjisë elektrike, treguesit e furnizimit të pandërprerë, si dhe treguesit e cilësisë së tensionit.

Duhet theksuar se standardet e cilësisë së furnizimit dhe shërbimit me energji elektrike janë element i rëndësishëm i rregullimit të sektorit të energjisë. Këto standarde përcaktohen në mënyrë që cilësia e furnizimit dhe shërbimit me energji elektrike, si dhe cilësia e tensionit të konsumatorët të përmirësohet vazhdimisht prej ndërmarrjes së energjisë.

Edhe gjatë këtij viti raportues janë monitoruar standardet e cilësisë së furnizimit dhe shërbimit me energji elektrike sipas fushave në vijim:

- Kontinuiteti i furnizimit;
- Cilësia e tensionit; dhe
- Cilësia komerciale.

6.8.1 Kontinuiteti i furnizimit

Kontinuiteti i furnizimit është i ndërlidhur me disponueshmërinë e sistemit energjetik, përkatësisht paraqet numrin dhe kohëzgjatjen e ndërprerjeve për çdo konsumator brenda një viti.

Ndërprerjet e furnizimit me energji regjistrohen nga Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH). Bazuar në Rregullën për Standardet e Cilësisë së Shërbimit të Energjisë Elektrike, ndërprerjet e energjisë elektrike klasifikohen si ndërprerje të shkurtra dhe të gjata. Çdo ndërprerje e furnizimit me energji që zgjatë deri në 3 minuta klasifikohet si ndërprerje e shkurtër, dhe çdo ndërprerje më e gjatë se 3 minuta klasifikohet si ndërprerje e gjatë. Vlen të theksohet se sipas Rregullës në fjalë dhe standardeve ndërkombëtare, nga operatorët e sistemit regjistrohen dhe raportohen vetëm ndërprerjet e gjata. Ndërprerjet e gjata klasifikohen si të planifikuara dhe të paplanifikuara.

Kontinuiteti i furnizimit matet me anë të indekseve:

- SAIDI - Indeksi mesatar i kohëzgjatjes së ndërprerjeve në sistem;
- SAIFI - Indeksi mesatar i frekuencës së ndërprerjeve në sistem;
- ENS - Energjia e pafurnizuar; dhe

- AIT - Koha mesatare e ndërprerjes.

Gjatë vitit 2020, kontinuiteti i furnizimit me energji elektrike është monitoruar nga Rregullatori për të dy operatorët e sistemit: Operatorin e sistemit të transmetimit (OST) dhe Operatorin e sistemit të shpërndarjes (OSSH).

6.8.1.1 Indekset matëse të raportuara nga OST

Sipas Rregullës për Standardet e Cilësisë së Shërbimit të Energjisë Elektrike, indikatorët e përgjithshëm të furnizimit të cilat Operatori i Sistemit të Transmetimit duhet të regjistrojë dhe raportojë janë:

- Kohëzgjatja mesatare e ndërprerjeve (AIT - Koha Mesatare e Ndërprerjes);
- Energjia e pa furnizuar (ENS – Energjia që nuk është Furnizuar).

Kohëzgjatja mesatare e ndërprerjeve (AIT - koha mesatare e ndërprerjes) në rrjetin e transmetimit përfaqëson kohëzgjatjen kumulative të ndërprerjeve të furnizimit me energji për konsumator.

Energjia e pa furnizuar (ENS – Energjia që nuk është furnizuar) është energjia që do të ishte furnizuar nga sistemi nëse nuk do të kishte asnjë ndërprerje të furnizimit me energji.

Indekset e përgjithshme matëse të raportuara nga OST për standardet e cilësisë së furnizimit dhe shërbimit me energji elektrike për vitin 2022 janë të paraqitura më poshtë.

- AIT - për ndërprerje të planifikuara ka qenë 9 minuta ose 0.15 orë;
- AIT - për ndërprerje të paplanifikuara ka qenë 27 minuta ose 0.45 orë;
- ENS - për ndërprerje të planifikuara në sistemin e transmetimit ka qenë 0.161 GWh; dhe
- ENS - për ndërprerje të paplanifikuara në sistemin e transmetimit ka qenë 0.498 GWh.




Fig. 6.24 Indikatorët matës AIT dhe ENS për KOSTT për vitin 2022

Në figurën e mëposhtme është paraqitur indeksi matëse i raportuar nga OST për standardet e cilësisë së furnizimit dhe shërbimit me energji elektrike, respektivisht për energjinë përgjatë viteve 2015 – 2022.




Fig. 6.25 Indeksi matës ENS për OST për periudhën 2015 - 2022

Sipas të dhënave të raportuara për indeksin matës ENS, gjatë vitit 2022 ka zbritje apo përmirësim të këtij indeksi për 42.45% në krahasim me vitin 2021, respektivisht ka zbritje te ndërprerjet e planifikuara prej 51.94% si dhe te ndërprerjet paplanifikuara 38.52%.

6.8.1.2 Indekset matëse të raportuara nga OSSH

Indekset matëse të raportuara nga OSSH mbi standardet e cilësisë së furnizimit dhe shërbimit me energji elektrike për vitin 2022 janë të paraqitur më poshtë.

- SAIDI - për ndërprerje të planifikuara në sistemin e shpërndarjes ka 35.89 orë;
- SAIDI - për ndërprerje të paplanifikuara në sistemin e shpërndarjes ka qenë 39.67 orë;
- SAIFI - për ndërprerje të planifikuara në sistemin e shpërndarjes ka qenë 8.91;
- SAIFI - për ndërprerje të paplanifikuara në sistemin e shpërndarjes ka qenë 42.19;
- ENS - për ndërprerje të planifikuara në sistemin e shpërndarjes ka qenë 22.75 GWh; dhe
- ENS - për ndërprerje të paplanifikuara në sistemin e shpërndarjes ka qenë 32.84 GWh.




Fig. 6.26 Indekset matës SAIDI, SAIFI dhe ENS për OSSH për vitin 2022

Në figurat e mëposhtme janë paraqitur indekset matëse të raportuara nga OSSH për standardet e cilësisë së furnizimit dhe shërbimit me energji elektrike përgjatë viteve 2011 – 2022 për indeksin SAIDI dhe SAIFI, ndërsa për indeksin ENS janë përgjatë viteve 2015 - 2022.




Fig. 6.27 Indikatorët SAIDI, SAIFI dhe ENS për OSSH për periudhën 2011-2022, dhe 2015 - 2022

Nga të dhënat e mësipërme vërehet se disa nga indekset matëse SAIDI, SAIFI dhe ENS në vitin 2022 në përgjithësi kanë pasur përmirësim në krahasim me vitin 2021.

Sipas të dhënave të raportuara për indeksin matës SAIDI gjatë vitit 2022, vërehet se ka pasur përmirësim të këtij indeksi krahasuar me vitin 2021, që do të thotë se në vitin 2022 ne total ka rënie të ndërprerjeve për 6.52% në krahasim me vitin 2021. Gjatë analizave më detale të bëra indeksit – SAIDI, vërehet se në vitin 2022 ka rritje të ndërprerjeve të planifikuara prej 71.80% në krahasim me vitin 2021, si dhe rënie të ndërprerjeve të paplanifikuara për 33.82% në krahasim me vitin 2021.

Nga analiza e bërë indeksit matës SAIFI, vërehet se gjatë vitit 2022 ka përmirësim të këtij indeksi krahasuar me vitin 2021, që do të thotë se në vitin 2022 ne total ka rënie të ndërprerjeve për 14.03% në krahasim me vitin 2021. Vlen të theksohet se gjatë analizave më detale të bëra indeksit – SAIFI, vërehet se në vitin 2022 ka rritje të shpeshtësisë së ndërprerjeve të planifikuara për konsumator (SAIFI) për 29.52% në krahasim me vitin 2021, si dhe rënie të shpeshtësisë së ndërprerjeve të paplanifikuara për konsumator për 23.23% në krahasim me vitin 2021.

Gjatë vitit 2022 energjia e pafurnizuar (ENS) në përgjithësi ka përmirësim krahasuar me vitin 2021, e që sipas të dhënave vërehet se në vitin 2022 ka rënie për 26.4% në krahasim me vitin 2021. Gjatë

analizave më detale të bëra indeksit –ENS, vërehet se në vitin 2022 ka rënie të energjisë së pafurnizuar për ndërprerje të planifikuara për 17.96% në krahasim me vitin 2021 si dhe rënie të energjisë së pafurnizuar për ndërprerje të paplanifikuara për 31.30%, në krahasim me vitin 2021.

6.8.2 Cilësia e tensionit

Cilësia e tensionit është e ndërlidhur me aspektin teknik të sistemit të energjisë elektrike dhe krahasohet ndaj tensionit nominal, që kryesisht gjatë kësaj periudhe është monitoruar përmes regjistrimit të ankesave të konsumatorëve lidhur me cilësinë e tensionit.

Gjatë vitit 2022, numri i ankesave të parashtruara nga konsumatorët në OSSH lidhur me cilësinë e tensionit ka qenë 162 ankesa, prej të cilave janë zgjidhur 145 apo 89.51% kurse në proces të shqyrtimit janë 17 ankesa apo 10.49%.




Fig. 6.28 Ankesat e konsumatorëve për cilësi të tensionit në vitin 2022

Më poshtë është paraqitur figura me të dhënat e statusit të ankesave të zgjidhura të konsumatorëve për cilësi të tensionit në OSSH për vitin 2022.




Fig. 6.29 Statusi i ankesave të konsumatorëve të zgjidhura për vitin 2022

Pra, nga figura e mësipërme vërehet se OSSH nga 145 ankesa të zgjidhura të konsumatorëve për cilësi të tensionit, prej tyre 72 ankesa i ka aprovuar në favor të konsumatorëve apo 49.66%, ndërsa 73 i ka refuzuar, apo e shprehur në përqindje 50.34%. Nga numri i kërkesave të refuzuara, 15 prej tyre nuk

kanë rezultuar me probleme, 48 janë shqyrtuar dhe janë përfshirë në planin investiv kurse 10 për arsye se asetet janë private, konsumatorët janë udhëzuar të aplikojnë për Pëlqime elektroenergjetike.

Më poshtë në figurë janë paraqitur ankesat e konsumatorëve për cilësi të tensionit sipas viteve, ku shihet se në vitin 2017 ka pasur rritje të ankesave të konsumatorëve për cilësi të tensionit, ndërsa nga viti 2018 vërehet se kemi rënie të ankesave të konsumatorëve për cilësi të tensionit, kurse në vitin 2022 në krahasim me vitin 2021 kemi numër të njëjtë të ankesave për cilësi të tensionit.




Fig. 6.30 Ankesat për cilësi të tensionit sipas viteve

Standardet e cilësisë së tensionit janë të përcaktuara në Rregullën për Kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji, në Kodin e shpërndarjes dhe Kodin e matjes së shpërndarjes.

6.8.3 Cilësia komerciale

Cilësia komerciale përcakton efikasitetin dhe saktësinë e zgjidhjes së ankesave dhe kërkesave të konsumatorëve. Rregullimi i cilësisë komerciale merr parasysh marrëdhëniet e ndërsjella ndërmjet konsumatorëve dhe furnizuesit.

Me qëllim të analizimit të cilësisë komerciale, të dhënat e marra nga i licencuari janë paraqitur në dy kategori të cilat prekin drejtpërdrejt çështjet e konsumatorëve. Këto kategori janë:

- Kyçjet/lidhjet e reja;
- Pëlqime energjetike; dhe
- Ankesat e konsumatorëve.

6.8.3.1 Lidhjet e reja

Në standardet e cilësisë komerciale, përveç tjerash, hyjnë edhe lidhjet e reja, përmes së cilave evidentohet se sa shpejtë ndërmarrja e energjisë merr masa për realizimin e kyçjeve/lidhjeve të reja.

Gjatë vitit 2022 janë regjistruar gjithsej 28,653 kërkesa të rregullta për lidhje të reja për grupet tarifore 4, 5, 6, 7 dhe 8, ndërsa janë aprovuar 27,206 apo 94.95% kërkesa për lidhje të reja, ndërsa pjesa e

mbetur është në proces të regjistrimit. Duhet të ceket se kërkesa për lidhje të reja të bartura nga viti paraprak kanë qenë 3,855.

Nga të dhënat e KESCO-s, shihet se nga numri i përgjithshëm i kërkesave për lidhje të reja më së shumti kërkesa ka pasur nga konsumatorët shtëpiak (grupi tarifor 5 dhe 6) 24,994 apo 87.23%, pasuar nga kërkesat për lidhje të reja të grupit tarifor komercial 0.4 kV Kategoria II – grupi tarifor 4 që kanë qenë 3,438 apo 12%, ndërsa kërkesa për grupit tarifor 8 - Ndrëçimi publik kanë qenë 218 apo 0.76%.

Nga numri i përgjithshëm i regjistrimeve të aplikuesve si konsumatorë në programin e faturimit “CCP”, konsumatorë shtëpiak janë 22,062 apo 86.11%, pasuar nga grupi tarifor 4 (0.4 kV Kategoria II – komercial) me 3,310 regjistrime apo 12.92%, si dhe grupi tarifor 8 (ndrëçimi publik) me 248 regjistrime apo 0.97%.




Fig. 6.31 Lidhjet e reja sipas distrikteve për vitin 2022

Nga diagrami i mësipërm vërehet se për vitin 2022 nga numri i përgjithshëm i kërkesave për lidhje të reja, më së shumti kërkesa ka pasur në distriktin e Prishtinës prej 10,904 apo 38.06%, pasuar nga distrikti i Ferizajt prej 4,496 apo 15.69 %, ndërsa më së paku kërkesa për lidhje të reja janë regjistruar në distriktin e Gjakovës prej 2,316 apo 8.08%. Gjithashtu, duhet theksuar se sa i përket regjistrimeve të kërkesave në programin e faturimit nga numri i përgjithshëm, më së shumti regjistrime ka qenë në distriktin e Prishtinës prej 8,877 apo 34.65%, pasuar nga distrikti i Ferizajt prej 3,909 apo 15.26%, ndërsa më së paku regjistrime janë evidentuar në distriktin e Gjakovës prej 2,170 apo 8.47 %.




Fig. 6.32 Lidhjet e reja sipas viteve

Nga diagrami i mësipërm vërehet se gjatë vitit 2022 ka pasur 0.95% më shumë kërkesa për lidhje të reja se sa në vitin 2021, dhe 15.66% më pak regjistrime të konsumatorëve se sa në vitin 2021.

6.8.3.2 Pëlqimet Elektroenergjetike

Nga të dhënat e prezantuara shihet se gjatë vitit 2022 në KEDS janë parashtruar 2,888 kërkesa për Pëlqime Elektroenergjetike, ndërsa të bartura nga viti 2021 kanë qenë 83 pëlqime.

Tab. 6.26 Pëlqimet Elektroenergjetike për vitin 2022

Distriktet	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Gjithsej
Prishtina	48	60	91	52	86	61	66	94	87	82	67	84	878
Mitrovica	13	20	22	20	17	13	14	17	21	13	16	13	199
Peja	27	27	50	34	24	42	30	34	43	25	33	49	418
Gjakova	17	10	9	32	18	29	21	17	44	23	24	27	271
Prizreni	14	6	21	20	23	15	19	29	24	25	17	22	235
Ferizaj	50	58	74	48	61	35	44	49	70	58	32	69	648
Gjilani	16	14	19	25	17	23	26	19	15	24	19	22	239
Gjithsej	185	195	286	231	246	218	220	259	304	250	208	286	2,888

Nga tabela e mësipërme vërehet se nga numri i përgjithshëm i kërkesave për Pëlqim Elektroenergjetik për vitin 2022, më së shumti kërkesa janë regjistruar në distriktin e Prishtinës dhe atë 878 apo shprehur në përqindje 30.40%, pasuar nga distrikti i Ferizajt prej 648 apo 22.44%, ndërsa më së paku kërkesa ka pasur në distriktin e Mitrovicës prej 199 apo 6.89 %.

Tab. 6.27 Pëlqimet Elektroenergjetike sipas distrikteve për vitin 2022

Distriktet	Kërkesa për PEE 2022	Të shqyrtuara - PEE	Të shqyrtuara - Informatë	Të shqyrtuara - Përgjigje	Dërguar departamentev e tjera	Në proces
Prishtina	878	612	130	48	99	15
Mitrovica	199	147	33	14	13	2
Peja	418	299	63	21	39	5
Gjakova	271	163	59	16	25	13
Prizreni	235	181	34	10	19	5
Ferizaj	648	432	136	23	45	23
Gjilani	239	152	56	24	9	6
Gjithsej	2,888	1,986	511	156	249	69

Nga tabela e mësipërme vërehet se nga 2,888 kërkesa të aplikuesve për Pëlqim Elektroenergjetik për vitin 2022 dhe 83 të bartura nga viti 2021, janë shqyrtuar dhe lëshuar Pëlqimi Elektroenergjetik 1,986 kërkesa, 511 kërkesa janë shqyrtuar dhe është dhënë palëve Informatë lidhur me kërkesën e tyre për Pëlqim Elektroenergjetik, 156 kërkesa janë shqyrtuar dhe është dhënë palëve përgjigje ndërsa sipas të dhënave të KEDS-it 249 kërkesa tjera gjithashtu janë shqyrtuar, por që sipas departamentit të Pëlqimeve Elektroenergjetike në kuadër të KEDS-it është konstatuar se këtyre kërkesave nuk duhet t’iu lëshohet Pëlqimi Elektroenergjetik, por që këto kërkesa janë deleguar të departamentet tjera, pjesa e mbetur prej kërkesave janë në proces të shqyrtimit.

Më poshtë është paraqitur diagrami i kërkesave për Pëlqime Elektroenergjetike për periudhën sipas viteve 2014 – 2022, dhe nga diagrami shihet qartë se për çdo vjet ka pasur rritje të kërkesave për Pëlqime Elektroenergjetike nga aplikuesit për kyçje, e qe krahasuar me vitin 2021 kemi një rritje prej 946 aplikacioneve apo shprehur ne përqindje 48.71%.




Fig. 6.33 Kërkesat për pëlqimet eektroenergjetike për periudhën 2014 – 2022

6.8.3.3 Ankesat e konsumatorëve te furnizuesi - KESCO

Sipas të dhënave të raportuara të KESCO-s gjatë vitit 2022 numri i përgjithshëm i ankesave të konsumatorëve të regjistruar në Departamentin për Konsumator në KESCO është 8,425 dhe të bartura nga viti i kaluar kanë qenë 2,190 ankesa, ndërsa të zgjidhura/përfunduara janë 6,958.

Më poshtë është paraqitur grafiku i ankesave të konsumatorëve të regjistruara dhe të zgjidhura për vitin 2022 sipas distrikteve.




Fig. 6.34 Ankesat dhe numri i konsumatorëve sipas distrikteve, 2022

Nga figura e mësipërme shihet se përqindja më e lartë e ankesave të konsumatorëve të regjistruar në KESCO gjatë vitit 2022 është në distriktin e Prishtinës 49.99%, pasuar nga distrikti i Ferizajt me 13.55%, ndërsa përqindja më e ulët është në distriktin e Gjakovës prej 4.97%. Duhet theksuar se numri më i madh i ankesave në distriktin e Prishtinës është kryesisht se Distrikti i Prishtinës ka edhe numrin më të madh të konsumatorëve në Kosovë. Gjithashtu nga figura e mësipërme shihet se përqindja më e lartë e ankesave të konsumatorëve të zgjidhura nga Departamenti i Konsumatorëve në KESCO në krahasim me numrin e përgjithshëm të ankesave të zgjidhura në nivel vendi është në distriktin e Prishtinës prej 50.22%, pasuar nga distrikti i Ferizajt prej 14.11%, ndërsa më e ulëta është në distriktin e Gjakovës prej 4.73%.

Më poshtë është paraqitur raporti i ankesave të konsumatorëve të parashtruara në KESCO me numrin e faturave/konsumatorëve sipas muajve.

Tab. 6.28 Raporti i ankesave dhe numrit të konsumatorëve sipas muajve për vitin 2022

Muaji	Ankesa	Numri i faturave	Raporti ankesa/konsumator
Janar	653	656,514	0.10%
Shkurt	876	658,341	0.13%
Mars	1,006	660,464	0.15%
Prill	693	662,194	0.10%
Maj	550	663,910	0.08%
Qershor	496	665,411	0.07%
Korrik	520	666,704	0.08%
Gusht	660	668,597	0.10%
Shtator	666	671,148	0.10%
Tetor	573	672,538	0.09%
Nëntor	592	674,867	0.09%
Dhjetor	1,140	678,816	0.17%
Gjithsej	8,425	7,999,504	0.11%

Nga të dhënat e raportuara nga furnizuesi KESCO shihet se numri i ankesave të regjistruara gjatë vitit 2022 është 8,425 e që paraqet 1.24% të numrit total të konsumatorëve, gjegjësisht 0.11% ndaj numrit të përgjithshëm të faturave vjetore.

Në figurën e mëposhtme është paraqitur numri i ankesave të regjistruara dhe të përfunduara sipas natyrës së ankesave për vitin 2022.




Fig. 6.35 Ankesat e konsumatorëve sipas natyrës për vitin 2022

Më poshtë janë paraqitur përshkrimet e natyrës së ankesave të konsumatorëve të parashtruara te Furnizuesi - KESCO:

B1 - Pagesë e pa regjistruar – kjo natyrë e ankesave ka të bëjë nëse konsumatori vë re se pagesa e bërë nga ai/ajo, nuk është regjistruar në llogarinë e tij (shifrën e tij), atëherë konsumatori duhet të paraqitet në KESCO, dhe të bëjë ankesë për pagesë të paregjistruar, duke bashkangjitur dëftesë-pagesën e tij dhe dëshmi të tjera.

B2 - Bilanci fillestar gabim - Kjo natyrë e ankesave ka të bëjë kur konsumatori ka vërejtur se gjatë bartjes së të dhënave fillestare është bërë gabim, dhe si të tillë kërkon që të përmirësohet bilanci fillestar.

B3 - Mosmarrja e faturave - Kjo natyrë e ankesave ka të bëjë me atë se faturat e energjisë elektrike nuk vijnë me rregull apo nuk vijnë fare, atëherë konsumatori bazuar në këtë konsumatori duhet të paraqet këtë natyrë të ankesave në KESCO në mënyrë që kjo mos të ndodhë në të ardhmen.

B4 – Mbilimiti - Kjo natyrë e ankesave ka të bëjë me ankesën e konsumatorit se është faturuar me mbi limit për shkak të gabimeve të leximit apo faturimit.

B5 - Ndryshim i paushallit - Kjo natyrë e ankesave ka të bëjë me atë se në rastet kur një kohë konsumatori ka qenë duke u faturuar paushall/pa matje, dhe se tani i është vendosur njehsori elektrik, dhe konsumatori dëshiron të faturohet sipas matjes që i regjistrohen në njehsor.

B6 - Lexim jo korrekt - Kjo natyrë e ankesave ka të bëjë me atë se konsumatorit nuk i përputhet shpenzimi i energjisë elektrike (kWh) i lexuar me shpenzimin e energjisë elektrike të faturuar, atëherë konsumatori duhet të parashtrorë ankesë ndaj kësaj natyre.

B7 - Lexim jo i rregullt - Kjo natyrë e ankesave ka të bëjë me atë se njehsori elektrik që regjistron energjinë e shpenzuar nuk është duke u lexuar me rregull, muaj për muaj, dhe rrjedhimisht kemi grumbullim të shpenzimit të energjisë elektrike vetëm në një faturë.

B8 - Njehsori jo i saktë - Kjo natyrë e ankesave ka të bëjë me atë nëse konsumatori dyshon se njehsori bën matje jo të saktë, atëherë duhet të paraqitet në KESCO dhe të bëjë ankesë për mos matje të saktë të pikës matëse.

B9 - Kërkesa për shlyerje të borxhit - Kjo natyrë e ankesave ka të bëjë me atë se nëse një konsumator ka privatizuar një ndërmarrje dhe në transaksionet e ndërmarrjes së privatizuar është një borxh që i takon ndërmarrjes së vjetër, atëherë duhet të kërkohet të shlyhet ky borxh dhe të ndërrohet emri, atëherë në këto raste konsumatori duhet të sjell të gjitha dokumentet e procesit të privatizimit dhe të dhënat e ndërmarrjes, në mënyrë që të procedohet me ankesë.

Sipas një vendimi të gjykatës, KESCO sh.a. është i obliguar që të bëjë shlyerjen e një borxhi në transaksionet e konsumatorit, atëherë konsumatori duhet të paraqitet në KESCO me të gjithë dokumentacionin përkatës.

Në rastet kur konsumatori ka pronë, që ka qenë e uzurpuar nga persona të ndryshëm dhe se kemi borxh të grumbulluar nga personat tjerë, atëherë konsumatori duhet të paraqitet në KESCO. dhe me vete të sjell dokumentet e lëshuara nga Agjencioni Kosovar i Pronës, i cili dëshmon se prona ka qenë e uzurpuar, atëherë bazuar në dokumentet e siguruara konsumatori kërkon që të shlyhet borxhi i kontestuar, por që natyrisht borxhi i pakontestuar duhet të paguhet.

B10 - Shkyçja pa njoftim - Kjo natyrë e ankesave ka të bëjë me atë se nëse konsumatori vlerëson se i ka ndodhur një shkyçje nga rrjeti elektrik pa njoftim.

B11 - Të tjera – kjo natyrë e ankesave ka të bëjë me atë se nëse asnjëra nga pikat e mësipërme nuk i përshatet konsumatorit, atëherë konsumatori duhet të shkruaj me fjalë ankesën e tij.

B12 – Shfrytëzim i paautorizuar i energjisë elektrike (Rikthimi i humbjeve) – Kjo natyrë e ankesave të konsumatorëve ka të bëjë me ankesat të cilat ndërlidhen me shfrytëzimin e paautorizuar të energjisë elektrike, si shfrytëzimi i pa kontraktuar i energjisë elektrike, dhe vjedhja e energjisë elektrike.

Nga të dhënat e raportuara nga KESCO për vitin 2022, vërehet se nga numri i përgjithshëm i ankesave të konsumatorëve më së shumti ankesa ka pasur lidhur me faturat me mbi limit për shkak të gabimeve të leximit apo faturimit prej 2,738 apo shprehur në përqindje prej 32.5%, ankesat lidhur me lexime jo korrekte prej 1,216 apo shprehur në përqindje prej 14.43%, pasuar nga ankesat lidhur me pagesat e pa regjistruara, ndërsa më së paku ankesa ka pasur lidhur me ndryshimin e paushallit dhe atë vetëm 2 ankesa apo 0.02%.

Bazuar ne te dhënat e raportuara nga KESCO per ankesat e konsumatorëve vërehet se ka rritje të numrit të ankesave në vitin 2022, e kjo rritje ka të bëjë gjithsisht me faturat me mbi limit për shkak të gabimeve të leximit apo faturimit si dhe gabimet në lexim në pikën matëse (lexim jo korrekt dhe lexim jo i rregullt). Nga të dhënat e raportuara vërehet se në vitin 2022 kemi një rritje të vogël të ankesave lidhur me gabimet në lexim në pikën matëse (lexim jo korrekt dhe lexim jo i rregullt),. Në përgjithësi duhet theksuar se numri i ankesave të konsumatorëve lidhur me gabimet në lexim të pikës matëse është në rënie e sipër dhe kjo fal mënyrës së re të leximit të pikës matëse me anë të pajisjes së dorës (ang. "Hand Held Unit"), e cila ka përmirësuar dukshëm leximin e pikave matëse dhe ka zvogëluar mundësinë e gabimeve gjatë leximit të pikës matëse, ngase leximi dhe faturimi bëhet në të njëjtën kohë.

Më poshtë është paraqitur figura me të dhënat e ankesave të zgjidhura nga KESCO për vitin 2022, apo më saktësisht statusi i ankesave të zgjidhura.




Fig. 6.36 Statusi i ankesave të konsumatorëve të zgjidhura për vitin 2022

Nga figura e mësipërme vërehet se KESCO nga 6,958 ankesa të zgjidhura të konsumatorëve, prej tyre 3,342 ankesa i ka aprovuar në favor të konsumatorëve apo 48.03%, ndërsa 3,616 i ka refuzuar, apo e shprehur në përqindje 51.97%.

Më poshtë është paraqitur diagrami me raportin e ankesave të paraqitura si dhe të zgjidhura tek furnizuesi KESCO sipas viteve 2014-2022.




Fig. 6.37 Ankesat e konsumatorëve në KESCO sipas viteve

7 SEKTORI I ENERGJISË TERMIKE

Sektori i energjisë termike në Kosovë përbëhet nga katër sisteme: NQ Termokos – Prishtinë, NQ Gjakova – Gjakovë, NQ Termomit – Mitrovicë, dhe në Zveçan. Ky sektor ka një shtrirje mjaft të kufizuar në shkallë vendore, që plotëson afërsisht 3 - 5% të kërkesës së përgjithshme për ngrohje në Kosovë.

7.1 Karakteristikat teknike të sistemeve të energjisë termike

Sektori i energjisë termike në Kosovë përbëhet nga 4 sisteme të energjisë termike (ngrohjes qendrore) me një kapacitet të instaluar prodhues i cili vlerësohet të jetë rreth 289 MW_{TH}. Ngrohtorja Termomit, Mitrovicë dhe e Zveçanit, për shkak të rrethanave të njohura, nuk i përgjigjen kërkesave për licencim / rregullim dhe monitorim nga ZRRE-ja, kështu që pamundësohet sigurimi i të dhënave përkatëse të azhurnuara; për këtë arsye në vijim paraqiten të dhëna të detajuara për NQ Termokos dhe NQ Gjakova.

7.1.1 Impiantet e prodhimit të energjisë termike

Impiantet për prodhimin e energjisë termike të NQ Termokos përbëhen nga ngrohtorja kryesore me kapacitet të përgjithshëm të instaluar prej 120 MW_{TH}, dhe ngrohtorja ndihmëse në Qendrën klinike universitare me kapacitet prej 14 MW_{TH}. Me kyçjen e stacionit të ekstraktimit të energjisë termike në njësitë B1 dhe B2 të TC Kosova B, këtij kapaciteti i është shtuar edhe kapaciteti i instaluar i kogjenerimit prej 140 MW_{TH}. Duhet theksuar se kaldajat me mazut në ngrohtoren e NQ Termokos nuk janë dekomisionuar por ato shërbejnë si kapacitet rezervë për tu aktivizuar në rastet e ndonjë avarie eventuale në njësitë e TC Kosova B.

Ngrohtorja e re me biomazë e qytetit Gjakova është e pajisur me dy njësi për prodhimin vetëm të energjisë termike me kapacitet të instaluar 2 x 5.5 MW_{TH} gjegjësisht 11 MW_{TH}, dhe njësinë e kogjenerimit me kapacitet të prodhimit të energjisë termike 4 MW_{TH} dhe kapacitet të prodhimit të energjisë elektrike 1.12 MW_{EL}. Pra Ngrohtorja e re me biomazë ka një kapacitet termik të përgjithshëm të instaluar të prodhimit të energjisë termike prej 15 MW_{TH}.

7.1.2 Sistemet e Shpërndarjes të Energjisë Termike

Sistemet e shpërndarjes së energjisë termike në Kosovë përbëhen nga rrjeti primarë i shpërndarjes që shtrihet deri në pikën e furnizimit në nënstacione, dhe nga rrjeti sekondar i cili shtrihet nga pika e furnizimit në nënstacione gjer tek shfrytëzuesit përfundimtarë.

Rrjeti primarë i shpërndarjes i NQ Termokosit ka një gjatësi traseje prej 47.8 km respektivisht gjatësi tubacioni prej 95.6 km. Pjesë integrale e rrjetit të shpërndarjes është edhe stacioni i pompimit dhe shkëmbyesve të nxehtësisë i cili gjendet në Bregun e Diellit dhe 598 nënstacione aktive të cilat janë pika ndarëse ndërmjet rrjetit primar dhe sekondar. Përpos rrjetit ekzistues të shpërndarjes, në vitin 2014 është ndërtuar edhe rrjeti i transportimit të energjisë termike TC Kosova B – NQ Termokos, në gjatësi prej rreth 10.5 km.

Rrjeti primar i shpërndarjes i NQ Gjakova shtrihet në gjatësi prej rreth 20.5 km trase respektivisht tubacion në gjatësi 41 km. Pjesë përbërëse e këtij rrjeti janë edhe rreth 220 nënstacione aktive të cilat janë pika ndarëse ndërmjet rrjetit primar dhe sekondar.

Një përmbledhje e karakteristikave teknike të sistemeve të ngrohjes qendrore të NQ Termokos dhe NQ Gjakova, paraqitet në tabelën më poshtë.

Tab. 7.1 Të dhënat teknike të sistemeve të ngrohjes qendrore

Kompania (Qyteti)	Kapaciteti i instaluar [MW _{TH}]	Kapaciteti operacional [MW _{TH}]	Rrjeti i energjisë termike	
			Gjatësia e rrjetit (trasesë) [km]	Nr. i nënstacioneve
	2 x 58 = 116	2 x 49.3 = 98.6	Rrjeti i shpërnd.	
TERMOKOS (Prishtinë)	2 x 7 = 14	2 x 6.3 = 12.6	47.8	605
	1 x 4 = 4	3.6	Rrjeti i Transp.	(aktive-598)
	[Kogjenerimi] 2 x 70 = 140	2 x 68.7 = 137.4	10.5	
Nën-total	274.0	252.2	58.3	605
NQ GJAKOVA (Gjakovë)	2 x 5.5 = 11	2 x 5.5 = 11	Rrjeti i shpërnd.	353
	[kogjenerimi*] 1 x 4 = 4	[kogjenerimi*] 1 x 4 = 4	20.5	(aktive-220)
Nën-total	15.0	15.0	20.5	353
Total	289.0	267.2	78.8	958 (Aktive - 818)

* Njësia e kogjenerimit e NQ Gjakova ka kapacitetin termik 4MW_{TH} dhe kapacitetin elektrik 1.12 MW_{EL}

7.2 Zhvillimet kryesore në sektorin e energjisë termike

Duke ju referuar zhvillimit të sektorit të energjisë termike në përgjithësi, është me rëndësi të theksohet se, gjatë vitit 2022 ka vazhduar përgatitja e Studimit të fizibilitetit për sistemet e reja të energjisë termike (ngrohjes qendrore) në tetë qytete të Kosovës. Ky studim zhvillohet në kuadër të platformës WBIF, ku institucion udhëheqës financiar është Banka Evropiane për Investim, analizon arsyeshmërinë ekonomiko-financiare dhe teknike të krijimit të sistemeve të energjisë termike në 8 qytetet e Kosovës – Pejë, Prizren, Gjilan, Ferizaj, Mitrovicë, Drenas, Obiliq dhe Zvečan.

Ky projekt do të ketë ndikim pozitiv në stabilitetin energjetik të Kosovës në radhë të parë duke reduktuar dukshëm përdorimin e energjisë elektrike për ngrohje, si dhe do të ketë efekt pozitiv në ruajtjen e ambientit duke kontribuar në arritjen e caqeve të efiçencës së energjisë dhe burimeve të ripërtëritshme.

7.2.1 Zhvillimet në NQ Termokos

Me qëllim të plotësimit të kërkesave në rritje për kycje në sistemin e NQ Termokos, gjatë vitit 2022 janë zhvilluar gjegjësisht iniciuar një numër i projekteve rehabilituese dhe të zgjerimit, kryesisht në rrjetin e shpërndarjes, që janë në faza të ndryshme të zhvillimit.

Gjatë këtij viti ka vazhduar realizimi i projektit për rehabilitim dhe zgjerim të rrjetit të NQ Termokos; ky projekt që udhëhiqet nga Banka Gjermane për Zhvillim (KfW) dhe përmban këto komponente kryesore:

- Rehabilitimi i rrjetit të shpërndarjes së NQ Termokos: Rehabilitim i rrjetit (zëvendësimi i tubacioneve) në gjatësi prej 6.5 km trase, në lagjet Qendër, Ulpianë dhe Kodra e Diellit;

- Zgjerimi i rrjetit me segmente të reja në gjatësi të përgjithshme 16.15 km trase: Mati 1 7.15 km, Qendra lindje 3 km, Arbëria 3 km, dhe dendësim i rrjetit në pjesë të ndryshme të qytetit 3 km trase;
- Rehabilitimi dhe modernizimi i 235 nënstacioneve ekzistuese në lagjet Ulpiana, Dardania, Kodra e Diellit dhe Qendër;
- Instalimi i 320 nënstacioneve të reja pothuajse në të gjitha lagjet e qytetit – aty ku planifikohet zgjerimi dhe dendësimi i rrjetit; duhet të theksohet se numri më i madh i nënstacioneve të reja (141) janë planifikuar në lagjen Mati 1.
- Instalimi i 2 rezervuarëve për deponim të ngrohjes me kapacitet 800 m³ (2x400 m³), si dhe pajisjeve për trajtimin kimik të ujit.
- Përmirësimi i sistemit të mbajtjes së presionit në rrjetin primarë përfshirë edhe instalimin e pompave të reja, dhe sistemin e kontrollit në distancë - SCADA

Ky projekt, që është fazën përfundimtare të realizimit, financohet në pjesën më madhe si donacion nga Qeveria Gjermane në vlerë 10 mil € dhe Qeveria e Luksemburgut 2.3 mil €, fonde që do të ndahen dhe menaxhohen përmes KfW, si dhe pjesa tjetër e kostos së investimit do të mbulohet me vetëfinancim nga Termokosi.



Fig. 7.1 Pamje nga punimet në shtrirjen e rrjetit dhe rehabilitimin e nënstacioneve

Me finalizimin e këtij projekti pritet të arrihet reduktim i humbjeve të rrjetit të shpërndarjes së energjisë termike dhe të përmirësohet kualiteti i ngrohjes në disa pjesë ku janë më problematike; po ashtu zgjerimi i rrjetit do ndikoj në rritjen e numrit të konsumatorëve që përfitojnë furnizim me energji termike (ngrohje qendrore), respektivisht shtimin e sipërfaqes për ngrohje të hapsirave që mbulohet nga shërbimi i furnizimit me ngrohje qendrore nga Termokosi.

Në gjysmën e dytë të vitit 2022 ka filluar realizimi i projektit të MCC - SHBA (“Millenium Challenge Corporation”) ‘Matja e ngrohjes qendrore’ në kuadër të Programit ‘Spektri i Energjisë së Besueshme’. Me instalimin e matësve individual të ngrohjes në nivel apartamenti do të lehtësohet faturimi i bazuar në konsumin e matur, dhe duke krijuar një sistem modern të faturimit për Termokosi synohet të arrihet shfrytëzimi efikas i energjisë termike. Përndryshe projekti ‘Matja e Ngrohjes Qendrore’ në vlerë të paraparë prej 10.9 mil \$, si donacion nga MCC – SHBA, do të përfshij rreth 300 ndërtesa të banimit kolektiv gjegjësisht rreth 17,500 konsumatorë shtëpiak dhe komercial; komponentët kryesorë të projektit janë:

- Instalimi i 54,000 alokatorëve të nxehtësisë dhe 5,100 matësve individual të energjisë termike;
- Instalimin e 85,500 valvulave termostatike në radiatorët e konsumatorëve (apartamenteve dhe njësive komerciale), si dhe instalimin e pompave qarkulluese në një numër të kufizuar të nënstacioneve termike;
- Zhvillimin e softverit për faturim dhe lexim të konsumit të energjisë termike;
- Asistencë në përmirësimin e shërbimeve të faturimit bazuar në konsumin e matur.

Realizimi i tërësishëm i këtij projekti do të mundësoj matjen e konsumit dhe implementimin e faturimit bazuar në matjen e regjistruar të konsumit, me çka do të arrihet kursimi i energjisë termike që do të liroj kapacitetet për zgjerim të bazës së konsumatorëve, respektivisht do mundësoj kyçjen në sistemin e ngrohjes të një numri të konsiderueshëm të konsumatorëve që aktualisht shfrytëzojnë energjinë elektrike për ngrohje të hapësirave.

Viti 2022 ka shënuar iniciimin e dy projekteve të rëndësishme për rritjen e kapaciteteve termike të NQ Termokos:

- **Projekti “Solar4Kosova – Solar for district heating”**: Projekt i iniciuar në kuadër të bashkëpunimit të Qeverisë sonë me KfW dhe BERZH, për prodhimin e energjisë termike nga energjia diellore, në vlerë të parashikuar të investimit prej rreth 80 mil. €. Marrëveshja për grantin dhe huanë e nënshkruar në dhjetor 2022, parasheh financimin e kombinuar të këtij projekti: 31.6 mil€ grant nga Qeveria Gjermane përmes KfW, 21.5 mil € grant nga EU-ja, dhe 23.2 mil € hua nga BERZH.
- **Projekti për dyfishimin e kapacitetit të ekstraktimit të energjisë termike nga koegjenerimi në TC Kosova B**: Ky projekt është në fazën fillestare studimore në kuadër të IPA-s mbështetur nga EU dhe EIB (Banka Investive Evropiane). Në qershor 2022 Qeveria e Kosovës ka nënshkruar marrëveshjen me EIB për grantin financiarë në vlerë 1.5 mil € për hartimin e studimit për këtë projekt. Ky projekt që parashihet të ketë vlerën e investimit prej rreth 25 mil €, do të kontribuoj në zgjerimin e mëtejshëm të sistemit të ngrohjes qendrore të Termokosit me ndikim pozitiv në ruajtjen e ambientit dhe rritjen e kualitetit të jetës së qytetarëve të Prishtinës.

Lidhur me projektet zhvillimore duhet theksuar këto projekte janë të përfshira në Planin Zhvillimor dhjetë vjeçar të NQ Termokos, i miratuar nga Bordi ZRRE-së. Plani Zhvillimor paraqet masat efikase që do të merren për të garantuar përshtatshmërinë e sistemit dhe për të siguruar furnizim sa më të mirë me energji termike (ngrohje qendrore), duke përfshirë planifikimet për projektet rehabilituese dhe të zgjerimit të infrastrukturës së sistemit të ngrohjes qendrore në komunën e Prishtinës, gjatë dhjetë vjetëve të ardhshme.

7.2.2 Zhvillimet në NQ Gjakova

Pas përfundimit të projektit kryesor zhvillimorë të NQ Gjakovës – Ngrohtorja e re me biomasë që përfshinë edhe njësinë e ko-gjenerimit të energjisë elektrike dhe asaj termike – gjatë vitit 2022 ka vazhduar realizimi i projektit “Përmirësimi i performancës së sistemit të ngrohjes qendrore të Gjakovës”; ky projekt përkrahet financiarisht nga Sekretariati Shtetërorë për Qështje Ekonomike i Zvicrës (SECO), në vlerë 5.5 mil € dhe nga Komuna e Gjakovës në vlerë 500 mijë €.

Ky projekt, që është fazën përfundimtare, ka përfshirë rehabilitimin e tërësishëm të sistemit të NQ Gjakovës dhe rritjen e efijencës së energjisë, si dhe ngritjen e performancës operative dhe financiare të ndërmarrjes; në vijim përshkruhen shkurtimisht 4 komponente kryesore:

- Zhvillimin korporativ të ndërmarrjes – ngrohtores së qytetit Gjakova;
- Rehabilitimin e rrjetit të shpërndarjes dhe nënstacioneve: rehabilitimi i rreth 9.7 km tubacion ku në pjesën më madhe është zëvendësimi i 6.2 km gypa të vjetër të çelikut; rehabilitimi i 342 nënstacioneve termike që përshinë instalimin e pajisjeve (instrumenteve) kontrolluese të presionit/temperaturës/rrjedhjes dhe pajisjeve matëse;
- Rehabilitimin e rrjetit të brendshëm (rrjetit sekondarë) dhe 14 nënstacione termike të Spitalit rajonal të Gjakovës; dhe
- Kyçjen në sistemin e ngrohjes qendrore të 13 objekteve të reja – kryesisht publike, ku përfshihet edhe instalimi i nënstacioneve të reja.

7.3 Performanca e ndërmarrjeve të energjisë termike

Në sezonin 2021/2022 NQ Termokos ka vijuar me trendin pozitiv të prodhimit dhe furnizimit të qëndrueshëm me energji termike, duke ofruar furnizim të pandërprerë 24 h, që kryesisht është rrjedhojë e prodhimit të mjaftueshëm nga impiantet e kogjenerimit në TC Kosova B, por edhe realizimit të projekteve rehabilituese të rrjetit dhe nënstacioneve termike.

Sa i përket NQ Gjakovës duhet përmendur se sezoni 2021/2022 ka qenë sezoni i parë i operimit komercial të Ndrohtores së re me biomasë; duhet theksuar se NQ Gjakova ka aktivizuar vetëm njësitë për prodhimin vetëm të energjisë termike, dhe se prodhimi dhe furnizimi me ngrohje ka filluar në nëntor 2021 dhe ka përfunduar në fillim të marsit 2022. Arsyet e fillimit me vonesë të sezonit kanë qenë të ndërlidhura me mos-përmbushjes me kohë të kërkesave ligjore për lëshim të lejes mjedisore - konkretisht është vonuar kontraktimi i kompanisë së licencuar për matjen e emetimeve. Kjo mandej ka shkaktuar vonesat në lëshimin e lejes mjedisore e po ashtu edhe licencës së operimit.

7.3.1 Prodhimi, furnizimi dhe humbjet në sistem

NQ Termokos

- Prodhimi i energjisë termike

NQ Termokos e ka bazuar prodhimin e energjisë termike nga impiantet e kogjenerimit në TC Kosova B. Në fakt në sezonin 2021/2022 sasia dërmuese e prodhimit të energjisë termike ka qenë nga impiantet e kogjenerimit në TC Kosova B, ndërsa kaldajat me mazut janë përdorur vetëm një ditë, kur për shkak të avarive të dy blloqeve në TC Kosova B është ndërprerë furnizimi me energji termike nga impiantet e ko-gjenerimit; prodhimi bruto i regjistruar i energjisë termike nga kaldajat me mazut ka qenë 96 MWh_{TH}.

Sasia e energjisë termike e ekstraktuar nga ko-gjenerimi në sezonin 2021/2022 ka qenë **294,373 MWh_{TH}**, që është për 5,720 MWh_{TH} ose 2% më e madhe se sasia e energjisë termike në sezonin e kaluar (288,653 MWh_{TH}). Ndërsa sasia e pranuar energjisë termike në stacionin e shkëmbimit të nxehtësisë në NQ Termokos ka qenë **288,485 MWh_{TH}**, që gjithashtu paraqet një rritje prej rreth 2% në krahasim me sezonin e kaluar (282,881 MWh_{TH}).

Të dhënat e përmbledhura të prodhimit të energjisë termike nga kogjenerimi, janë paraqitur në tabelën vijuese:

Tab. 7.2 Prodhimi i energjisë termike nga kogjenerimi

Energjia Termike nga Kogjenerimi – NQ Termokos, Sezoni 2021/2022			
Muaji	Njësia	En.term. e ekstraktuar (matur në TC Kosova B)/Prodhimi Bruto	En.term. e pranuar (matur në NQ Termokos)/Prodhimi neto
Tetor 2021	MWh _{TH}	24,764	24,269
Nëntor 2021	MWh _{TH}	37,423	36,675
Dhjetor 2021	MWh _{TH}	49,979	48,979
Janar 2022	MWh _{TH}	56,732	55,597
Shkurt 2022	MWh _{TH}	46,678	45,744
Mars 2022	MWh _{TH}	50,177	49,173
Prill 2022	MWh _{TH}	28,620	28,048
Gjithsej	MWh_{TH}	294,373	288,485

- Furnizimi me energji termike

Në sezonin 2021/2022 NQ Termokos gjithashtu ka vazhduar me furnizim të mjaftueshëm sasior dhe kualitativ të energjisë termike, që kryesisht është rrjedhojë e përmirësimit në vazhdimësi të prodhimit të energjisë termike, si dhe mirëmbajtjes, riparimeve dhe rehabilitimit të rrjetit.

Furnizimi i konsumatorëve me energji termike (ngrohje qendrore), në këtë sezonë vlerësohet të jetë **256,616 MWh_{TH}**, që paraqet rritje prej **3,406 MWh_{TH}** ose 1.3 % në krahasim me sezonin paraprak 2020/2021 (253,210 MWh_{TH}). Ky furnizim i realizuar është mjaft i kënaqshëm dhe ka përmbushur planifikimet dhe objektivat për një furnizim të mjaftueshëm dhe cilësor.

- Humbjet në sistem

Sistemi i energjisë termike i NQ Termokos ka specifikat e veta sa i përket humbjeve në sistem, për shkak të integritetit të energjisë termike nga kogjenerimi. Pra, humbjet në rrjet përfshijnë dy komponentë: humbjet në rrjetin e transportit TC Kosova B – NQ Termokos dhe humbjet në rrjetin primar të shpërndarjes.

Humbjet në rrjetin e transportimit të energjisë termike TC Kosova B – NQ Termokos, në gjatësi prej 10.5km, janë përcaktuar nga matjet që janë kryer në stacionin e ekstraktimit të energjisë termike në TC Kosova B dhe në stacionin e pranimit të energjisë termike në NQ Termokos. Nga matjet që janë kryer në periudhën tetor 2021 – prill 2022 rezulton se humbjet sasiore në këtë periudhë janë **5,888 MWh_{TH}** gjegjësisht **2%**; niveli humbjeve në rrjetin e transportimit është i njëjtë me sezonin e kaluar. Në tabelën vijuese janë dhënë detaje për humbjet në rrjetin e transportimit të energjisë termike.

Tab. 7.3 Energjia termike dhe humbjet e në rrjetin e transmetimit TC Kosova B – NQ Termokos– sezoni 2021/2022

Humbjet në rrjetin e trans. En. Term. Sezoni 2020-2021	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Total
Energjia termike e ekstraktuar - matur në TC Kosova B [MWh]	24,764	37,423	49,979	56,732	46,678	50,177	28,620	294,373
Energjia termike e pranuar - matur në NQ Termokos [MWh]	24,269	36,675	48,979	55,597	45,744	49,173	28,048	288,485
Humbjet në sasi të energjisë [MWh]	495	748	1,000	1,135	934	1,004	572	5,888
Humbjet në [%]	2.00%	2.00%	2.00%	2.00%	2.00%	2.00%	2.00%	2.00%

Humbjet në rrjetin primar të shpërndarjes së energjisë termike normalisht përcaktohen nga matjet e energjisë termike në hyrje të rrjetit të shpërndarjes dhe nga furnizimi i energjisë termike në nënstacionet e konsumatorëve. Mirëpo, në mungesë të matjes së tërësishme të furnizimit të energjisë termike (në nënstacione), për llogaritjen e furnizimit janë bërë disa përafrime duke përdorur në radhë të parë parametrat si: kërkesën specifike për kapacitetin ngrohës (W/m^2) dhe orë e ngarkesës së plotë respektivisht konsumin specifik (kWh/m^2). Vlera e përlllogaritur e konsumit është **256,616 MWh_{Th}**. Duke zbritur këtë vlerë të konsumit nga sasia e energjisë termike e futur në rrjetin e shpërndarjes (**287,830 MWh_{Th}**) rezulton se humbjet sasiore në rrjetin e shpërndarjes për sezonin 2021/2022 janë **31,214 MWh_{Th}**, që në përqindje paraqet **10.84%**. Ky nivel i humbjeve paraqet një rritje prej 0.6% krahasuar me sezonin e kaluar (10.24%); kjo rritje e humbjeve është si pasojë e punimeve në rehabilitim të rrjetin që janë kryer edhe gjatë një pjese të sezonit të ngrohjes, ku ka qenë e nevojshme të bëhen testime hidraulike në segmente të caktuara të rrjeti, e po ashtu kur janë instaluar nënstacionet e reja fillimisht rrjeti sekondarë është mbushur me ujë nga rrjeti primarë.

Në tabelën vijuese janë paraqitur të dhënat e përmbledhura për prodhimin, furnizimin dhe humbjet e tërësishme në rrjet – rrjetin e transportimit të energjisë termike dhe në rrjetin e shpërndarjes:

Tab. 7.4 Performanca energjetike e NQ Termokos – sezoni 2021/2022

NQ Termokos - Sezoni i Ngrhjes 2021/2022		
Përshkrimi	Njësia	Vlera
Prodhimi bruto në stabilimentet e ngrohtores	[MWh _{th}]	96
Prodhimi bruto në stabilimentet e kogjenerimit	[MWh _{th}]	294,373
Humbja sasiore në rrjetin e transportit (TC Kosova B - NQ Termokos)	[MWh _{th}]	5,888
Humbjet në përqindje në rrjetin e transportit	[%]	2.00
Konsumi vetanak	[MWh _{th}]	752
Prodhimi neto i energjise termike	[MWh _{th}]	287,829
Humbjet sasiore në rrjetin e shpërndarjes	[MWh _{th}]	31,214
Humbjet në përqindje në rrjetin e shpërndarjes	[%]	10.84
Furnizimi i konsumatorëve me energji termike	[MWh _{th}]	256,615

NQ Gjakova

- Prodhimi i energjisë termike

Në sezonin 2021/'22, NQ Gjakova ka filluar me operimin komercial në ngrohtoren e re me biomasë. Megjithatë, për shkak të pamundësisë për të siguruar sasinë e nevojshme të lëndë djegëse, edhe në

këtë sezonë prodhimi i energjisë termike ka qenë i reduktuar – prodhimi bruto ka qenë **12,773 MWh_{TH}** ndërsa prodhimi neto i energjisë termike **12,713 MWh_{TH}**. Për këtë prodhim të energjisë termike në këtë sezon janë shpenzuar **5,150 ton** të lëndës djegëse - biomasë.

- Furnizimi me ngrohje

Si pasojë e prodhimit të reduktuar, NQ Gjakova gjatë sezonit 2021/2022 ka ofruar një furnizim të reduktuar; gjithashtu duhet theksuar se për këtë arsye furnizimi është ndërprerë para përfundimit zyrtarë të sezonit. Furnizimi i konsumatorëve me energji termike në këtë sezon ka qenë **10,170 MWh_{TH}**, sasi kjo që nuk e plotëson e kërkesën për ngrohje të gjithë konsumatorëve të kyçur në sistemin e NQ Gjakovës.

- Humbjet në sistem

Sa i përket humbjeve në prodhimin e energjisë termike, fillimisht duhet theksuar se, pajisjet matëse në impiantet e ngrohjes së re janë të instaluar, por duhet të kryhet leximi i saktë i këtyre pajisjeve, si dhe përpunimi dhe raportimi i drejtë i të dhënave për prodhimin e energjisë termike. Sipas raportimit të ndërmarrjes, efikasiteti i kaldajave për prodhimin e energjisë termike është vlerësuar rreth 80%, që shkakton një humbje gjatë procesit të transformimit të energjisë së lëndës djegëse në energji termike, e cila vlerësohet të jetë 3,193 MWh_{TH}.

Humbjet në rrjetin primar të shpërndarjes llogariten si diferenca në mes të sasisë së energjisë termike të futur në rrjetin e shpërndarjes dhe furnizimit/konsumit. Në mungesë të matjes së sasisë së furnizuar të energjisë termike (në nënstacione), për llogaritjen e furnizimit janë bërë disa përafrime duke përdorur në radhë të parë parametrat si: kërkesën specifike për kapacitetin ngrohës (W/m²) dhe orë e ngarkesës së plotë respektivisht konsumin specifik (kWh/m²). Vlera e përlllogaritur e konsumit është **10,170 MWh_{TH}**. Duke zbritur këtë vlerë të konsumit nga sasia e energjisë termike e futur në rrjetin e shpërndarjes (**12,713MWh_{TH}**) rezulton se humbjet sasiore në rrjetin e shpërndarjes për sezonin 2021/2022 janë **2,543MWh_{TH}**, që në përqindje janë rreth 20%.

Në tabelën vijuese janë paraqitur të dhënat e përmbledhura për prodhimin, furnizimin dhe humbjet e në rrjetin e shpërndarjes:

Tab. 7.5 Performanca energetike e NQ Gjakova – sezoni 2021/2022

NQ Gjakova - Sezoni i Ngrhjes 2021-2022		
Përshkrimi	Njësia	Vlera
Sasia e lëndës djegëse -biomasë	[ton]	5,150
Vlera kalorifike	[MWh _{th} /ton]	3.1
Energjia e futur nga lënda djegëse - biomasë	[MWh _{th}]	15,966
Efikasiteti i kaldajave	[%]	80.00
Prodhimi bruto i energjisë termike	[MWh _{th}]	12,773
Konsumi vetanak	[MWh _{th}]	60
Prodhimi neto i en.termike / Energjia e futur në rrjetin e shpërndarjes	[MWh _{th}]	12,713
Humbjet sasiore në rrjetin e shpërndarjes	[MWh _{th}]	2,543
Humbjet në përqindje	%	20.00
Furnizimi i konsumatorëve me energji termike	[MWh _{th}]	10,170

Në tabelën vijuese janë paraqitur të dhënat e prodhimit, furnizimit dhe humbjeve në sistem të përmbledhura për tërë sektorin e energjisë termike.

Tab. 7.6 Performanca energjetike e sektorit të energjisë termike – sezoni 2021/2022

Sektori i Energjisë Termike - Sezoni 2021/2022				
Përshkrimi	Njësia	NQ Termokos	NQ Gjakova	Gjithsej
Prodhimi bruto i energjisë termike	[MWh _{th}]	294,469	12,773	307,242
Humbjet sasiore në rrjetin e transportit	[MWh _{th}]	5,888	-	5,888
Humbjet në përqindje në rrjetin e transportit	[%]	2.00	0.00	2.00
Konsumi vetanak	[MWh _{th}]	752	60	812
Prodhimi neto i energjisë termike	[MWh _{th}]	287,829	12,713	300,542
Humbjet sasiore në rrjetin e shpërndarjes	[MWh _{th}]	31,214	2,543	33,757
Humbjet në përqindje në rrjetin e shpërndarjes	[%]	10.84	20.00	11.23
Furnizimi i konsumatorëve me energji termike	[MWh _{th}]	256,615	10,170	266,785

7.4 Faturimi, arkëtimi dhe sipërfaqja e ngrohjes

7.4.1 Faturimi dhe arkëtimi

Në lidhje me faturimin fillimisht duhet përmendur se edhe në sezonin 2021/2022, faturimi i konsumatorëve të energjisë termike kryesisht ka qenë i bazuar në sipërfaqen e ngrohjes (për metër katror), ndërsa një numër më i vogël i konsumatorëve janë faturuar bazuar në konsumin e matur. Konkretisht në NQ Termokos numri i konsumatorëve të faturuar me matje ka arritur në 129 konsumatorë, kryesisht komercial e institucional, përderisa NQ Gjakova, në mungesë të njehsorëve funksional, pothuajse tërësisht faturon sipas sipërfaqes ngrohëse.

NQ Termokos në sezonin 2021/2022 ka shënuar një rritje të faturimit në krahasim me sezonin e kaluar, që është kryesisht rrjedhojë shtimit të numrit të konsumatorëve respektivisht rritjes së sipërfaqes ngrohëse dhe përmirësimit të vazhdueshëm të furnizimit. Faktikisht faturimi i realizuar në sezonin 2021/2022 ka qenë **7,487,083 €**, që paraqet një rritje prej 274,823 € ose 3.8% në krahasim me sezonin 2021/2022 (7,212,260 €).

Nga faturimi total i realizuar në sezonin 2021/2022 prej **7,487,083 €**, faturimi me matje ka qenë **2,869,927€** ndërsa dhe pa matje **4,617,156€**; raporti i faturimit me matje dhe pa matje si dhe vlerat respektive janë paraqitur në diagramin më poshtë.




Fig. 7.2 Pjesëmarrja e vlerave të faturimit me matje dhe pa matje në faturimin total

NQ Termokos në sezonin 2021/2022 ka arkëtuar shumën prej **5,049,572 €** që paraqet shkallën e përgjithshme të arkëtimit prej **67.44%**. Duhet theksuar se niveli i arkëtimit ka shënuar një rritje afër 4% në krahasim me sezonin e kaluar 2020/2021 ku përqindja e arkëtimit ishte 63.46%. Duhet përmendur se në këtë sezonë arkëtimi i pagesave nga grupi i konsumatorëve shtëpiak është dukshëm më i ulët (53.70%); përderisa arkëtimi i pagesave të Konsumatorëve komercial e institucional ka qenë 80.86%.

Siç u theksua më lartë, NQ Gjakova gjatë sezonit 2021/2022 ka ofruar një furnizim të reduktuar, si pasojë e shkurtimit të sezonit të ngrohjes dhe gjithashtu sipërfaqja ngrohëse aktive ende mbetet e vogël në krahasim me sipërfaqen ngrohëse totale të kyçur. Rrjedhimisht faturimi në këtë sezon ka qenë mjaft i vogël – **398,584 €**, ndërsa arkëtimi si shumë monetare ka arritur vlerën prej **353,094€**, që paraqet një shkallë të arkëtimit prej 88.59%.

Detajet në lidhje me faturimin dhe arkëtimin janë treguar në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm.

Tab. 7.7 Faturimi dhe arkëtimi – sezoni 2021/2022

Sezoni i ngrohjes 2021/2022	Sipërfaqja ngrohëse [m ²]	Pjesëmarrja në përqindje	Faturimi [€]	Arkëtimi [€]	Shkalla e arkëtimit [%]
NQ "Termokos" Prishtina					
Amvisëri	855,044	58.71%	3,698,216	1,985,788	53.70%
Komercial e Institucional	601,241	41.29%	3,788,867	3,063,784	80.86%
Gjithsej	1,456,285	100.00%	7,487,083	5,049,572	67.44%
NQ "Gjakova" Gjakovë					
Amvisëri	32,239	44.93%	150,084	132,297	88.15%
Komercial e Institucional	39,516	55.07%	248,500	220,797	88.85%
Gjithsej	71,755	100.00%	398,584	353,094	88.59%




Fig. 7.3 Faturimi dhe arkëtimi NQ Termokos – sezoni 2021/2022

7.4.2 Sipërfaqja për ngrohje

Në sezonën 2021/2022 NQ Termokos ka pasur sipërfaqen e përgjithshme ngrohëse të konsumatorëve prej **1,456,285 m²**, që ndahet në grupet e konsumatorëve të amvisërisë dhe komercial e institucional sipas proporcionit 59% : 41%.

Ndërsa sipërfaqja totale ngrohëse e NQ Gjakova është **71,755 m²**, e ndarë në proporcionin 45% konsumatorët e amvisërisë dhe 55% konsumatorët komercial e institucional. Siç u përmend më lartë, sipërfaqja ngrohëse e konsumatorëve aktiv ende është e vogël krahasuar me sipërfaqen totale të konsumatorëve të kyçur në sistem dhe mbetet sfidë për NQ Gjakovën aktivizimi i konsumatorëve pasiv duke ofruar furnizim të mjaftueshëm dhe cilësorë.

Në grafikët e mëposhtëm paraqiten sipërfaqet ngrohëse të NQ Termokos dhe NQ Gjakova, të ndara sipas grupeve të konsumatorëve.




Fig. 7.4 Sipërfaqja ngrohëse sipas grupeve të konsumatorëve në sezonin 2021/2022

8 SEKTORI I GAZIT NATYROR

8.1 Perspektiva e zhvillimit të sektorit të gazit natyror në Kosovë

Me qëllim të hapjes së perspektivës së zhvillimit të sektorit të gazit natyror dhe njëkohësisht përmbushjes së obligimeve që Kosova i ka ndaj Traktatit të Komunitetit të Energjisë, Parlamenti i Kosovës në qershor 2016, në kuadër të pakos së ligjeve të energjisë, ka miratuar Ligjin për Gazin Natyror, Nr.05/L-082.

Me këtë ligj është bërë transpozimi i pakos së tretë të legjislacionit Evropian relevant për gazin natyror, kryesisht:

- Direktiva Nr. 2009/73/EC për Rregullat e Përbashkëta për Tregun e Brendshëm të Gazit Natyror; dhe
- Rregullorja Nr. 715/2009/EC për Kushtet e Qasjes në Rrjetet e Transmisionit të Gazit Natyror.

Ligji për gazin natyror shtron bazat për kornizën ligjore dhe rregullative për transmisionin, shpërndarjen, deponimin dhe furnizimin me gaz natyror dhe për operimin e sistemeve të transmisionit dhe shpërndarjes së gazit. Rrjedhimisht me këtë ligj përcaktohet organizmi dhe funksionimi i sektorit të gazit natyror dhe qasja në rrjetet dhe tregun e gazit.

Zhvillimi i infrastrukturës së gazit natyror në Kosovë ndërlihet me projektet e infrastrukturës së gazit në rajonin e Evropës Juglindore. Vlerësohet se projekti i gazsjellësit TAP do ketë ndikim pozitiv në zhvillimin e infrastrukturës së gazit në Komunitetin e Energjisë respektivisht në rajonin e Evropës Juglindore, duke ofruar mundësi për lidhjen e projekteve të planifikuara rajonale si gazsjellësi Jon-Adriatik (IAP), ALKOGAP dhe Interkonekzioni Maqedoni e Veriut - Kosovë, projekte këto që e plotësojnë të ashtuquajturën 'Unaza e Gazit e Komunitetit të Energjisë'.

Me operacionalizimin e gazsjellësit Transadriatik (TAP) përgjatë 878 kilometrave të trajektores së tij në Greqi, Shqipëri, Detin Adriatik e Itali, janë mundësuar rrjedhat e para të gazit nga burimet e gazit "Shah Deniz II" në Azerbajxhan. Kapaciteti fillestarë i TAP është 10 miliardë metër kub (bcm) për vit, me mundësi shtimi gjer në 20 bcm për vit. TAP do lejoj kçjjet interkonektive (intekonekcionet) përgjatë gazsjellësit për të furnizuar me gaz projektet tjera regjionale. Pra me marrëveshjet shtetërore me shtetet "nikoqire" (Greqia, Shqipëria dhe Italia) janë para-përcaktuar vendet e kçjjes dhe sasitë respektivisht kapacitetet e gazit.

Në këtë kontekst të zhvillimeve rajonale në sektorin e gazit, këtyre 2 - 3 viteve të fundit janë ndërmarrë një numër aktivitetesh të ndërlihdura me projektet aktuale të gazsjellësve rajonal si Studimi i parafizibilitetit për projektin e Gazsjellësit Shqipëri – Kosovë (ALKOGAP) dhe Gazsjellësin Maqedoni e Veriut – Kosovë.



Fig. 8.1 Projektet e Infrastrukturës rajonale të gazit dhe opsionet për kyçjen e Kosovës (përfshirë ALKOGAP dhe interkoneksionin e gazit Maqedoni e Veriut - Kosovë)

Zhvillimi kryesor gjatë vitit 2022 ka qenë finalizimi i hartimit të Planit Nacional të Zhvillimit të Sektorit të Gazit dhe Rishikimi e Asistenca për Kornizën Rregullative, I financuar përmes platformës së WBIF, ku Institucion financiar udhëheqës është BERZH. Ky plan ka adresuar zhvillimin e një plani gjithëpërfshirës afat-mesëm dhe identifikimin e projekteve kryesore të gazit, me objektiv kryesor të zhvillimit të infrastrukturës përkatëse të gazit brenda vendit. Po ashtu në kuadër të këtij plani është kryer edhe rishikimi i kornizës rregullative, vlerësimi organizativ dhe institucional dhe vlerësimi i ndikimit në mjedis (VNM).

Ky plan përfshinë komponentët kryesorë si në vijim:

- Projektionet afat-gjatë të kërkesës për gaz, ku janë përfshirë: sektorët e amvisërisë dhe shërbimeve, industria, sektori I ngrohjes qendrore dhe gjenerimi I energjisë elektrike.
- Vlerësimi i opsioneve më të favorshme për furnizim (import) të gazit natyror përmes interkonektorëve regjional dhe vlerësimet përkatëse për zhvillimin e rrjetit të brendshëm të gazit natyror.
- Përcaktimi i parametrave teknik të tubacionit dhe stacioneve dhe pajisjeve përkatëse, si dhe analizës hidraulike të tubacionit po ashtu dhe konfigurimit dhe optimizimit të sistemit.
- Analiza ekonomike dhe financiare duke përfshirë vlerësimin e kostove të investimit dhe koston e operimit e mirëmbajtjes, si dhe Analiza e përfitimeve të koston.

Duhet theksuar se identifikimi i projekteve prioritare investive është bazuar në skenarin e preferuar industrial që përfshinë segmentin e kryesor të transmisionit dhe dy segmente tek qendrat kryesore industriale (të paraqitura në hartën e mëposhtme); konkretisht:

- Segmentin Hani Elezit – Prishtinë, si pjesë e interkonektorit Maqedoni e Veriut (Shkup) – Kosovë (Prishtinë);
- Segmentin Prishtinë – Mitrovicë, ku përfshihet edhe Obiliqi; si dhe

- Segmentin Hani Elezit – Fabrika e çimentos Sharrcem.



Fig. 8.2 Projektet investive prioritare brenda vendit sipas skenarit industrial

Gjithashtu duhet theksuar se ZRRE ka qenë i përfshirë në 'Komitetin drejtues të Projektit' që ka pasur për detyrë të përcjellë hartimin e studimit dhe po ashtu të kontribuoj me dhënien e komenteve dhe inpueteve përkatëse.

Adresa e Rregullatorit

Zyra e Rregullatorit për Energji

Prishtinë 10000, Kosovë

Tel: +383 (0) 38 247 615

Fax: +383 (0) 38 247 620

Email: info@ero-ks.org

Web: www.ero-ks.org

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji:

Tel: +383 (0) 38 247 615 lok. 101

Sekretaria:

Tel: + 383 (0) 38 247 615 lok. 104

Departamenti për Mbrojtje të Konsumatorëve:

Tel. + 383 (0) 38 247 615 lok. 116 dhe 125

Email: ankesa.dmk@ero-ks.org